BANKA E SHQIPËRISË

# BULETINI EKONOMIK

**Botim tremujor**

**Dhjetor 2004**

*Artikujt e paraqitur në këtë botim, nuk shprehin gjithmonë opinionin zyrtar të Bankës së Shqipërisë. Këtyre artikujve lutemi t'u referoheni si mendime personale të autorëve.*

*Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi, jeni të lutur të citoni burimin.*
*Botuar nga : Banka e Shqipërisë, Sheshi "Skënderbej", Nr.1, Tiranë.*
*Tel : 355-4-222230; 235568; 235569;*
*Faks : 355-4-223558*
*www.bankofalbania.org*

*Për komentet dhe sugjerimet tuaja na shkruani në:*
*Sektori i Publikimeve, Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun.*
*E-mail: public@bankofalbania.org*

*Shtypur në Shtypshkronjën e Bankës së Shqipërisë.*
*Tirazhi : 640 kopje*

# BULETINI EKONOMIK TREMUJOR
## DHJETOR 2004

PËRMBAJTJA


"SFIDAT 7-VJEÇARE TË DREJTIMIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË"
*FJALA E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, Z.ARDIAN FULLANI, NË KONFERENCËN E PARË PËR SHTYP, NËNTOR 2004* 5

DEKLARATA GJASHTËMUJORE E ZHVILLIMEVE EKONOMIKE DHE MONETARE,
TETOR – DHJETOR 2004 7

*I. FJALA E GUVERNATORIT* 7
*II. ECURIA EKONOMIKE GJATË GJASHTËMUJORIT TË DYTË TË VITIT 2004* 9
*III. INFLACIONI GJATË PERIUDHËS KORRIK - DHJETOR* 18
*IV. ZHVILLIMET MONETARE DHE TREGJET FINANCIARE* 23
*V. EKONOMIA SHQIPTARE NË VITIN 2005* 35

DOKUMENTI I POLITIKËS MONETARE PËR VITIN 2005 38

ZHVILLIMET NË SEKTORIN E JASHTËM TË EKONOMISË PËR NËNTËMUJORIN E VITIT 2004 45

DEKLARATA E BANKËS SË SHQIPËRISË "MBI STABILITETIN E SISTEMIT FINANCIAR NË SHQIPËRI" 48

LAJMET PËR PERIUDHËN TETOR – DHJETOR 2004 50

NGJARJET JURIDIKE 54

DREJTIMI I BANKËS SË SHQIPËRISË 57

LISTA E SUBJEKTEVE TË LICENCUARA NGA BANKA E SHQIPËRISË 58

BANKA DHE DEGË TË BANKAVE TË HUAJA 58

SUBJEKTE JOBANKA 61

SUBJEKTET FINANCIARE QË NUK LICENCOHEN NGA BANKA E SHQIPËRISË PËR KRYERJEN E VEPRIMTARISË SË TYRE, NË MBËSHTETJE TË VENDIMIT NR. 26, DATË 29.03.2000, TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË BANKËS SË SHQIPËRISË "PËR PËRJASHTIMIN E DISA SUBJEKTEVE NGA ZBATIMI I DISPOZITAVE TË LIGJIT NR. 8365,
DATË 02.07.1998 "PËR BANKAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"" 63

ZYRA TË KËMBIMEVE VALUTORE 64

UNIONET E SHOQËRIVE TË KURSIM-KREDITIT 70

ZYRA TË PËRFAQËSIMIT TË BANKAVE TË HUAJA 71

# SFIDAT 7-VJEÇARE TË DREJTIMIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË

## FJALA E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, Z. ARDIAN FULLANI, NË KONFERENCËN E PARË PËR SHTYP. 5 NËNTOR 2004

Duke e konsideruar takimin e sotëm me ju, daljen time të parë zyrtare në publik si guvernator, dëshiroj t'ju falenderoj për interesimin dhe besimin tuaj ndaj Bankës së Shqipërisë. E shoh të nevojshme që edhe një herë të shpreh angazhimin tim personal dhe të stafit që unë drejtoj se Banka e Shqipërisë do t'i ketë gjithnjë dyert e hapura, duke synuar forcimin dhe mirëfunksionimin e mëtejshëm të urave, tashmë të ngritura të komunikimit. Megjithatë, mesazhi im i sotëm është që ky komunikim do të jetë jo vetëm institucional me mua, por me institucionin e Bankës së Shqipërisë. Kjo do të thotë se unë do të siguroj një transparencë, komunikim të qartë dhe të vazhdueshëm, në mënyrë që fuqia e madhe e medias të bëjë të mundur transmetimin e mesazheve tona të qarta në publik.

Banka e Shqipërisë konsiderohet sot si një institucion i konsoliduar, i besueshëm dhe transparent. Politika e saj monetare ka qenë e matur dhe efektive, duke ndihmuar në forcimin e ekuilibrit makroekonomik, në përputhje të plotë me programet kombëtare të zhvillimit ekonomik të vendit. Duke gjykuar këto aspekte, do të doja të prezantoja disa nga idetë në lidhje me përsosjen e tyre në të ardhmen, duke i qëndruar idesë time të shprehur tashmë, asaj të vazhdimësisë.

Fillimisht, dëshiroj të ndalem në **zhvillimin institucional të Bankës së Shqipërisë**. Në perceptimin tim, pavarësia e institucionit të bankës qendrore është një problem *paramount*, ndërkohë që po kaq të rëndësishme gjykoj edhe hapjen e mëtejshme të institucionit, duke pasur parasysh edhe një llogaridhënie gjithnjë e më të plotë dhe më bashkëkohore. Banka qendrore është një institucion jo vetëm i pavaruar, por edhe kryesisht dhe paralelisht i përgjegjshëm, që do të thotë realisht transparent në marrjen e vendimeve, në bërjen e politikave dhe në realizimin e tyre. Gjatë mandatit tim do të siguroj që vendimet do të merren larg ndikimeve të ekzekutivit dhe politikës, ndërkohë që Banka e Shqipërisë do të përmbushë detyrimin e saj ligjor në dhënien e këshillave dhe të ekspertizave përkatëse ndaj vendimmarrjes ekonomike në vend.

Gjatë mandatit tim, objektiv kryesor i politikës monetare do të jetë **ruajtja e stabilitetit të çmimeve**. Për të konsoliduar ruajtjen e stabilitetit të çmimeve, banka do të konsiderojë në të ardhmen adoptimin e regjimit "inflation targeting" ose siç njihet ndryshe "inflacioni i synuar", i cili i përshtatet më mirë ndryshimeve të ekonomisë shqiptare në të ardhmen, sidomos zgjerimit dhe zhvillimit të sektorit financiar. Në këtë kuptim, edhe kuadri operacional do të evoluojë më tej, duke synuar funksionimin vetëm mbi parimet e tregut.

**Qëndrueshmëria e sistemit bankar** do të jetë shtylla e dytë e rëndësishme në të cilën do të mbështetet banka qendrore. Banka e Shqipërisë do të nxisë zhvillimin dhe konsolidimin e një sistemi bankar dhe financiar të shëndetshëm, në funksion të zhvillimit ekonomik të vendit. Kjo do të çojë jo vetëm në financimin real të ekonomisë me kredi nga sistemi bankar, por edhe në rritjen e efektivitetit të ndërmjetësimit financiar dhe shërbimeve financiare e bankare. Një dimension të ri në këtë drejtim, do të marrë futja e parave *cash* në kanalet bankare, duke kontribuar në këtë mënyrë në formalizimin e ekonomisë.

Në këto kushte, merr një rëndësi parësore **ngritja në standarde bashkëkohore e mbikëqyrjes bankare dhe financiare**. Kjo nënkupton domosdoshmërinë e rishikimit të bazës rregullatore ekzistuese, për ta sjellë atë sa më pranë standardeve më të mira në këtë drejtim, si edhe për ta shndërruar procesin mbikëqyrës realisht në një proces të orientuar sipas rrezikut dhe proaktiv. Një komunikim i hapur dhe i drejtpërdrejtë me industrinë bankare dhe institucionet e tjera të rëndësishme financiare, do të qëndrojë në themel të këtyre objektivave. Të gjitha angazhimet e mësipërme kërkojnë ridimensionimin e kapaciteteve analizuese dhe

kërkimore, duke synuar shmangien e karakterit përshkrues dhe shpjegimin e thelbit të fenomeneve në ekonomi. Për këtë qëllim, Banka e Shqipërisë do të iniciojë krijimin e forumeve konsultative me përfaqësues të fushës akademike, analistë dhe studiues. Kjo do të mundësojë ballafaqimin me palë të treta të paanshme, të cilat do të na ofrojnë jo vetëm eksperiencën e tyre, por edhe do të sjellin një këndvështrim alternativ për një vendimmarrje të mirëinformuar.

Banka e Shqipërisë do t'i kushtojë rëndësi të veçantë **administrimit efektiv të burimeve njerëzore** duke synuar edhe në këtë drejtim arritjen e standardeve ndërkombëtare të institucioneve model. Ajo do të bëhet një institucion tërheqës për profesionistët.

Banka e Shqipërisë, mbi të gjitha do të fuqizojë **marrëdhëniet mbi baza reciprociteti me të gjithë partnerët ndërkombëtarë**. Në tryezën e bisedimeve ajo do të jetë një partner real në diskutimin e politikave ekonomiko-financiare, ku do të ofrojë alternativat e saj të zgjedhjeve të përpunuara jo vetëm mbi bazën e logjikës ekonomike, por edhe të realitetit shqiptar.

Banka e Shqipërisë sheh tek Banka Qendrore Evropiane institucionin i cili përfaqëson jo vetëm modelin e organizimit dhe të veprimit drejt të cilit ne synojmë të afrohemi me shpejtësi, por edhe mundësinë e një bashkëpunimi konkret, në drejtime të veçanta të funksionimit të Bankës së Shqipërisë si edhe të objektivave strategjikë të ekonomisë së vendit.

# DEKLARATA GJASHTËMUJORE E ZHVILLIMEVE EKONOMIKE DHE MONETARE KORRIK – DHJETOR 2004

## I. FJALA E GUVERNATORIT

Pjesa e dytë e vitit 2004, ka gjeneruar një aktivitet më të madh ekonomik, duke regjistruar një lloj gjallërimi të përgjithshëm, veçanërisht pas një fillimviti relativisht të qetë. Përshpejtimi i rritjes së prodhimit është evidentuar pothuajse në të gjithë sektorët ekonomikë, ndërkohë që objektivat madhorë në ekonomi janë përmbushur në përputhje me programin e përgjithshëm të zhvillimit ekonomiko – financiar të vendit.

Në rrafshin ndërkombëtar, ky gjashtëmujor përkoi me një përshpejtim të tendencave të verifikuara në pjesën e parë të vitit, sidomos përsa i takon ecurisë së dollarit amerikan dhe rritjes së çmimit të naftës. Politika monetare e Rezervës Federale, gjatë kësaj periudhe, ka ndryshuar kahun e politikës monetare me anë të disa rritjeve të njëpasnjëshme të përqindjes bazë të interesit, në tentativë për të frenuar presionet inflacioniste në ekonomi. Nga ana tjetër, Banka Qendrore Evropiane, duke vlerësuar ecurinë e inflacionit dhe presionet e forta ndaj euros, ka gjykuar të paarsyeshëm ndryshimin e përqindjes bazë, duke e mbajtur atë në nivelin 2 për qind për rreth 1 vit e gjysmë.

Në planin e brendshëm, prodhimi në sektorin bujqësor pritet të jetë më i lartë sesa parashikimi i fillimvitit. Po kështu, dhe shitjet e realizuara nga sektorët jobujqësorë të ekonomisë kanë qenë më të larta si në krahasim me dy tremujorët e parë, ashtu edhe në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Ngadalësimi në sektorin e industrisë është balancuar nga ecuria e mirë në sektorin e shërbimeve (tregtisë, hoteleve dhe restoranteve) dhe në atë të ndërtimit, duke kontribuar ndërmjet të tjerash në një situatë më të mirë të punësimit. Shpenzimet buxhetore kanë qenë brenda kufijve të parashikuar, duke mos rrezikuar rritjen e kërkesës. Rritja e çmimit të naftës në tregun ndërkombëtar, ndonëse është reflektuar në çmimin e naftës dhe të transportit në Shqipëri, nuk duket të ketë shkaktuar kosto shtesë të papërballueshme për biznesin dhe për konsumatorin në vend.

Inflacioni vjetor në muajin dhjetor rezultoi 2.2 për qind, ndërsa inflacioni mesatar vjetor ishte 2.9 për qind. Respektimi i objektivit të inflacionit ka ardhur si rrjedhojë e situatës së qëndrueshme makroekonomike, e kontrollit të kërkesës së brendshme të ekonomisë dhe e stabilitetit të treguesve monetarë.

Viti 2004 u karakterizua nga respektimi i objektivave fiskalë në drejtim të shpenzimeve buxhetore dhe deficitit buxhetor, si dhe nga një shpërndarje më e njëtrajtshme e shpenzimeve fiskale. Kërkesa e qeverisë për hua ka ardhur në rritje gjatë gjashtëmujorit të dytë, por duke mbetur gjithsesi brenda niveleve të parashikuara. Gjithashtu, norma vjetore e ndryshimit të shpenzimeve buxhetore korente ka qenë e qëndrueshme. Zbatimi i një politike fiskale të matur ka krijuar kushte për kontrollimin më të mirë të normës së inflacionit.

Politika monetare e Bankës së Shqipërisë, gjatë gjithë gjysmës së dytë të vitit 2004, ka ruajtur kahun zbutës, duke synuar para së gjithash uljen e kostos së huamarrjes në ekonomi. Banka e Shqipërisë uli dy herë normën bazë të interesit, në muajt korrik dhe nëntor, me nga 0.25 pikë përqindje. Këto ulje e sollën normën bazë të interesit në nivelin më të ulët historik të saj, 5.25 për qind. Megjithatë, norma reale e interesit vazhdon të jetë pozitive, duke mundësuar thithjen e depozitave në sistemin bankar dhe duke ruajtur raportet e likuiditetit në sistem.

Sistemi bankar është karakterizuar nga ritme të larta të kreditimit të ekonomisë gjatë vitit 2004. Teprica e kredisë është rritur 9.2 miliardë lekë gjatë periudhës qershor - nëntor 2004, duke qenë 51 për qind më e lartë se rritja e tepricës në gjashtëmujorin e parë të vitit. Krediti për ekonominë po zë një peshë gjithnjë në rritje në

strukturën e aktiveve të sistemit bankar, duke përbërë një burim të rëndësishëm të kërkesës për mjete monetare. Raporti kredi/depozita është në rritje të vazhdueshme, tregues i cili prezanton pozitivisht funksionin e rolit ndërmjetësues të sistemit bankar në mbështetjen e zhvillimit të ekonomisë. Rritja e tepricës së kredisë, gjatë 11 muajve të parë të vitit, shënon vlerën 15.3 miliardë lekë, duke përbërë një rritje prej 30 për qind në krahasim me fundin e vitit 2003.

Politika monetare zbutëse e Bankës së Shqipërisë ka ndihmuar edhe në zbutjen e presioneve mbiçmuese të kursit të këmbimit të lekut. Diferencat midis interesave në valutë dhe atyre në lekë kanë pësuar rënie gjatë vitit 2004. Megjithatë, hyrjet valutore në rritje nga njëra anë dhe ulja e ritmeve të importeve nga ana tjetër, kanë krijuar një diferencë të përkohshme midis ofertës dhe kërkesës për valutë gjatë muajve të verës. Ky zhbalancim ka ushtruar presion të dukshëm për mbiçmimin e kursit të këmbimit të lekut, duke rritur edhe luhatshmërinë në tregjet valutore. Luhatshmëria e kursit të këmbimit në sajë të kësaj rritjeje të përkohshme të ofertës valutore, ka diktuar nevojën e ndërhyrjes së Bankës së Shqipërisë në tregun valutor gjatë muajve të verës, në kahun e blerjes së valutës.

Megjithë rritjen e deficitit tregtar, deficiti korent në tremujorin e tretë ka qenë më i ulët se në tremujorët paraardhës, falë bilanceve pozitive dhe të rritura të të ardhurave, shërbimeve dhe sidomos të transfertave korente. Bilanci në kategorinë e transfertave korente vlerësohet të jetë rreth 294 milionë usd, duke qenë më i lartë se në dy tremujorët e parë dhe rreth 44 për qind më i madh se ai i tremujorit të tretë të vitit të kaluar. Në tërësi, zhvillimet e bilancit të pagesave gjatë vitit 2004, paraqiten pozitive. Niveli i rezervave valutore bruto, në fund të periudhës, u vlerësua në 1 miliardë e 244 milionë usd, i mjaftueshëm për të përballuar 5.1 muaj importe mallrash dhe shërbimesh.

Bazuar në zhvillimet e mësipërme, mund të konkludohet se viti 2004, në përgjithësi kontribuoi në përforcimin e mëtejshëm të ekuilibrit makroekonomik të vendit. Ndonëse ende nuk disponohen të dhëna të plota për fundin e vitit 2004, është kristalizuar ideja se objektivat kryesorë të parashikuar në planin afatmesëm të zhvillimit të vendit janë përmbushur në mënyrë të kënaqshme. Sipas vlerësimeve të fundit, ekonomia shqiptare është rritur me 6 për qind në kushtet e një norme inflacioni të ulët, shumë pranë nivelit të poshtëm të bandës objektiv.

Reformat strukturore, me gjithë problematikën e tyre, gjatë vitit 2004 ecën përpara. Privatizimi i ish - Bankës së Kursimeve, ka rritur konkurrencën e sektorit bankar, ndërkohë që është bërë progres në procesin e privatizimit të kompanive të tjera shtetërore si Albtelekom dhe ARMO.

I gjithë ky proces konsolidues ka krijuar premisat për qëndrueshmëri më të madhe në të ardhmen. Tashmë është konturuar programi i zhvillimit të vendit për vitin 2005, pjesë e të cilit janë edhe objektivat kryesorë të politikës monetare.

Objektivi kryesor i politikës monetare për vitin 2005, i përfshirë në programin monetar, mbetet ruajtja e normës vjetore të inflacionit në intervalin 2 – 4 për qind. Ky objektiv do të synohet të arrihet nëpërmjet kontrollit të rritjes së ofertës monetare në nivel të përafërt me rritjen e PBB-së nominale, nën supozimin e ecurisë së qëndrueshme të shpejtësisë së qarkullimit të parasë në ekonomi. Mbi këtë bazë, ritmi vjetor i rritjes së ofertës së parasë për vitin 2005, të parashikuar në programin monetar është 9.4 për qind. Ky ritëm është konsistent me plotësimin e kërkesës për para të ekonomisë, që vjen nga rritja reale e saj me 6 për qind.

Programi monetar i Bankës së Shqipërisë është hartuar në përputhje me politikat e tjera në ekonomi, ku veçanërisht spikat harmonizimi i saj me politikën fiskale të qeverisë. Banka e Shqipërisë vlerëson se ashtu si në vitet e fundit, edhe gjatë vitit 2005, ecuria e zhvillimit ekonomik të vendit do të jetë në përputhje me objektivat e programit të zhvillimit të përgjithshëm të tij. Zhvillimet e fundit në sistemin bankar, rrisin optimizmin se ai do të përmbushë gjithnjë e më mirë rolin e tij të ndërmjetësimit financiar në ekonomi. Ne gjykojmë se konsolidimi i tij do të vazhdojë me ritme më të shpejta gjatë këtij viti, duke i ofruar publikut në përgjithësi më shumë kredi, më shumë shërbime dhe më shumë siguri në administrimin e kursimeve.

# II. ECURIA EKONOMIKE GJATË GJASHTËMUJORIT TË DYTË TË VITIT 2004

## II.1 EKONOMIA BOTËRORE

Ekonomia botërore hyri në fazën e maturimit të ciklit të zhvillimit gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2004. Ritmet e larta të rritjes të fundit të vitit 2003 dhe të fillimit të vitit 2004 janë pasuar nga një rritje më e moderuar gjatë kësaj periudhe. Rritja e çmimit të naftës ka qenë një faktor, i cili ka ndikuar negativisht në ritmet e rritjes ekonomike. Në muajin tetor, çmimet e naftës arritën pikën më të lartë, por që prej këtij momenti ato kanë shënuar rënie, duke u shoqëruar me rritje të optimizmit dhe të indekseve të bursave. Tregtia botërore është rritur me 8.5 për qind gjatë vitit 2004[1], duke qenë njëkohësisht mbështetëse dhe një shenjë e rritjes ekonomike. Nga ana tjetër, rritja ekonomike është asistuar edhe nga politika makroenomike të cilat ruajnë një kah nxitës në nivel botëror. Kështu, normat e ulëta të huamarrjes dhe niveli i lartë i investimeve kanë ndikuar pozitivisht në zhvillimin e ekonomisë botërore. Pavarësisht çmimit të lartë të naftës, presionet inflacioniste kanë qenë të ulëta. Efektet sekondare të rritjes së çmimit janë zbehur, si pasojë e konkurrencës së lartë.

SHBA duket të ketë baza të qëndrueshme, FOMC vendosi të rrisë me 0.25 pikë përqindjeje normën bazë të interesit në datën 14 dhjetor, duke e çuar atë në nivelin 2.25 për qind. Kjo ishte rritja e pestë e normës së interesit nga Rezerva Federale për këtë vit. Megjithatë, tregjet financiare vazhdojnë të jenë të shqetësuara për problemet strukturore të ekonomisë amerikane. Deficiti mujor tregtar i SHBA-së arriti rekordin prej 60.3 miliardë usd në muajin nëntor, si pasojë e kërkesës në nivele rekord për naftë dhe për mallra konsumi. Gjithashtu, deficiti buxhetor për vitin fiskal 2004, i cili mbaroi në 30 shtator, shënoi vlerën 412.6 miliardë dollarë, rreth 3.6 për qind të PBB-së dhe rreth 9.4 për qind më shumë se në vitin e kaluar. Këto deficite kanë lëkundur besimin e investitorëve në vlerën afatgjatë të dollarit, gjë që është reflektuar në uljen e kursit të këmbimit të tij kundrejt valutave kryesore.

Norma e rritjes së PBB-së reale për Eurozonën ishte vetëm 0.3 për qind gjatë tremujorit të tretë. Ecuria e kësaj ekonomie, gjatë gjysmës së dytë të vitit nuk ka ruajtur ritmet e gjysmës së parë. Gjatë tremujorit të tretë kontributi i eksporteve neto ishte negativ, si pasojë e rritjes së konsiderueshme të importeve. Eksportet përbëjnë rreth një të pestën e ekonomisë evropiane, nivel ky rreth 2 herë më i lartë se ai i SHBA-së. Për rrjedhojë, ekonomia e Eurozonës

**Tabelë 1. Disa tregues kryesorë të ekonomive botërore (në përqindje).**

| | PBB - T3 | Papunësia | IÇK |
|---|---|---|---|
| Britani | 3.0 | 4.6 (shtator) | +1.2 (tetor) |
| Francë | 2.0 | 9.9 (tetor) | +2.1 (tetor) |
| Gjermani | 1.3 | 10.8 (nëntor) | +1.8 (nëntor) |
| Itali | 1.3 | 8.1 (prill) | +2.0 (nëntor) |
| Japoni | 3.9 | 4.7 (tetor) | +0.5 (tetor) |
| USA | 4.0 | 5.5 (tetor) | +3.2 (tetor) |
| Eurozonë | 1.8 | 8.9 (tetor) | +2.2 (nëntor) |

*Burimi: Revista "The Economist", 4-10 dhjetor 2004.

Në Shtetet e Bashkuara, ecuria e aktivitetit ekonomik gjatë këtij gjashtëmujori ka qenë pozitive. Në bazë të vlerësimeve më të fundit, rritja e përkthyer në terma vjetorë e PBB-së tremujore ishte 4 për qind gjatë tremujorit të tretë, nga 3.3 për qind që ishte gjatë tremujorit të dytë. Baza e rritjes për këtë periudhë ka qenë rritja e konsumit personal. Rritja e punëzënies gjatë këtij viti ka qenë një prej arsyeve të rritjes së konsumit personal. Duke vlerësuar se rritja ekonomike në është më e ndjeshme ndaj mbiçmimit të euros, mbiçmim i cili arriti në vlerën 7 për qind gjatë katër muajve të fundit. Ndikimi negativ i vlerësimit të euros në eksporte, ka sjellë edhe uljen e besimit të biznesit. Një faktor tjetër që ka ndikuar në ngadalësimin ekonomik është ulja e konsumit privat, që vlerësohet të ketë qenë pasojë e çmimit të lartë të naftës dhe e normës së papunësisë, e cila është rreth 8.9 për qind. Vendet e Eurozonës kanë filluar të ulin taksat, me qëllim nxitjen e

[1] Shifrat e Organizatës Botërore të Tregtisë.

konsumit personal, por duke rënduar më tej situatën e tyre fiskale. Për vitin 2004, vlerësohet se raporti i deficitit buxhetor ndaj PBB-së do të arrijë në nivelin 2.9 për qind nga 2.7 për qind që ishte në vitin 2003. Inflacioni në Eurozonë, në muajin nëntor, ishte 2.2 për qind nga 2.4 për qind që ishte në muajin tetor, duke reflektuar lëvizjet e çmimit të naftës. Norma vjetore e indeksit të grupit të energjisë u rrit nga 6.4 për qind, në muajin shtator 2004, në 9.8 për qind në muajin tetor 2004. Të dhënat nga tregu i punës tregojnë se rritja e pagës vjetore në Eurozonë ka qenë e moderuar gjatë tremujorit të tretë të vitit 2004, fakt ky që do të ndihmojë në kontrollin e presioneve inflacioniste në periudhën afatmesme.

### *Kurset e këmbimit*

Dollari ka vazhduar të nënçmohet me ritme të shpejta kundrejt të gjitha monedhave, gjatë 2 muajve të fundit të vitit 2004. Në ditët e fundit të muajit dhjetor, në tregjet botërore 1 euro u këmbye me 1.36 dollarë amerikanë. Deri më sot kjo është norma më e lartë historike e këmbimit të euros me dollarin.

Faktori kryesor që ka ndikuar në zhvlerësimin e dollarit është deficiti i llogarisë korente në Shtetet e Bashkuara. Dobësimi i dollarit mirëpritet nga eksportuesit amerikanë, ndërkohë që liderët e vendeve të Evropës kanë filluar të shqetësohen, pasi forcimi i euros ka filluar të ndjehet nga prodhuesit evropianë. Dollari amerikan ka kapur nivelet më të ulëta të këmbimit edhe kundrejt monedhave të tjera, gjatë muajit dhjetor. 1 dollar është këmbyer edhe me 104.5 yenë japonezë dhe me 1.9 paundë britanikë.

### *Çmimet e naftës*

Pas arritjes së një piku prej 55 dollarësh për fuçi në muajin tetor, çmimet e naftës kanë shënuar ulje, por duke mbetur gjithsesi në nivele të larta historike. Oferta botërore e naftës së papërpunuar është 1 për qind më e lartë se konsumi ditor, një diferencë kjo që i bën tregjet nervoze në rast ndërprerjesh prodhimi. Problemet kryesore gjeopolitike gjatë muajve të fundit janë të lidhura me zhvillimet në Irak dhe me mosmarrëveshjet në Rusi midis Yukos, kompanisë më të madhe ruse të prodhimit të naftës dhe Qeverisë Ruse.

Grafik 1. Ecuria e kursit të këmbimit euro - dollar, gusht - dhjetor 2004.




Burimi: Bloomberg.

Grafik 2. Ecuria e çmimit të naftës së papërpunuar, gusht - dhjetor 2004.




Burimi: Bloomberg.

Vendet anëtare të OPEC-ut, në mbledhjen e muajit dhjetor, vendosën të ulin prodhimin me një milion fuçi në ditë. Megjithatë, vendimi nuk pati efekte të forta në çmim, pasi nuk do të hyjë menjëherë në fuqi. OPEC-u prodhonte 28 milionë fuçi naftë në ditë, rreth 1 milion më teper se tavani i prodhimit. Vendimi për ta kthyer prodhimin në nivelet tavan u mor me qëllim që të mos u jepet mundësi vendeve që konsumojnë naftë të krijojnë stoqe, që do të çonte në ulje të çmimit.

Ekonomia shqiptare është ndihmuar nga kushtet e përshtatshme klimaterike, të cilat kanë ndikuar pozitivisht në prodhimin bujqësor dhe në situatën energjitike. Prodhimi në sektorin bujqësor pritet të jetë më i lartë sesa parashikimi i fillimvitit, duke bërë që kontributi i këtij sektori në rritjen e PBB-së të kalojë nga 0.7 pikë përqindjeje në 1 pikë përqindjeje.

**Tabelë 2. Rritja reale e PBB-së.**

| | 2002 | 2003 | 2004* |
|---|---|---|---|
| Ekonomia | 4.7 | 6.0 | 6.0 |
| - Industria | 1.8 | 2.7 | 3.1 |
| - Bujqësia | 2.1 | 3.0 | 3.0 (3.8 rishikuar) |
| - Ndërtimi | 8.7 | 11.3 | 10.6 |
| - Transporti | 9.7 | 10.8 | 10.1 |
| - Shërbimet | 5.1 | 6.4 | 6.4 |

Burimi: Ministria e Financave.

## II.2 EKONOMIA E VENDIT

Edhe gjatë këtij gjashtëmujori, informacioni statistikor i diponueshëm në funksion të analizës së ekonomisë reale vazhdoi të jetë i rrallë, duke e vështirësuar ndjeshëm aftësinë analizuese të Bankës së Shqipërisë. Informacioni jo vetëm që është i pakët, por për më tepër edhe periudha e bërjes publike të tij është me kohë vonesë nga mbyllja e periudhës së vrojtuar. Në këto rrethana, jemi detyruar të përdorim atë informacion të pakët që mund të disponojmë, i cili kryesisht konsiston në indeksin e shitjeve dhe në disa vlerësime të përgjithshme në lidhje me prodhimin bujqësor.

Aktiviteti ekonomik në vend ka shënuar një rritje të ndjeshme gjatë tremujorit të tretë të vitit. Vëllimi i shitjeve të sektorit jobujqësor ka patur një rritje të dukshme, qoftë kundrejt tremujorit paraardhës, qoftë kundrejt të njëjtit tremujor të vitit të kaluar. Si rezultat, indeksi i shitjeve gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2004, shënoi një rritje prej 4.7 për qind ndaj së njëjtës periudhë të vitit të kaluar, duke kompensuar rënien e vënë re në tremujorin e parë. Ngadalësimi në sektorin e industrisë është balancuar nga ecuria e mirë në sektorin e shërbimeve (tregtisë, hoteleve dhe restoranteve) dhe në atë të ndërtimit. Në veçanti, zhvillime pozitive vihen re në sektorin e shërbimeve dhe të ndërtimit, shitjet e të cilëve janë rritur respektivisht me 6.2 për qind dhe 7.1 për qind gjatë nëntë muajve të parë të vitit. Nga këndvështrimi makroekonomik, rritja ekonomike ka marrë jetë në kushtet e një stabiliteti relativ të ekulibrave të brendshëm dhe të jashtëm. Inflacioni ka qenë 2.9 për qind në nivel mesatar, afërsisht në mesin e intervalit objektiv të Bankës së Shqipërisë. Zhvillimet monetare kanë lëvizur brenda ekuilibrave të përcaktuar. Teprica e kredisë për ekonominë është rritur me rreth 30 për qind gjatë njëmbëdhjetë muajve të parë të vitit, duke u zhvendosur njëkohësisht drejt afateve më të gjata të maturimit. Ky zhvillim tregon për një mbështetje më të madhe të sistemit bankar në drejtim të rritjes së kapaciteteve prodhuese të ekonomisë shqiptare.

Leku ka patur përgjithësisht një tendencë mbiçmimi, të favorizuar nga rritja e besimit në monedhën vendase, nga normat pozitive të interesit dhe nga ulja e importeve të energjisë dhe produkteve bujqësore. Megjithatë, bilanci i pagesave ka shënuar zhvillime pozitive duke u shoqëruar me rritje të rezervës valutore të Bankës së Shqipërisë. Deficiti i bilancit tregtar në terma nominalë ka vazhduar të rritet, i ndikuar edhe nga nënçmimi i dollarit kundrejt euros. Gjithsesi, gjatë vitit 2004, eksportet kanë shënuar një rritje pothuaj dy herë më të lartë se importet, duke treguar një ecuri më të mirë të sektorit të jashtëm të ekonomisë.

Papunësia ka ardhur në rënie, ndërkohë që shpenzimet buxhetore deri në muajin nëntor kanë qenë brenda kufijve të parashikuar, duke mos rrezikuar rritjen e ofertës. Rritja e çmimit të naftës në tregun ndërkombëtar, ndonëse është

reflektuar në çmimin e naftës dhe të transportit në Shqipëri, nuk duket të ketë shkaktuar kosto shtesë të papërballueshme për biznesin dhe konsumatorin në vend.

Duke gjykuar nga zhvillimet e deritanishme, dhe në pritje të konfirmimeve të të dhënave të tremujorit të katërt, vlerësojmë se objektivi i rritjes me 6 për qind të ekonomisë shqiptare për vitin 2004 është arritur.

### II.2.1 ECURIA E SEKTORËVE TË EKONOMISË

Vëllimi i shitjeve në ekonomi[2] ka shënuar rritje gjatë tremujorit të tretë të vitit 2004. Indeksi i shitjeve për ekonominë ka shënuar një rritje prej 14.6 për qind ndaj tremujorit të dytë dhe rritje prej 9.1 për qind ndaj tremujorit të tretë të vitit të kaluar. Shitjet për nëntëmujorin e parë të vitit 2004 kanë qenë rreth 4.7 për qind më të larta se ato të së njëjtës periudhë të vitit të mëparshëm. Sektori me peshën më të madhe në shitjet e ekonomisë, ai i tregtisë, hoteleve dhe restoranteve, është zhvilluar me ritme të kënaqshme, duke shënuar rritje për të gjitha periudhat e krahasimit dhe duke ndikuar dukshëm ecurinë e shitjeve totale.

Duke ndjekur ecurinë e vitit të kaluar, edhe gjatë vitit 2004 është vënë re një rritje progresive e shitjeve nga tremujori në tremujor për të gjithë sektorët e ekonomisë.

#### *SEKTORI I INDUSTRISË*

Gjatë nëntë muajve të parë të vitit, shitjet në sektorin e industrisë, i përfaqësuar nga industria përpunuese, industria nxjerrëse dhe industria e prodhimit të energjisë, ujit dhe gazit, kanë qenë në të njëjtin nivel me vitin e kaluar. Prodhimi i energjisë elektrike është rritur me 7.1 për qind gjatë nëntë muajve të parë të vitit, ndërkohë që përdorimi i energjisë elektrike është rritur me 3.9 për qind. Përdorimi i energjisë elektrike nga konsumatorët jofamiljarë, është rritur me 10.3 për qind. Duke u nisur nga ecuria e mirë e prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike dhe në mungesë të të dhënave më të plota, gjykojmë se shitjet e këtij sektori kanë ardhur si pasojë e uljes së shitjeve të ujit dhe të gazit.

#### *SEKTORI I NDËRTIMIT*

Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2004 shitjet në sektorin e ndërtimit kanë shënuar një rritje prej

**Tabelë 3. Ecuria e shitjeve sipas sektorëve (në përqindje).**

| | Pesha e shitjeve (% ndaj totalit) | Janar – Shtator 2004/2003 | T3 '04 / T2 '04 | T3 '04 / T3 '03 |
|---|---|---|---|---|
| Ekonomia gjithsej | 100.0 | 4.7 | 14.6 | 9.1 |
| Industri | 26.0 | -0.6 | 3.0 | 0.0 |
| Ndërtim | 12.8 | 7.1 | 10.7 | 3.2 |
| Tregti, hotele, restorante | 44.0 | 6.2 | 23.7 | 18.0 |
| Transport dhe telekomunikacion | 11.8 | 5.0 | 17.8 | 1.8 |
| Të tjera | 5.5 | 15.1 | 3.3 | 14.7 |

*Burimi: INSTAT.

Grafik 3. Shitjet e sektoreve sipas tremujoreve.




*Burimi: INSTAT.

[2] Në këtë vlerësim nuk përfshihen shitjet e sektorit të bujqësisë.

rreth 11 për qind në krahasim me tremujorin e mëparshëm. Nivelin më të lartë të shitjeve këtë tremujor ky sektor e ka realizuar gjatë muajit gusht, me një rritje prej 25.3 për qind krahasuar me shitjet mesatare mujore të nëntëmujorit 2004. Rritja e shitjeve në tremujorin e tretë, ka bërë që shitjet në sektorin e ndërtimit, gjatë nëntë muajve të parë të vitit, të rriten me 7.1 për qind në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

### *Sektori i transportit dhe i telekomunikacionit*

Sektori i transportit dhe i telekomunikacionit ka regjistruar një rritje prej 5 për qind të vëllimit të shitjeve, gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2004, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Gjatë tremujorit të tretë, shitjet në këtë sektor janë rritur me 18 për qind në krahasim me tremujorin e kaluar. Vëllimi i punës në porte për periudhën e mësipërme është rritur me 7 për qind. Importet, të cilat përbëjnë peshën kryesore të vëllimit të mallrave në porte, janë rritur me 5 për qind, ndërsa eksportet me 29 për qind. Gjithsesi, vihet re se vëllimi i punës në transportin hekurudhor, për periudhën janar-nëntor 2004, ka pësuar një rënie të ndjeshme me 20 për qind në mallra dhe 16 për qind në udhëtarë, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

### *Sektori i bujqësisë*[3]

Viti 2004 është shoqëruar me zhvillime pozitive në drejtim të prodhimit bujqësor, blegtoral dhe agroindustrial. Sipas vlerësimeve të Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit, dega e bujqësisë pritet të rritet me 3.8 për qind gjatë vitit 2004 kundrejt parashikimit fillestar prej 2.9 për qind. Për pasojë, kontributi i rritjes së prodhimit të sektorit të bujqësisë në rritjen e PBB-së për vitin 2004 llogaritet të jetë rreth 1 pikë përqindjeje kundrejt vlerësimit fillestar për një kontribut prej 0.7[4] pikë përqindjeje.

Rritja më e madhe e prodhimit bujqësor është favorizuar nga kushtet e favorshme klimaterike si dhe është mbështetur në përmirësimin e teknologjisë së përdorur nga fermerët dhe në rritjen e investimeve (sidomos në sektorin e agroindustrisë). Prodhimi i bollshëm i perimeve dhe i bimëve të arave në vend në krahasim me vitin e kaluar, ka konkurruar importet dhe ka ndikuar në uljen e çmimeve të këtyre mallrave gjatë pjesës më të madhe të vitit.

Prodhimi agroindustrial, i cili përfaqëson rreth 20 për qind të prodhimit të përgjithshëm bujqësor të vendit, vlerësohet se është rritur me 12 për qind gjatë vitit 2004. Sipas vrojtimit të agroindustrisë për tremujorin e tretë, përpunimi i produkteve bujqësore është rritur ndjeshëm. Gjatë tremujorit të tretë është shtuar ndjeshëm prodhimi i konservimit të peshkut, të frutave dhe perimeve, i përpunimit të qumështit, si edhe prodhimi i vajit të ullirit, i pijeve alkolike, i proshutës dhe ujit e pijeve freskuese.

Megjithëse rritja e përpunimit të këtyre produkteve gjatë tremujorit të tretë shpjegohet me natyrën sezonale të prodhimit të tyre, prodhimi agroindustrial për tremujorin e tretë është rritur me 18.3 për qind në terma vjetorë, gjë që tregon ecurinë e mirë të kësaj dege.

**Tabelë 4. Prodhimi bujqësor për vitin 2004.**

| | Pesha në prodhimin e përgjithshëm bujqësor | Parashikimi korrik 2004/2003 (%) | Vlerësimi dhjetor 2004/2003 (%) |
|---|---|---|---|
| A. Bujqësia | 80 | 2.9 | 3.8 |
| A.1. Blegtoria | 37 | 4.3 | 4.9 |
| A.2. Bimët | 43 | 1.8 | 2.9 |
| B. Agroindustria | 19 | 10 | 12 |
| C. Peshkimi | 1 | 10.7 | 10.7 |
| Totali | 100 | 4.1 | 4.9 |

*Burimi: Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit

[3] Ky sektor përfshin degën e bujqësisë, të agroindustrisë dhe të peshkimit.
[4] Ky kontribut është llogaritur duke përdorur normën e rritjes prej 3 për qind dhe peshën e sektorit në PBB prej 21.8 për qind.

**Tabelë 5. Ecuria e prodhimit agroindustrial gjatë vitit 2004 (ndryshimi në %).**

| | T3'04 (në mld lekë) | T3/T3 2004/2003 | T3/T2 2004 |
|---|---|---|---|
| Prodhimi agroindustrial | 9.9 | 18.3 | 44.5 |
| Mish dhe nënprodukte të tij | 0.7 | 41.0 | 25.6 |
| Produkte të konservuara | 0.2 | 5.6 | 40.7 |
| Qumësht dhe nënprodukte të tij | 1.4 | 15.3 | -18.0 |
| Miell gruri dhe buke | 1.8 | -5.5 | 4.9 |
| Pije alkolike | 1.1 | 59.6 | 51.5 |
| Ujë dhe pije freskuese | 2.4 | 126.6 | 179.5 |
| Të tjera | 1.6 | -25.0 | 141.1 |

*Burimi: Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit.

### *II.2.2 SEKTORI FISKAL*

Politika fiskale dhe treguesit fiskalë kanë ecur përgjithësisht brenda kuadrit të programuar për periudhën janar-nëntor 2004. Sipas të dhënave të Ministrisë së Financave, deri në fund të muajit nëntor, janë mbledhur 92.2 për qind e të ardhurave dhe janë realizuar rreth 90 për qind e shpenzimeve të planifikuara për këtë periudhë.

Kjo ka bërë që deficiti buxhetor, në fund të muajit nëntor, të jetë rreth 24.8 miliardë lekë, nga 32 miliardë lekë të parashikuara. Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar (janar-nëntor) të ardhurat janë rritur me 11.3 për qind, shpenzimet janë rritur me 9.1 për qind, ndërsa deficiti buxhetor është ulur me 3.3 për qind. Në terma të PBB-së, të ardhurat buxhetore kanë ruajtur pothuajse të njëjtin nivel me atë të vitit të kaluar, afërsisht 21.7 për qind, ndërkohë që shpenzimet kanë arritur në nivelin 24.8 për qind të PBB-së, duke shënuar një ulje prej 0.7 pikë përqindjeje në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Kontrolli i shpenzimeve buxhetore dhe i deficitit buxhetor brenda niveleve të parashikuara ka bërë që presionet inflacioniste nga ana e sektorit fiskal të mos jenë të ndjeshme.

#### *TË ARDHURAT BUXHETORE*

Të ardhurat buxhetore kanë shënuar rritje në të gjithë komponentët e tyre gjatë periudhës janar–nëntor 2004. Niveli i të ardhurave tatimore, në fund të muajit nëntor, arriti në rreth 149.2 miliardë lekë, ndërsa tatimet e mbledhura nga doganat rezultuan rreth 111 miliardë lekë, duke realizuar respektivisht me 96.4 për qind dhe 97.7 për qind nivelin e parashikuar në buxhetin vjetor.

**Tabelë 6. Treguesit fiskalë (në miliardë lekë) dhe ndryshimi relativ (në përqindje).**

| | Korrik-Nëntor 2004 | Ndryshimi me 2003 | Janar – Nëntor 2004 | Ndryshimi me 2003 |
|---|---|---|---|---|
| Të ardhurat | 79.4 | 15.7 | 165.4 | 11.3 |
| Shpenzimet | 95.7 | 12.0 | 190.2 | 9.1 |
| Deficiti | 16.3 | -2.9 | 24.8 | -3.3 |

Burimi: Ministria e Financave.

Grafik 4. Struktura e të ardhurave buxhetore mujore (në miliardë lekë).




Burimi: Ministria e Financave.

Të ardhurat tatimore mbeten burimi kryesor i të ardhurave buxhetore. Ato përbëjnë 85 për qind të të ardhurave totale deri në muajin nëntor.

Ndryshe nga periudhat e mëparshme, tatimi mbi vlerën e shtuar tejkaloi nivelin e parashikuar duke u realizuar në masën 103.2 për qind. Gjithashtu, të ardhurat nga pushteti lokal janë realizuar në masën 85.4 për qind.

për qind. Megjithatë, ecuria e shpenzimeve kapitale pritet të ketë rritje të ndjeshme në muajin dhjetor dhe në vitin e ardhshëm, si pasojë e përdorimit të një pjese të të ardhurave të privatizimit të Bankës së Kursimeve për investime strategjike.

Shpenzimet korente përbëjnë (për periudhën janar – nëntor 2004) 90 për qind të shpenzimeve totale.

**Tabelë 7. Të ardhurat nga tatimet dhe doganat (në miliardë lekë).**

| | Nëntor | Plani | Realizimi (në %) | Plani vjetor |
|---|---|---|---|---|
| 1. Të ardhurat tatimore | 149.2 | 154.9 | 96.4 | 170.6 |
| 1.1 Tatimet dhe Doganat | 111.0 | 113.6 | 97.7 | 125.6 |
| - Tatimi mbi Vlerën e Shtuar | 53.3 | 51.6 | 103.2 | 57.2 |
| - Tatimi mbi fitimin | 14.7 | 13.8 | 106.2 | 15.2 |
| 2. Të ardhura nga pushteti lokal | 9.1 | 10.7 | 85.4 | 11.3 |
| 3. Të ardhura buxheti i pavarur | 29.1 | 30.6 | 95.1 | 33.7 |
| 4. Të ardhura jotatimore | 13.8 | 18.7 | 73.7 | 20.8 |

Burimi: Ministria e Financave.

### *Shpenzimet buxhetore*

Në lidhje me shpenzimet buxhetore, viti 2004 ka patur të njëjtën karakteristikë me vitin paraardhës: gjatë njëmbëdhjetë muajve të parë të vitit, shpenzimet korente janë realizuar në masën 97.7 për qind të planit, ndërkohë që shpenzimet kapitale janë realizuar vetëm në masën 67 për qind. Nga këto të fundit, shpenzimet e mbuluara me financim të huaj u realizuan në masën 48.3

### *Deficiti fiskal*

Deficiti fiskal, gjatë periudhës janar-nëntor, ishte afërsisht 77.5 për qind e nivelit të planifikuar. Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, deficiti fiskal ka patur një ulje prej 3.3 për qind.

Pjesa më e madhe e deficitit është financuar nga burimet e brendshme, kryesisht në formën e huamarrjes së brendshme.

Grafik 5. Struktura e shpenzimeve buxhetore (në milionë lekë).




Burimi: Ministria e Financave.

Grafik 6. Financimi i deficitit buxhetor për vitin 2004.




Burimi: Ministria e Finacave.

### II.2.3 TREGU I PUNËS

Treguesit e tregut të punës flasin për një ecuri pozitive të punësimit gjatë pjesës së dytë të vitit 2004. Si pasojë e emigrimit, viti 2004 rezulton me një ulje të numrit të forcave të punës dhe të punësimit. Gjatë tremujorit të tretë, numri i të punësuarve u rrit me 1 mijë vetë të tjerë të regjistruar. Edhe numri i të papunëve ka ardhur në rënie, duke e çuar normën e papunësisë nga 15 për qind në fillim të vitit në 14.6 për qind në tremujorin e tretë. E shprehur ndryshe, kjo do të thotë që numri i të papunëve është zvogëluar me 3 mijë vetë për periudhën në fjalë.

tremujorit të tretë) të numrit të të punësuarve në sektorin shtetëror. Ndryshimi i këtij raporti ka ardhur si rezultat i strukturimeve në ndërmarrjet shtetërore, të cilat kanë pakësuar numrin e të punësuarve të tyre, si dhe nga privatizimi i Bankës së Kursimeve, duke rritur numrin e të punësuarve në sektorin privat jobujqësor. Numri i të punësuarve në sektorin privat bujqësor ka mbetur i pandryshuar edhe për nëntëmujorin e parë të vitit 2004. Numri i të punësuarve në këtë sektor është 534 mijë vetë.

Ndryshimi i pagës minimale të miratuar në tremujorin e tretë të vitit 2004, nga 10060 lekë

**Tabelë 8. Treguesit e tregut të punës (në mijë vetë).**

| | 2002 | | | | 2003 | | | | 2004 | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Tr.I | Tr.II | Tr.III | Tr.IV | Tr.I | Tr.II | Tr.III | Tr.IV | Tr.I | Tr.II | Tr.III |
| Forcat e punës gjithsej (në mijë) | 1096 | 1093 | 1094 | 1094 | 1096 | 1093 | 1092 | 1091 | 1080 | 1081 | 1080 |
| A. Të punësuar gjithsej (në mijë) | 918 | 917 | 919 | 921 | 926 | 927 | 928 | 927 | 919 | 921 | 922 |
| i) në sektorin shtetëror | 189 | 188 | 187 | 187 | 185 | 185 | 184 | 182 | 179 | 179 | 177 |
| ii) në sektorin privat jo bujqësor | 6 | 203 | 206 | 208 | 207 | 208 | 210 | 211 | 206 | 208 | 211 |
| iii) në sektorin privat bujqësor | 526 | 526 | 526 | 526 | 534 | 534 | 534 | 534 | 534 | 534 | 534 |
| B. Papunësia (në mijë) | | | | | | | | | | | |
| i) të papunë gjithsej | 178 | 176 | 175 | 173 | 170 | 166 | 164 | 164 | 161 | 160 | 158 |
| ii) përfitojnë pagesë papunësie | 13 | 13 | 12 | 11 | 11 | 11 | 11 | 11 | 11.7 | 12.3 | 12 |
| C. Shkalla e papunësisë (në %) | 16.2 | 16.1 | 16.0 | 15.8 | 15.5 | 15.2 | 15.0 | 15.0 | 14.9 | 14.8 | 14.6 |

*Burimi: INSTAT, Konjuktura, shtator 2004.

Në strukturën e punësimit sipas sektorëve, vëmë re një rritje të vazhdueshme të numrit të të punësuarve në sektorin privat jobujqësor gjatë vitit 2004, dhe një ulje (e vërejtur më tepër gjatë

në 10080 lekë, është reflektuar dhe në rritjen e pagës mesatare në sektorin shtetëror me 3 për qind. Gjithashtu, pagesa e papunësisë është rritur në masën 4360 lekë.

### II.2.4 SEKTORI I JASHTËM I EKONOMISË

Bilanci i pagesave e ka mbyllur tremujorin e tretë me një bilanc pozitiv. Rezervat valutore janë rritur me rreth 95 milionë usd gjatë këtij tremujori. Deficiti korent ishte rreth 26 milionë usd, ndërkohë që bilanci i llogarisë kapitale dhe financiare ishte pozitiv (rreth 30 milionë usd). Deficiti tregtar ka ardhur në rritje në krahasim me dy tremujorët e parë të vitit si edhe në krahasim me tremujorin e tretë të vitit të kaluar. Megjithatë, deficiti korent në tremujorin e tretë ka qenë më i ulët se në tremujorët paraardhës të vitit, falë bilanceve pozitive dhe të rritura të të ardhurave, të shërbimeve dhe të transfertave korente.

siguruar rreth 70 për qind të të ardhurave të përgjithshme dhe kanë përfaqësuar 60 për qind të shpenzimeve për shërbime. Të ardhurat nga udhëtimet e jorezidentëve në Shqipëri për tremujorin e tretë (rreth 190 milionë usd) janë rritur me 14 për qind në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, ndërkohë që shpenzimet e udhëtarëve rezidentë jashtë kanë rënë me rreth 20 për qind, duke qëndruar në nivelin 130 milionë usd. Shërbimet e transportit, ndonëse kanë qenë në nivele më të ulëta sesa ato të udhëtimit, kanë regjistruar rritje si në krahun e hyrjeve ashtu edhe në atë të daljeve në krahasim me tremujorin e tretë të vitit të kaluar. Rritje është vërejtur gjithashtu në të ardhurat nga

**Tabelë 9. Bilanci i pagesave (në milionë usd).**

| | T1'04 | T2'04 | T3'04 | Jan- Shta '04 | Jan- Shta '03 |
|---|---|---|---|---|---|
| A.Llogaria korente | -77.9 | -108.4 | -25.7 | -212.1 | -261.2 |
| A.1. Mallrat | -317.9 | -358.0 | -405.8 | -1081.7 | -957.6 |
| A.2. Shërbimet | -6.1 | 0.7 | 27.1 | 21.7 | -44.1 |
| A.3. Të ardhurat | 36.3 | 32.1 | 59.4 | 127.8 | 133.2 |
| A.4. Transfertat korente | 209.9 | 216.9 | 293.6 | 720.4 | 607.3 |
| B. Llogaria kapitale | 34.0 | 25.7 | 33.6 | 93.3 | 113.1 |
| C. Llogaria financiare | 22.9 | 203.2 | -4.3 | 221.8 | 124.8 |
| D. Mjetet e rezervës | -14.9 | -117.4 | -95.3 | -227.6 | -78.5 |
| E. Gabime dhe harresa | 29.9 | -3.0 | 85.9 | 112.8 | 90.7 |

Burimi: Banka e Shqipërisë.

#### *LLOGARIA KORENTE*

Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2004 të ardhurat në llogarinë korente të Shqipërisë kanë qenë 787 milionë dollarë ndërsa shpenzimet 813 milionë dollarë. Në këtë periudhë kanë hyrë në formë pagesash korente rreth 38 për qind e pagesave të të gjithë nëntëmujorit të parë, ndërkohë që shpenzimet kanë patur një shpërndarje më të njëtrajtshme, duke përfaqësuar 36 për qind të shpenzimeve të nëntëmujorit. Ky tremujor përgjithësisht karakterizohet nga importe mallrash më të larta se dy tremujorët e parë të vitit, nga eksporte mallrash më të ulëta, si edhe nga hyrje/dalje më të larta në kategorinë e shërbimeve. Transfertat korente hyrëse gjithashtu regjistrojnë rritje gjatë tremujorit të tretë, për shkak të rritjes së numrit të emigrantëve që kthehen për pushime.

Në kategorinë e shërbimeve, peshën më të madhe vazhdojnë ta mbajnë shërbimet e udhëtimit, të cilat si për tremujorin e tretë, ashtu edhe për të gjithë nëntëmujorin janar-shtator kanë

shërbime të tjera, ndërkohë që pagesat për këto shërbime kanë mbetur në nivelin e vitit të kaluar.

Bilanci pozitiv i të ardhurave nga puna (60 milionë usd) është rritur me rreth 10 milionë usd në krahasim me tremujorin e tretë të vitit të kaluar.

Në këtë kategori, peshën më të madhe e mbajnë të ardhurat nga kompensimi i punonjësve, të cilat për tremujorin e tretë janë vlerësuar 48 milionë usd. Flukset e të ardhurave nga investimet e portofolit, të rezervës dhe nga investime të tjera nuk kanë shënuar ndryshime në krahasim me tremujorin e tretë të vitit të kaluar.

Bilanci në kategorinë e transfertave korente vlerësohet të jetë rreth 294 milionë usd, duke qenë më i lartë se në dy tremujorët e parë dhe rreth 44 për qind më i madh se ai i tremujorit të tretë të vitit të kaluar. Prurjet nga emigrantët (282 milionë usd) janë shoqëruar edhe nga transferta në formë të asistencës teknike (7 milionë usd), të mallrave (5 milionë usd) dhe të transfertave të tjera (22 milionë usd).

*LLOGARIA KAPITALE DHE FINANCIARE*

Llogaria kapitale për tremujorin e tretë të vitit 2004 ka shënuar flukse hyrëse neto prej 34 milionë usd, duke mos paraqitur ndryshim të madh në krahasim me tremujorët e mëparshëm. Bilanci i llogarisë financiare tregon se hyrjet financiare neto gjatë tremujorit të tretë kanë qenë pothuajse zero. Pretendimet e rezidentëve ndaj jorezidentëve janë rritur po aq sa detyrimet e rezidentëve (përkatësisht 124 dhe 126 milionë usd). Në anën e mjeteve është regjistruar një pakësim prej rreth 120 milionë usd i zotërimeve në formën e investimeve të portofolit, ndërkohë që janë rritur me 234 milionë usd depozitat e sistemit tonë bankar jashtë. Nga ana e detyrimeve, Shqipëria ka tërhequr rreth 72 milionë usd në formë investimesh direkte dhe rreth 32 milionë usd në formë borxhi zyrtar dhe privat. Detyrimet e rezidentëve ndaj jorezidentëve janë rritur edhe si pasojë e huamarrjes në formë kredish afatgjata dhe të atyre të buta nga jashtë, të cilat e kanë shtuar borxhin e jashtëm të Shqipërisë me 160 milionë usd. Për nëntëmujorin e parë të vitit 2004 huamarrja e re private (75 milionë usd) është rreth 5.5 herë më e lartë në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2003. Shifrat e reja të borxhit privat janë përftuar edhe si pasojë e një bashkëpunimi më të ngushtë me institucionet kredidhënëse që kanë mbështetur në vite biznesin shqiptar. Shërbimet e borxhit të jashtëm në formën e pagesave të principalit, gjatë periudhës arritën në 31 milionë usd. Flukset hyrëse të mjeteve valutore në formën e kapitaleve financiare janë reflektuar në rritje të rezervave valutore të autoritetit monetar, me rreth 228 milionë usd. Niveli i rezervave valutore bruto, në fund të periudhës, u vlerësua në 1 miliardë e 244 milionë usd, i mjaftueshëm për të përballuar 5.1 muaj importe mallrash dhe shërbimesh.

# III. INFLACIONI GJATË PERIUDHËS KORRIK - DHJETOR

## III.1 ECURIA E INFLACIONIT DHE E GRUPEVE PËRBËRËSE

Pjesa e dytë e vitit 2004 u karakterizua nga një inflacion i ulët, brenda objektivit të Bankës së Shqipërisë prej 2 – 4 për qind. Inflacioni vjetor në muajin dhjetor rezultoi 2.2 për qind, ndërsa inflacioni mesatar vjetor ishte 2.9 për qind. Respektimi i objektivit të inflacionit përpos të tjerash është reflektim i situatës së qëndrueshme makroekonomike, i kontrollit të kërkesës së brendshme të ekonomisë dhe i stabilitetit të treguesve monetarë.

**Tabelë 10. Norma vjetore e inflacionit (në për qind).**

| | 2000 | 2001 | 2002 | 2003 | 2004 |
|---|---|---|---|---|---|
| Janar | -1.3 | 2.2 | 6.5 | 0.0 | 3.3 |
| Shkurt | -1.3 | 1.5 | 7.6 | 1.1 | 4.4 |
| Mars | -2.1 | 2.9 | 7.5 | 1.3 | 4.0 |
| Prill | -1.4 | 3.0 | 6.5 | 2.3 | 3.2 |
| Maj | -0.1 | 2.5 | 4.6 | 2.8 | 2.6 |
| Qershor | 0.1 | 4.0 | 3.7 | 2.6 | 2.9 |
| Korrik | -1.3 | 5.6 | 4.2 | 3.0 | 3.1 |
| Gusht | -0.7 | 4.1 | 5.5 | 3.0 | 2.7 |
| Shtator | 0.9 | 3.5 | 5.3 | 2.8 | 2.0 |
| Tetor | 1.8 | 1.8 | 5.8 | 2.9 | 2.0 |
| Nëntor | 1.9 | 2.8 | 3.7 | 3.4 | 2.2 |
| Dhjetor | 4.2 | 3.5 | 1.7 | 3.3 | 2.2 |
| Mesatar | 0.1 | 3.1 | 5.2 | 2.2 | 2.9 |

*Burimi: INSTAT.

Në përputhje me paralajmërimet më të hershme të Bankës së Shqipërisë, gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit të kaluar u vërtetua ecuria në rënie e çmimeve të produkteve bujqësore, duke përforcuar gjithnjë e më shumë bindjen se prodhimi i brendshëm bujqësor i këtij viti ka qenë më i lartë në raport me vitet e mëparshme.

Në lidhje me këtë ndikim, mbetet që të verifikohet në të ardhmen nëse kishim të bënim me një vit të veçantë, suksesi i të cilit u bazua në kushtet

atmosferike dhe në rrethana të tjera rastësore apo nëse kemi të bëjmë me shtim të investimeve në sera dhe në teknikë bujqësore. Nëse do të verifikohet kjo e dyta, atëherë mund të konkludohet se sjellja tipike sezonale e verifikuar në të kaluarën do të ndryshojë sadopak, duke i dhënë një shans më shumë sheshimit të kurbës mujore të inflacionit.

Efekti i zgjatur i uljes së çmimeve bujqësore ka qenë mëse i mjaftueshëm për të absorbuar ndikimet rritëse që shoqëruan rritjen e çmimit të naftës dhe efektet e vonuara të ndryshimeve të çmimeve të administruara (rritja e çmimit të energjisë elektrike dhe të telefonisë fikse, përkatësisht në muajt janar dhe prill).

Grafiku 8, pasqyron në mënyrë më të detajuar kontributin që çdo grup i shportës së çmimeve ka dhënë në formimin e inflacionit vjetor.

Duke u ndalur më në detaje në ecurinë e zërave kryesorë të shportës do të evidentonim:

- Grupi "Ushqime dhe pije joalkolike" ka shënuar norma vjetore negative për periudhën maj–nëntor 2004, zhvillim i cili është diametralisht i kundërt në raport me të shkuarën. Megjithatë, ajo që bie në sy ka të bëjë me faktin se kontributi i këtij grupi ka qenë në ulje të vazhdueshme. Pesha e madhe e këtij grupi vazhdon t'i japë inflacionit "fytyrën" e tij. Në sajë të peshës së madhe (42.6 për qind) që ka ky grup në shportën e çmimeve

Grafik 7. Inflacioni vjetor (në për qind).




Burimi: Banka e Shqipërisë, INSTAT.

Grafik 8. Kontributi i grupeve kryesore të shportës së IÇK-së (në pikë përqindjeje).




Burimi: Banka e Shqipërisë, INSTAT.

të konsumit, ai ndikon ndjeshëm në vlerën e inflacionit total. Dinamika që ka karakterizuar zhvillimin ekonomik të vendit këto 3 – 4 vitet e fundit, ndërmjet të tjerash ka prekur dhe sjelljen e konsumatorit shqiptar, një konstatim ky që ndoshta do të imponente ndryshime në kompozimin e shportës së çmimeve. Pavarësisht faktit se ende Shqipëria konsiderohet si vend i varfër përsëri sjellja e konsumatorit gjykohet të jetë në ndryshim të pandërprerë, sigurisht në drejtim të një strukture tipike për shoqëritë e konsumit. Një ulje e peshës së këtij grupi do të zbuste luhatjet e mëdha të indeksit të çmimeve nga njëri muaj në tjetrin, ndërkohë që ndryshime të mundshme mund të ketë pësuar edhe vetë struktura e këtij grupi.

- Indeksi i çmimeve të grupit "Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji" është rritur sistematikisht gjatë gjithë vitit 2004. Rritja e tarifës së energjisë elektrike, në muajin janar 2004, pati efekt të drejtpërdrejtë në kahun rritës, duke kontribuar mesatarisht me 2.3 pikë përqindjeje në normën vjetore të inflacionit (tabela 12).

- Vendimet për rritjen e çmimit të administruar të telefonisë fikse me 68.8 për qind në muajin dhjetor 2003 dhe më pas reduktimi i tij me 28.5 për qind në prill 2004, ndikuan inflacionin e grupit "Komunikimi". Pas këtij reduktimi, kontributi i grupit në inflacionin vjetor total u ul nga 0.7 pikë përqindjeje, në periudhën dhjetor 2003 – mars 2004, në 0.2 pikë përqindjeje në periudhën prill–nëntor 2004. Në muajin dhjetor, kontributi i këtij grupi ishte negativ prej -0.46 pikë përqindjeje, duke reflektuar faktin që norma vjetore e inflacionit nuk ndikohet më nga rritja e tarifës në muajin dhjetor 2003.

**Tabelë 11. Norma vjetore e inflacionit dhe kontributi i grupit "Ushqime dhe pije joalkolike" në inflacionin total.**

| | Inflacioni vjetor 2003 | Kontributi (pp) | Inflacioni vjetor 2004 | Kontributi (pp) |
|---|---|---|---|---|
| Korrik | 6.2 | 2.56 | -0.1 | -0.05 |
| Gusht | 5.6 | 2.33 | -1.4 | -0.58 |
| Shtator | 5.3 | 2.21 | -2.9 | -1.25 |
| Tetor | 4.3 | 1.82 | -2.2 | -0.94 |
| Nëntor | 4.8 | 2.01 | -1.6 | -0.70 |
| Dhjetor | 2.7 | 1.20 | 0.3 | 0.12 |

Burimi: Banka e Shqipërisë, INSTAT.

**Tabelë 12. Norma vjetore e inflacionit dhe kontributi i grupit "Qira, ujë, lëndë djegëse, energji" në inflacionin total.**

| | Inflacioni vjetor 2003 | Kontributi (pp) | Inflacioni vjetor 2004 | Kontributi (pp) |
|---|---|---|---|---|
| Korrik | 0.4 | 0.10 | 9.9 | 2.39 |
| Gusht | 1.6 | 0.39 | 9.7 | 2.37 |
| Shtator | 1.0 | 0.23 | 10.4 | 2.49 |
| Tetor | 2.8 | 0.68 | 9.2 | 2.24 |
| Nëntor | 3.8 | 0.91 | 9.2 | 2.22 |
| Dhjetor | 4.1 | 0.95 | 8.8 | 2.08 |

Burimi: Banka e Shqipërisë, INSTAT.

Grafik 9. Inflacioni vjetor i 4 grupeve kryesore të shportës së IÇK-së (në për qind).



Burimi: Banka e Shqipërisë, INSTAT.

- Inflacioni i grupeve të tjera të shportës së IÇK-së u luhat në mënyrë të moderuar gjatë këtij gjashtëmujori. Ulje të inflacionit vjetor ka shënuar grupi "Veshje dhe këpucë", ndërsa rritje kanë shënuar grupet "Hotele, kafene dhe restorante" dhe "Shërbimi arsimor".

## III.2 AMBIENTI MAKROEKONOMIK DHE ÇMIMET E KONSUMIT

Ruajtja e inflacionit në nivele të ulëta është pa dyshim një rezultat i kushteve të favorshme makroekonomike dhe i politikave të përshtatshme dhe të kujdesshme monetare dhe fiskale, megjithë zhvillimet e favorshme në prodhimin bujqësor dhe çmimet e mallrave ushqimorë.

Viti 2004 u karakterizua nga respektimi i objektivave fiskalë në drejtim të shpenzimeve buxhetore dhe deficitit buxhetor, si dhe nga një shpërndarje më e njëtrajtshme e shpenzimeve buxhetore. Kërkesa e qeverisë për hua ka ardhur në rritje gjatë gjashtëmujorit të dytë, por duke mbetur gjithsesi brenda niveleve të parashikuara. Gjithashtu, norma vjetore e ndryshimit të shpenzimeve buxhetore korente ka qenë e qëndrueshme. Zbatimi i një politike fiskale të matur ka krijuar kushte për kontrollimin më të mirë të normës së inflacionit.

Politika monetare e Bankës së Shqipërisë ka ruajtur kahun zbutës edhe gjatë gjashtëmujorit të dytë, duke synuar uljen e kostos së huamarrjes në ekonomi. Megjithatë, norma e ulët e inflacionit

Grafik 10. Ndryshimi vjetor i shpenzimeve korente.




Burimi: Ministria e Financave.

ka siguruar një normë reale pozitive të interesit duke mundësuar thithjen e depozitave në sistemin bankar dhe duke ruajtur raportet e likuiditetit në sistem. Lehtësimi i politikës monetare është realizuar pa cënuar ekuilibrat monetarë. Gjashtëmujori i dytë i këtij viti është karakterizuar nga ritme më të larta të rritjes së agregatëve monetarë, por pa përcjellë në ekonomi presione inflacioniste.

Grafik 11. Ndryshimet vjetore të agregatëve monetarë M1 dhe M3 (në përqindje).




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Një faktor i rëndësishëm në ecurinë e moderuar të inflacionit ka qenë edhe mbiçmimi i vazhdueshëm i lekut ndaj euros dhe dollarit[5]. Në një farë mase, mbiçmimi i lekut gjatë muajve të verës i detyrohet të njëjtëve faktorë që kanë ndikuar në normën e ulët të inflacionit gjatë kësaj periudhe: zhvendosjes së importeve në treg nga rritja e prodhimit vendas. Gjithsesi, mbiçmimi i lekut, i kombinuar dhe me normat e ulëta të inflacionit në shtetet partnere, ka sheshuar impulset inflacioniste që gjenerohen nga inflacioni i importuar[6].

Tabelë 13. Inflacioni vjetor i vendeve kryesore partnere (në përqindje).

| | Maj | Qershor | Korrik | Gusht | Shtator | Tetor | Nëntor |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Greqi | 3.1 | 3.0 | 3.1 | 2.8 | 2.9 | 3.3 | 3.2 |
| Itali | 2.3 | 2.4 | 2.2 | 2.4 | 2.1 | 2.1 | 2.0 |

Burimi: Eurostat News Release.

Nga ana tjetër, faktorët e ofertës nuk kanë sjellë presione të ndjeshme në rritjen e çmimeve të konsumit. Ndikimi i rritjes së çmimit të naftës në tregun vendas ishte i moderuar. Rritja e çmimit të naftës në tregjet e huaja me rreth 29.7 për qind gjatë periudhës gusht - tetor 2004, u reflektua në rritjen e inflacionit të grupit "Transport" në 4.1 për qind. Megjithatë, mbiçmimi i vazhdueshëm i lekut ndaj dollarit ka zbutur efektin në inflacion të rritjes së çmimit të naftës në tregjet botërore[7]. Nga ana tjetër, përshtatja e kërkesës së brendshme[8] për këtë produkt bëri që çmimi në vend të mos reflektonte rritjen e plotë të tij.

Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2004, Indeksi i Çmimeve të Prodhimit shënoi rritje në terma vjetorë dhe tremujorë[9]. Teorikisht, rritja e Indeksit të Çmimeve të Prodhimit në kuadrin e rritjes së përdorimit të kapacitetit, sinjalizon rrezikun e kalimit të kostove në çmimet e konsumit. Megjithatë, kjo ende nuk është vërtetuar dhe në pamundësi të analizave empirike në këtë drejtim ende nuk mund të konkludohet nëse ky kalim do të verifikohet në një kohë të dytë apo jo. Mospërcjellja e këtij efekti në çmimet e konsumit, mund të jetë një indikator i faktit që në ekonominë shqiptare ka ende kapacitete të papërdorura. Gjithashtu, rritja e konkurrencës në ekonomi ka ushtruar një ndikim kufizues në rritjen e çmimeve të konsumit.

[5] Leku është mbiçmuar me 13.2 për qind ndaj dollarit dhe 5.3 për qind ndaj euros në nivel vjetor.
[6] Një presion inflacionist i tillë ishte rritja e çmimit të naftës.
[7] Gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2004 leku është mbiçmuar me rreth 8.2 për qind.
[8] Konsumi i naftës në vend për tremujorin e tretë 2004, është zvogëluar me 14.5 për qind në nivel vjetor dhe me 40 për qind ndaj tremujorit paraardhës. Burimi: INSTAT, Konjuktura për tremujorin e tretë të vitit 2004.
[9] Burimi: INSTAT, IÇP. Rritja e IÇP-së ndaj tremujorit paraardhës ishte 1.26 për qind, ndërsa ndaj vitit të kaluar 13.53 për qind.

Grafik 12. Ecuria e Indeksit të Çmimeve të Prodhimit gjatë viteve 2003 dhe 2004.




Burimi: INSTAT.

Po kështu, rritja e lehtë e pagës në sektorin publik, si dhe ulja në normën e papunësisë[10] nuk sollën ndryshime të rëndësishme në dinamikën e konsumit duke mos dhënë presione të ndjeshme inflacioniste.

Respektimi i objektivit të inflacionit nga Banka e Shqipërisë për vitin 2004, ka dhënë një kontribut pozitiv në zhvillimin e ekonomisë shqiptare, duke ndikuar në ruajtjen e ekuilibrave makroekonomikë.

# IV. ZHVILLIMET MONETARE DHE TREGJET FINANCIARE

## IV.1 POLITIKA MONETARE E BANKËS SË SHQIPËRISË

Banka e Shqipërisë ka vijuar të ndjekë një politikë monetare zbutëse gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2004. Kjo politikë është kushtëzuar nga zhvillimet pozitive makroekonomike, në inflacion dhe në treguesit monetarë. Gjatë gjashtëmujorit të dytë, norma e inflacionit vjetor është luhatur në bandën e poshtme të objektivit 2-4 për qind, ndërkohë që pritjet për inflacionin kanë qenë të stabilizuara në nivele të ulëta.

Prodhimi bujqësor i kënaqshëm dhe tendencat mbiçmuese të monedhës vendase gjatë vitit 2004, kanë kufizuar presionet inflacioniste nga ana e ofertës në gjysmën e dytë të vitit. Inflacioni i ulët që ka rezultuar, ka sjellë normën reale të interesit në nivelet e mëparshme edhe pas uljes së normës bazë të interesit.

Nga ana tjetër, megjithëse ndryshimi vjetor i M1 real ka kaluar në kahun pozitiv, duke shfaqur tendenca rritëse, norma e rritjes vjetore të tij mbetet e ulët në krahasim me mesataren historike. Raporti i parasë jashtë bankave ndaj ofertës monetare ka qenë i stabilizuar rreth mesatares 26.1 për qind gjatë periudhës njëmbëdhjetëmujore.

Ndërkohë, raporti i kërkesës dhe ofertës për mjete monetare në lekë, M2, ka qenë i zhvendosur në drejtim të kërkesës, duke favorizuar mbiçmimin e lekut gjatë kësaj periudhe dhe duke ndihmuar në kontrollin e presioneve inflacioniste.

[10] Të dhënat marrë nga INSTAT për tremujorin e tretë të vitit 2004.

Grafik 13. Treguesit kryesorë monetarë.




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Zhvillimet në treguesit monetarë dhe pritjet pozitive për ecurinë e inflacionit, krijuan kushte për vazhdimin e politikës monetare zbutëse edhe gjatë pjesës së dytë të vitit 2004. Banka e Shqipërisë uli dy herë normën bazë të interesit, në muajt korrik dhe nëntor, me nga 0.25 pikë përqindje. Këto ulje e sollën normën bazë të interesit në nivelin më të ulët historik të saj, 5.25 për qind.

Gjithashtu, në kuadër të politikës monetare lehtësuese, Banka e Shqipërisë ka ndryshuar formën e ankandit për tërheqjen e likuiditetit të tepërt të sistemit gjatë tremujorit të tretë, në ankand me shumë çmime. Reagimi i bankave ndaj këtyre lëvizjeve të politikës monetare ka qenë i kënaqshëm. Në sajë të diferencës kohore të përcjelljes së efektit, ndryshimet e interesave të bonove të thesarit përfshijnë reagimin e

Grafik 14. Norma bazë e interesit.




Burimi: Banka e Shqipërisë.

bankave edhe ndaj uljeve të normës bazë të realizuara në gjysmën e parë të vitit.

Politika e ndjekur dhe operacionet e ndërmarra nga Banka e Shqipërisë kanë bërë të mundur respektimin e objektivave sasiorë të saj.

**Tabelë 14. Reagimi i sistemit pas dy uljeve të fundit të normës bazë* (në pikë përqindje).**

| | 3-mujore | 6-mujore | 12-mujore |
|---|---|---|---|
| Depozita | (0.31) | (0.51) | (0.60) |
| Bono thesari | (0.73) | (0.96) | (0.90) |

*Ndryshimi përfshin periudhën 28.07.2004.
Burimi: Banka e Shqipërisë.

Politika monetare zbutëse e Bankës së Shqipërisë ka ndihmuar edhe në zbutjen e presioneve mbiçmuese të kursit të këmbimit të lekut. Diferencat midis interesave në valutë dhe atyre në lekë kanë pësuar rënie gjatë vitit 2004. Megjithatë, hyrjet valutore në rritje nga njëra anë dhe ulja e importeve nga ana tjetër, kanë krijuar një diferencë të përkohshme midis ofertës dhe kërkesës për valutë gjatë muajve të verës. Ky zhbalancim ka ushtruar presion të dukshëm për mbiçmimin e kursit të këmbimit të lekut, duke rritur edhe luhatshmërinë në tregjet valutore.

Luhatshmërita e kursit të këmbimit, në sajë të kësaj rritjeje të përkohshme të ofertës valutore, ka diktuar nevojën e ndërhyrjes së Bankës së Shqipërisë në tregun valutor gjatë muajve të verës, në kahun e blerjes së valutës.

Gjatë muajve korrik-gusht, janë tërhequr nga tregu i brendshëm valutor rreth 35.3 milionë euro dhe rreth 17.5 milionë usd, duke gjeneruar 6.2 miliardë lekë në treg. Kërkesa në rritje për likuiditet ka bërë që Banka e Shqipërisë të mos sterilizojë këto ndërhyrje nëpërmjet shitjes me të drejta të plota të bonove të thesarit.

## IV.2 ECURIA E AGREGATËVE MONETARË

Zhvillimet monetare, gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2004, kanë ecur përgjithësisht sipas programit monetar të Bankës së Shqipërisë. Duke reflektuar edhe ecurinë pozitive të ekonomisë në këtë periudhë, ekuilibrat monetarë të vendosur në gjashtëmujorin e parë janë ruajtur, ndërkohë që kërkesa e ekonomisë për mjete monetare dhe agregatët monetarë kanë shënuar rritje. Norma e rritjes vjetore të ofertës monetare në muajin nëntor arriti në 10.5 për qind, nga 7.4 për qind që ishte në muajin qershor. Rritja e ofertës monetare gjatë kësaj periudhe është mbështetur në rritjen e të dy përbërësve të saj, agregatit M2 dhe depozitave në valutë. Zhvillimet në strukturën kohore dhe valutore të ofertës monetare tregojnë një tendencë stabilizimi. Gjatë periudhës qershor-nëntor, raporti i parasë jashtë bankave ndaj M3 është luhatur në nivele pothuajse konstante, ndërsa raporti i depozitave në valutë ndaj ofertës monetare është stabilizuar në nivele të larta historike.

**Tabelë 15. Realizimi i objektivave sasiorë të Bankës së Shqipërisë.**

| | Dhjetor '03 | Mars 04 | Qershor 04 | Shtator '04 | Nëntor '04 |
|---|---|---|---|---|---|
| Rezerva ndërkombëtare neto (në milionë dollarë) | | | | | |
| Objektivi | 715.8 | 751.8 | 765.8 | 923.7 | 935.7 |
| Aktuale | 832.7 | 827.6 | 961.5 | 1043.6 | 1060.8 |
| Diferenca | 116.8 | 75.8 | 195.7 | 119.9 | 125.1 |
| Mjetet e brendshme neto (në miliardë lekë) | | | | | |
| Objektivi | 96.0 | 83.0 | 85.0 | 70.0 | 74.0 |
| Aktuale | 72.0 | 66.4 | 54.7 | 55.4 | 56.7 |
| Diferenca | -24.0 | -16.6 | -30.3 | -14.5 | -17.2 |
| Kredia e brendshme neto për qeverinë (në miliardë lekë) | | | | | |
| Objektivi | 280.9 | 272.8 | 270.1 | 279.1 | 282.4 |
| Aktuale | 266.8 | 272.6 | 263.6 | 272.0 | 276.2 |
| Diferenca | 0.0 | -0.2 | -6.5 | -7.1 | -6.3 |

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 15. Ecuria e normave vjetore të agregatëve monetarë.




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Ecuria sipas parashikimeve e kërkesës për para të qeverisë dhe të ekonomisë gjatë kësaj periudhe, si dhe injektimi i likuiditetit nëpërmjet blerjeve valutore të Bankës së Shqipërisë në muajt e verës, janë reflektuar në ritme më të larta të rritjes së agregatit M2. Kjo rritje është reflektuar si në rritjen e parasë jashtë bankave ashtu dhe të depozitave në lekë, duke stabilizuar rritjen vjetore të dy komponentëve dhe peshat e tyre në ofertën monetare. Gjashtëmujori i dytë i vitit shënoi rikthimin e ritmeve vjetore të rritjes së parasë jashtë bankave në nivele pozitive. Në muajin nëntor, norma vjetore e rritjes së parasë jashtë bankave arriti në 6.8 për qind, nga -0.5 për qind që ishte në muajin qershor, duke reflektuar stabilizimin e strukturës kohore të ofertës monetare, pas një periudhe të gjatë zhvendosjeje të saj drejt mjeteve më afatgjata.

Raporti i parasë jashtë bankave ndaj M3 në muajin nëntor shënoi nivelin 26.0 për qind, duke mbetur pothuajse i pandryshuar nga niveli i tij në fund të gjashtëmujorit të parë. Kjo qëndrueshmëri, reflekton kryesisht stabilitetin financiar të arritur dhe praninë e normave pozitive të interesit real në vazhdimësi gjatë dy viteve të fundit. Megjithë uljet e njëpasnjëshme të normës bazë të interesit, normat e interesit të depozitave në lekë kanë mbetur në nivele të pranueshme, duke ruajtur të qëndrueshëm raportin e parasë jashtë bankave ndaj M3.

Ecuria e depozitave në lekë gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit ka patur tendencë stabilizimi, duke shënuar edhe një trend të lehtë rritës. Në muajin nëntor, depozitat në lekë shënuan një rritje vjetore prej 10.5 për qind. Ecuria e kënaqshme e tyre

Grafik 16. Raporti i PjB ndaj M3 dhe norma mesatare e interesit real.




Burimi: Banka e Shqipërisë.

është rezultat i rritjes së kërkesës për mjete monetare në lekë dhe rritjes së besimit në monedhën vendase. Diferencat pozitive midis normave reale të interesit në lekë dhe në valutë, kanë krijuar një preferencë për instrumentet e investimit në lekë (depozita dhe bono thesari). Kështu, edhe portofoli i bonove të thesarit të individëve, në gjashtëmujorin e dytë të vitit, ka shënuar një rritje me 2.4 miliardë lekë, rritje e cila është rreth 43 për qind më e lartë në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Tendenca në rritje e normave vjetore të rritjes së parasë jashtë bankave dhe depozitave pa afat në lekë, është reflektuar në ritme më të larta të rritjes së agregatit M1. Norma e rritjes vjetore të këtij treguesi, në muajin nëntor, arriti në 10.5 për qind[11], nga 1.3 për qind që ishte në fund të gjashtëmujorit të parë. Me stabilizimin e strukturës kohore të ofertës monetare, ritmi vjetor i rritjes së agregatit M1 është përafruar me mesataren e tij historike, në linjë me ritmin e rritjes së ofertës së përgjithshme monetare.

Hyrjet e konsiderueshme të valutës në sezonin e verës, në prani të një kursi të qëndrueshëm këmbimi gjatë periudhës korrik-nëntor[12], kanë sjellë rritje më të larta vjetore të depozitave në valutë. Në muajin nëntor, rritja vjetore e depozitave në valutë ishte 15 për qind kundrejt 12.6 për qind në muajin qershor.

Nga ana tjetër, mbiçmimi i kursit të këmbimit të lekut vazhdon të reduktojë rritjen e depozitave në valutë, të shprehur në terma të lekut. Në mungesë të këtij efekti, norma e rritjes vjetore të depozitave në valutë gjatë 5 muajve të fundit do të paraqitej e qëndrueshme, në një nivel mesatar rreth 26 për qind. Ritmi i lartë i rritjes së depozitave në valutë është shoqëruar me rritjen e mëtejshme të peshës së tyre në ofertën e parasë.

Megjithatë, përshpejtimi i rritjes vjetore të agregatit M2 gjatë kësaj periudhe, ka bërë që tendenca rritëse e raportit të depozitave në valutë ndaj M3 të vijë duke u zbutur.

**Tabelë 16. Ecuria e treguesve monetarë në muajin nëntor (në miliardë lekë).**

| | Nëntor | Ndryshimi 5-mujor | | Ndryshimi vjetor | |
|---|---|---|---|---|---|
| | 2004 | Absolut | Përqindje | Absolut | Përqindje |
| Para jashtë bankave | 128.9 | 10.6 | 9.1 | 8.2 | 6.8 |
| Depozita totale | 366.3 | 26.4 | 7.8 | 39.0 | 11.9 |
| - në lekë | 249.1 | 13.6 | 5.8 | 23.7 | 10.5 |
| - në valutë | 117.2 | 12.8 | 12.4 | 15.3 | 15.0 |
| Depozita pa afat | 73.1 | 8.1 | 12.6 | 11.2 | 18.2 |
| - në lekë | 28.3 | 6.0 | 25.3 | 6.7 | 30.8 |
| - në valutë | 44.7 | 2.1 | 5.1 | 4.6 | 11.4 |
| Depozita me afat | 293.2 | 18.3 | 6.7 | 27.8 | 10.5 |
| - në lekë | 220.7 | 7.6 | 3.6 | 17.1 | 8.4 |
| - në valutë | 72.5 | 10.7 | 17.1 | 10.7 | 17.3 |
| M1 | 157.2 | 16.6 | 11.8 | 14.9 | 10.5 |
| M2 | 377.9 | 24.2 | 6.9 | 31.9 | 9.2 |
| M3 | 495.1 | 37.0 | 8.1 | 47.2 | 10.5 |
| Baza monetare | 169.6 | 9.5 | 6.1 | 13.3 | 8.5 |

Burimi: Banka e Shqipërisë.

[11] Ndryshimi i rregullores së Bankës "Raiffeisen" ka sjellë një zhvendosje të depozitave në lekë nga depozitat me afat në ato pa afat, me rreth 2.5 miliardë lekë. Në mungesë të këtij efekti, norma vjetore e rritjes së M1, në muajin nëntor, do të rezultonte në 8.7 për qind.

[12] Në muajin nëntor, kursi i këmbimit të lekut kundrejt valutave euro dhe usd, i kombinuar me peshën përkatëse të depozitave në euro dhe usd ndaj totalit, rezultoi në të njëjtin nivel me atë të muajit qershor.

Grafik 17. Ecuria e raportit të depozitave në valutë ndaj M3.




Burimi: Banka e Shqipërisë.

## IV.3 KËRKESA E BRENDSHME

### IV.3.1 MJETET VALUTORE NETO

Mjetet valutore neto të sistemit bankar, gjatë pjesës së dytë të vitit, kanë dhënë një kontribut të konsiderueshëm në rritjen e ofertës monetare. Kontributi i tyre në rritjen vjetore të M3 ka qenë në rritje të vazhdueshme gjatë gjashtëmujorit të dytë dhe, në muajin nëntor, ai arriti në 66.8 për qind. Blerjet e Bankës së Shqipërisë në tregun valutor, rritja e depozitave në valutë pranë bankave të nivelit të dytë, konvertimi në valutë i kapitalit të Bankës "Raiffeisen" dhe mbiçmimi i euros kundrejt dollarit, kanë qenë faktorët kryesorë që kanë ndikuar në rritjen e mjeteve valutore.

Mjetet valutore neto të sistemit bankar janë rritur me 304.9 milionë dollarë[13] gjatë periudhës qershor-nëntor. Në këtë rritje ka ndikuar si rritja e mjeteve valutore neto të Bankës së Shqipërisë ashtu dhe ajo e bankave të nivelit të dytë.

Kështu, rezervat valutore neto të Bankës së Shqipërisë janë rritur me 158.9 milionë dollarë, ndërsa mjetet valutore neto të bankave të nivelit të dytë janë rritur me 146 milionë dollarë.

Duke përjashtuar efektin e kursit të këmbimit, rritja e rezervës valutore të Bankës së Shqipërisë është 108.2 milionë dollarë, ndërsa rritja e mjeteve valutore neto të bankave të nivelit të dytë është 121.4 milionë dollarë.

Grafik 18. Kontributi i rritjes së MVN në rritjen e M3.




Burimi: Banka e Shqipërisë.

[13] Të vlerësuara me kursin fiks të dhjetor '03, rritja e këtyre mjeteve është 229.6 milionë dollarë.

Grafik 19. Ecuria e mjeteve valutore neto të sistemit bankar (në milionë dollarë).




Burimi: Banka e Shqipërisë.

### IV.3.2 KËRKESA E QEVERISË PËR MJETE MONETARE

Kërkesa e qeverisë për mjete monetare ka ardhur në rritje gjatë pjesës së dytë të vitit. Në muajin nëntor, llogaritë fiskale shënojnë një deficit buxhetor prej 19.2 miliardë lekësh. Financimi gjithsej i deficitit buxhetor, në muajin nëntor, arriti në 21.8 miliardë lekë[14], nga 9.4 miliardë lekë në muajin qeshor. Nga ky financim, 21.6 miliardë lekë ishin në formën e financimit të brendshëm, kryesisht nga sistemi bankar. Format kryesore të financimit kanë qenë emetimi i bonove të thesarit dhe i obligacioneve dyvjeçare. Bankat e nivelit të dytë, gjatë periudhës korrik-nëntor, kanë rritur portofolin e bonove të thesarit me rreth 3.9 miliardë lekë. Individët kanë rritur portofolin e tyre me 2.4 miliardë lekë, ndërsa institucionet e kanë ulur atë me 0.5 miliardë lekë. Banka e Shqipërisë nuk ka patur ndryshime në portofolin e saj të bonove të thesarit.

Emetimi i obligacioneve qeveritare që nga muaji qershor ka siguruar një financim prej 5 miliardë lekësh. Ndërkohë, financimi i deficitit është mbuluar edhe nga të ardhurat nga privatizimi i Bankës së Kursimeve (tani Banka "Raiffeisen"), që për periudhën qershor – nëntor janë përdorur në masën rreth 4.9 miliardë lekë[15].

### IV.3.3 KREDIA PËR EKONOMINË

Sistemi bankar është karakterizuar nga ritme të larta të kreditimit të ekonomisë gjatë vitit 2004.

Grafik 20. Ecuria kumulative e financimit të deficitit buxhetor (në miliardë lekë).




Burimi: Banka e Shqipërisë.

[14] Diferenca midis deficitit buxhetor dhe financimit të brendshëm të deficitit buxhetor përfaqëson gjendjen e llogarisë të qeverisë pranë Bankës së Shqipërisë.
[15] Nga "Konvertimi i fondeve të BK për borxhin e jashtëm" është përdorur një shumë ekstra prej 1.5 miliardë lekësh si financimin e brendshëm.

Teprica e kredisë është rritur 9.2 miliardë lekë gjatë periudhës qershor -nëntor 2004, duke qenë 51 për qind më e lartë se rritja e tepricës në gjashtëmjorin e parë të vitit. Krediti për ekonominë po zë një peshë gjithnjë në rritje në strukturën e aktiveve të sistemit bankar, duke përbërë një burim të rëndësishëm të kërkesës për mjete monetare. Raporti kredi/depozita është në rritje të vazhdueshme, tregues i cili prezanton pozitivisht funksionin e rolit ndërmjetësues të sistemit bankar në mbështetjen e zhvillimit të ekonomisë.

kursit të këmbimit të të dyja monedhave usd dhe euro, në uljen e tepricës së kredisë për gjithë vitin 2004 llogaritet rreth 3.6 miliardë lekë. Duke e përjashtuar këtë efekt, teprica e kredisë për ekonominë do të ishte rritur me rreth 19 miliardë lekë.

Struktura e tepricës së kredisë sipas monedhave karakterizohet nga niveli i lartë i kredisë në valutë. Në fund të muajit nëntor 2004, struktura e tepricës së kredisë lekë–valutë rezultoi 18 me 82 për qind. Teprica e kredisë në valutë sipas

**Tabelë 17. Ecuria e disa treguesve kryesorë[16].**

| | 2002 | 2003 | 2004 | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | T-1 | T-2 | T-3 | Nëntor |
| Oferta e parasë (në miliardë lekë) | 416.7 | 448.4 | 456.0 | 458.2 | 487.6 | 495.2 |
| Kredi e brendshme (në % ndaj M3) | 70.8 | 71.5 | 71.6 | 69.5 | 67.4 | 68.0 |
| - Kredi për qeverinë (në % ndaj M3) | 61.5 | 60.2 | 59.9 | 57.1 | 54.8 | 54.7 |
| - Kredi për ekonominë (në % ndaj M3) | 9.3 | 11.3 | 11.7 | 12.4 | 12.6 | 13.3 |
| Kredi për ekonominë (% ndaj totalit të aktiveve) | 11.5 | 13.7 | 13.7 | 14.6 | 14.7 | 15.8 |
| Kredi për ekonominë (në % ndaj PBB) | 5.7 | 6.8 | 7.0 | 7.4 | 7.3 | 8.1 |
| Depozita gjithsej (në % ndaj PBB) | 42.2 | 43.4 | 44.1 | 44.1 | 44.4 | 44.8 |
| Raporti kredi/depozita (në %) | 13.5 | 15.7 | 15.8 | 16.7 | 16.9 | 18 |

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Rritja e tepricës së kredisë gjatë 11 muajve të parë të vitit shënon vlerën 15.3 miliardë lekë, duke përbërë një rritje prej 30 për qind në krahasim me fundin e vitit 2003. Ndërkohë, teprica e kredisë në valutë është nën efektin e kursit të këmbimit të lekut me dy monedhat e

monedhave euro dhe usd përbën përkatësisht 69 për qind dhe 31 për qind të totalit të kredisë në fund të muajit nëntor. Krahasuar me fundin e gjashtëmujorit të parë të vitit (48 me 52) kjo strukturë ka pësuar zhvendosje të theksuar në favor të euros.

**Tabelë 18. Ecuria e treguesve të tepricës së kredisë (në përqindje).**

| | 2002 | 2003 | T-1 '04 | T-2' 04 | T-3'04 | Nëntor'04 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Teprica e kredisë (në miliardë lekë) | 38.7 | 50.7 | 53.4 | 56.8 | 60.9 | 66.0 |
| | | | | | | |
| Kredi afatshkurtër | 53.8 | 46.0 | 41.6 | 35.4 | 34.0 | 33.3 |
| Kredi afatmesme | 30.1 | 33.3 | 35.4 | 37.8 | 37.0 | 36.9 |
| Kredi afatgjatë | 16.1 | 20.7 | 23.0 | 26.8 | 29.0 | 29.8 |
| | | | | | | |
| Lekë | 21.3 | 19.6 | 17.0 | 17.0 | 17.0 | 18 |
| Valutë | 73.7 | 80.4 | 83.0 | 83.0 | 83.0 | 82 |

Burimi: Banka e Shqipërisë.

muaja, usd dhe euro. Vlerësimi i lekut ndaj usd dhe euros, në pjesën më të madhe të vitit 2004, ka ndikuar negativisht në rritjen e tepricës së kredisë. Po të flitet me gjuhën e shifrave, efekti i

Kredia e re e akorduar gjatë periudhës korrik-nëntor arriti në 32.5 miliardë lekë. Një zhvillim pozitiv i kreditimit gjatë vitit 2004 ka qenë zhvendosja graduale e kredisë së re drejt afateve

[16] Ky raport është ndërtuar ndaj PBB-së në nivel vjetor për vitin 2004.

më të gjata të maturimit. Kështu, 40 për qind e kredisë së re të lëvruar në pjesën e dytë të vitit 2004 është kredi afatmesme dhe afatgjatë, kundrejt vlerës 29 për qind të shënuar nga ky tregues në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Gjithashtu, një nga veçoritë më të spikatura për tregun e huadhënies bankare, gjatë gjithë vitit 2004, është rritja e lëvrimit të kredive të reja në lekë. Janë akorduar kredi të reja në lekë rreth 30 miliardë lekë ose 33 për qind e kredisë së re gjithsej. Kreditë e reja të akorduara në lekë përbëjnë 37 për qind të totalit të kredisë së re gjatë periudhës korrik-nëntor. Edhe pse vërehet një orientim dhe interesim i bankave për të kredituar në lekë, efekti i tyre në rritjen portofolit të kredisë në lekë është i vogël. Kjo, sepse kreditë në lekë, në pjesën më të madhe, lëvrohen në terma kohorë afatshkurtër.

Kredia bankare gjatë pjesës së dytë të vitit vlerësohet të ketë pësuar ndryshime edhe në drejtim të sektorëve të ekonomisë. Vërehen tendenca në rritje të kreditimit në sektorin e bujqësisë dhe të industrisë përpunuese. Gjatë vitit 2004, vlerësohet se sektori i tregtisë ka pësuar një rënie në drejtim të financimit nga sistemi bankar. Ky sektor gjatë tre viteve të fundit ka qenë sektori më i kredituar i ekonomisë.

**Tabelë 19. Ecuria e kredisë së re në vite (në miliardë lekë).**

| | 2002 | 2003 | T-1 '04 | T-2 '04 | T-3 '04 | Janar-Nëntor'04 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Kredi e re (në mld lekë) | 62.6 | 92.6 | 27.9 | 28.5 | 18.0 | 88.8 |
| | | | | | | |
| Kredi afatshkurtër | 44.7 | 63.1 | 18.7 | 18.1 | 10.9 | 56.2 |
| Kredi afatmesme | 13.0 | 22.2 | 5.7 | 6.8 | 3.9 | 19.9 |
| Kredi afatgjatë | 4.8 | 7.4 | 3.5 | 3.6 | 3.1 | 12.7 |
| | | | | | | |
| Lekë | 20.8 | 30.8 | 8.80 | 8.9 | 6.0 | 29.6 |
| Valutë | 41.8 | 61.8 | 19.10 | 19.6 | 12.0 | 59.2 |

Burimi: Banka e Shqipërisë.

**Tabelë 20. Teprica e kredisë sipas degëve të ekonomisë (në përqindje).**

| | | 2002 | 2003 | T-1 '04 | T-2 '04 | T-3 '04 | Nëntor'04 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Bujqësia, gjuetia dhe silvikultura | 0.8 | 1 | 1.0 | 1.2 | 1.6 | 1.6 |
| 2 | Peshkimi | 0.2 | 0 | 0.1 | 0.1 | 0.1 | 0.1 |
| 3 | Industria nxjerrëse | 0.2 | 1 | 0.2 | 0.2 | 0.3 | 0.2 |
| 4 | Industria përpunuese | 17.0 | 17 | 16.9 | 18.4 | 18.2 | 18.6 |
| 5 | Prodhimi, shpërndarja energji elektrike, gaz dhe ujë | 3.3 | 3 | 3.0 | 3.3 | 3.2 | 3.2 |
| 6 | Ndërtimi | 8.6 | 10 | 9.7 | 10.7 | 10.2 | 10.7 |
| 7 | Tregtia, riparimi i automobilave dhe artikujve shtëpiakë | 40.4 | 34 | 31.4 | 23.5 | 21.9 | 22.2 |
| 8 | Hotele dhe restorante | 6.0 | 6 | 7.1 | 8.3 | 8.3 | 7.7 |
| 9 | Transporti dhe telekomunikacioni | 2.4 | 1 | 2.0 | 1.5 | 1.6 | 1.4 |
| 10 | Aktivitete financiare | - | 0 | 0.1 | 0.7 | 0.7 | 0.4 |
| 11 | Pasuritë e patundshme | 9.1 | 13 | 13.7 | 14.8 | 15.6 | 9.1 |
| 12 | Shëndeti dhe veprimtaritë sociale | 0.5 | 0 | 0.5 | 0.5 | 0.5 | 0.5 |
| 13 | Shërbime kolektive, sociale dhe personale | 4.2 | 8 | 4.2 | 4.5 | 5.3 | 5.2 |
| 14 | Të tjera | 7.3 | 4 | 10.1 | 12.2 | 12.7 | 19.0 |
| | Totali | 100 | 100 | 100.0 | 100.0 | 100.0 | 100.0 |

Burimi: Banka e Shqipërisë.

## IV.4 KURSI I KËMBIMIT

Edhe pse disa nga faktorët që ndikuan në mbiçmimin e lekut gjatë periudhës së verës së hershme (qershor) kanë qenë gjithnjë në zbehje, leku ka qenë në pozita të forta kundrejt euros dhe dollarit edhe gjatë pjesës së dytë të vitit. Për periudhën qershor-dhjetor, leku është nënçmuar me 2.7 për qind kundrejt euros, ndërsa është mbiçmuar me 8.7 për qind kundrejt dollarit. Megjithëse gjatë kësaj periudhe janë zbehur efektet e disa faktorëve specifikë, si rritja e prodhimit vendas apo rritja e ofertës së valutës së huaj nga turizmi dhe remitancat, faktorët e brendshëm afatgjatë kanë ruajtur dhe përforcuar pozitat e lekut. Këta faktorë, të evidentuar në vazhdimësi në analizat e Bankës së Shqipërisë, janë:

- Konsolidimi i vazhdueshëm i stabilitetit ekonomik të vendit. Ky stabilitet ka forcuar besimin në sistemin financiar shqiptar dhe në aktivet monetare në lekë.
- Normat reale të interesit në lekë më të larta se normat e interesit në valutë. Kjo diferencë ka nxitur një kërkesë të lartë për lekë. Edhe pse normat e interesit në lekë kanë qenë në rënie, nivelet e ulëta të inflacionit kanë mbajtur lart normat reale të interesave në lekë.
- Konsolidimi i financave publike dhe i deficitit buxhetor ka diktuar një kërkesë të ulët të qeverisë për mjete monetare. Gjithashtu, kredia në lekë mbetet në nivele të ulëta, duke e kufizuar, në njëfarë mase, gjenerimin e mjeteve monetare në lekë.

Nga ana tjetër, edhe ecuria e raportit të valutave në tregun ndërkombëtar ka ndikuar kursin e këmbimit të lekut, sidomos këmbimin e lekut kundrejt dollarit amerikan. Kështu, kundrejt dollarit leku ka qenë në mbiçmim të vazhdueshëm, ndërsa kundrejt euros këmbimi i lekut ka ndërruar kah nga mesi i qershorit. Që nga fillimi i vitit, mbiçmimi i lekut kundrejt euros dhe dollarit është përkatësisht 5.5 për qind dhe 12.3 për qind. Nivelet e këmbimit të lekut në fund të vitit 2004 janë 126.35 lek/euro dhe 92.64 lek/usd.

## IV.5 TREGU I PARASË DHE NORMAT E INTERESIT

### IV.5.1 ECURIA E LIKUIDITETIT

Sistemi bankar ka rezultuar me tepricë likuiditeti gjatë gjashtëmujorit të dytë. Likuiditeti mesatar ditor ka qenë i qëndrueshëm në nivelin e 5.2 miliardë lekëve, afër nivelit 5.1 miliardë lekë që ishte në gjashtëmujorin e parë.

Instrumenti kryesor i përdorur për tërheqjen e likuiditetit ka qenë ai i repove me afat njëjavor dhe njëmujor. Vëllimi mesatar i repove njëjavore ka patur një rënie të lehtë në gjysmën e dytë të vitit, ndërsa vëllimi mesatar i repove njëmujore është rritur. Repot njëmujore janë përdorur në muajt korrik dhe gusht si një formë afatgjatë e tërheqjes së likuiditetit të tepërt të sistemit bankar. Ankandet e repove janë zhvilluar kryesisht sipas formës me çmim fiks, por nga mesi i muajit gusht deri në mesin e muajit shtator janë zhvilluar dhe ankande të repove njëjavore me shumë çmime. Kjo formë ankandi është përdorur për të lehtësuar zbatimin e vendimeve të politikës monetare në drejtim të uljes së normave të interesit.

Grafik 21. Ecuria e kursit të këmbimit gjatë vitit 2004 (lek/usd shkalla majtas).




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 22. Likuiditeti i sistemit bankar (në milionë lekë)[17].




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Lehtësia e kredisë njëditore ka patur një përdorim më të ndjeshëm në krahasim me gjashtëmujorin e parë të vitit. Niveli mesatar ditor i saj arriti në 265 milionë lekë, nga 36 milionë lekë që ishte në gjashtëmujorin e parë. Rritja në përdorimin e kësaj lehtësie vjen dhe si rrjedhojë e vënies në funksionim të sistemit të pagesave AIPS, nga muaji mars i këtij viti. Ndërsa, përdorimi i lehtësisë së depozitave njëditore është luhatur në të njëjtat nivele me gjashtëmujorin e parë.

Në tregun ndërbankar ka patur rritje në nivelin e transaksioneve. Kështu, niveli mesatar i transaksioneve njëditore arriti në 0.48 miliardë lekë nga 0.33 miliardë lekë që ishte në gjashtëmujorin e parë. Gjithashtu, janë zhvilluar transaksione ndërbankare njëmujore, niveli mesatar i të cilave arriti në vlerën e 57 milionë lekëve.

Totali i ofruar për investim në ankandet e bonove të thesarit nga sistemi bankar dhe individët ka vazhduar të jetë më i lartë se ai i kërkuar nga qeveria, sidomos për bonot e thesarit me afate maturimi 6- dhe 12-mujore. Rritja e konkurrencës për këto alternativa investimi ka ndihmuar në rritjen e presioneve për reduktimin e normave të interesit në tregun primar.

### IV.5.2 ECURIA E NORMAVE TË INTERESIT

Veçori e gjashtëmujorit të dytë 2004 ka qenë arritja e niveleve më të ulëta historike të *yield*-it të bonove të thesarit dhe të interesave në tregun ndërbankar. Ndërkohë, interesat e depozitave me afat në lekë kanë arritur nivelet më të ulëta në 12 vitet e fundit[18]. Tendenca rënëse e interesave ka ardhur si rezultat i politikës monetare lehtësuese të Bankës së Shqipërisë. Rënia e interesave të depozitave në lekë dhe rritja e interesave për depozitat në valutë, ka çuar në ngushtimin e *spread*-it midis tyre. Kështu, për depozitat me afat, *spread*-i i interesave lekë-usd është ulur nga 4.7 pikë përqindjeje, që ishte në fund të gjashtëmujorit të parë, në 3.8 pikë përqindjeje në fund të muajit nëntor. Në të njëjtën kohë, *spread*-i i interesave lekë-euro ka zbritur nga 3.8 pikë përqindjeje në 3.5 pikë përqindjeje.

Grafik 23. Ndryshimi gjashtëmujor i interesit mesatar të ponderuar të depozitave me afat tremujor në lekë dhe i *yield*-it të bonove të thesarit tremujore.




Burimi: Banka e Shqipërisë.

[17] Përfshin: repon, depozitën njëditore dhe llogarinë rrjedhëse në lekë minus kredinë njëditore.
[18] Që nga korriku i vitit 1992.

Megjithë uljen e interesave nominalë, niveli i ulët i inflacionit ka ndikuar në ruajtjen e vlerës së interesave realë. Interesat realë të depozitave dymbëdhjetëmujore në lekë, janë luhatur rreth një niveli mesatar prej 3.75 për qind nga 3,44 për qind që ishte në gjashtëmujorin e parë.

reagimeve ndaj sinjalizimeve të Bankës së Shqipërisë janë të ndryshme për të tre afatet e maturimit. Ky fakt dhe pritshmëritë për inflacionin mund të përkthehen në ndryshime të mëtejshme të interesave nga bankat e nivelit të dytë për një ose për disa nga maturimet.

Grafik 24. Interesat reale dhe nominale të depozitave me afat 12-mujor në lekë.




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Politika zbutëse e Bankës së Shqipërisë është reflektuar më shumë në uljen e normave të interesit të depozitave 6- dhe 12-mujore. Gjithashtu, edhe *yield*-i mesatar i ponderuar i bonove të thesarit 3-mujore, 6-mujore dhe 12-mujore është ulur dukshëm gjatë vitit 2004, duke lehtësuar koston e borxhit të qeverisë. Duhet theksuar se diferencat kohore të përcjelljes së

Në përgjithësi, gjatë gjysmës së dytë të vitit 2004[20], janë vërejtur ndryshime të interesave të kredive në kahun rënës. Normat e interesave të kredive në lekë[21] kanë reaguar në të njëjtin kah me sinjalet e politikës monetare. Kjo është shoqëruar dhe me rritje të kredive në lekë në masën 2.5 miliardë lekë, në gjysmën e dytë të vitit 2004.

**Tabelë 21. Reagimi i sistemit bankar ndaj politikës monetare gjatë vitit 2004 (në pikë përqindjeje).**

| Periudha | 6-ml[19] | 6-ml | 2004 (ndryshimi) | 2004 (niveli) |
|---|---|---|---|---|
| Norma bazë e interesit | 1.00 | -0.75 | -1.75 | 5.25 |
| Depozitat në lekë | | | | |
| 3-mujore | -0.77 | -0.4 | -1.17 | 4.5 |
| 6-mujore | -1.01 | -0.61 | -1.62 | 5.5 |
| 12-mujore | -1.13 | -0.60 | -1.73 | 5.9 |
| *Yield*-i i bonove të thesarit | | | | |
| 3-mujore | -0.46 | -0.79 | -1.25 | 6.1 |
| 6-mujore | -0.59 | -0.96 | -1.55 | 7.2 |
| 12-mujore | -0.49 | -0.90 | -1.39 | 8.1 |

Burimi: Banka e Shqipërisë.

**Tabelë 22. Normat e interesit për kreditë në lekë (në përqindje).**

| | qershor-04 | nëntor-04 | Ndryshimi |
|---|---|---|---|
| | a | b | C = b-a |
| Kredi deri 6 muaj | 11.94 | 11.98 | 0.04 |
| Kredi 6 muaj – 1 vit | 17.33 | 15.05 | -2.28 |
| Kredi 1-3 vjet | 19.37 | 19.02 | -0.35 |
| Kredi mbi 3 vjet | 15.23 | 12.72 | -2.51 |

Burimi: Banka e Shqipërisë.

[19] Përfshin dhe fundin e vitit 2003, pasi efekti i vendimit të marrë në këtë periudhë është parë në fillim të vitit 2004.
[20] Të dhënat më të fundit janë deri në muajin nëntor 2004.
[21] Me përjashtim të kredive me afat deri në 6 muaj.

Ndërkohë, interesat e kredive në valutë kanë shfaqur tendenca rënëse, si rezultat i konkurrencës në rritje në këtë treg. Përjashtim bëjnë normat e interesave të kredive me afat deri në 6 muaj, të cilat kanë pësuar një rritje të lehtë kryesisht si rezultat i mesatarizimeve që iu bëhen këtyre normave. Në muajin nëntor, interesat mesatarë të ponderuar të kredive në usd arritën në 8.45 për qind dhe për kreditë në euro, 8.49 për qind.

Gjashtëmujori i dytë i vitit 2004 është karakterizuar nga rritja e interesave të depozitave në valutë sidomos e atyre në dollarë, me përkatësisht 0.7 pikë për qind për depozitat me afat në usd dhe 0.12 pikë për qind, për depozitat me afat në euro.

Grafik 25. Interesat mesatare të ponderuara të depozitave në valutë.




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në fund të muajit nëntor, interesat mesatarë të ponderuar të depozitave me afat në usd dhe në euro, arritën përkatësisht në 1.42 për qind dhe 1.68 për qind. Normat e interesave në usd janë rritur në të gjitha afatet, ndikuar nga rritja e shpejtë e interesave libor, si pasojë e politikës shtrënguese të Fed-it. Po kështu, rritje të lehtë ka patur në të gjitha afatet e interesave të depozitave në euro, ndikuar nga luhatjet e interesave euribor dhe nga konkurrenca në treg.

## V. EKONOMIA SHQIPTARE NË VITIN 2005

Konsolidimi i vazhdueshëm i stabilitetit makroekonomik gjatë viteve të fundit, përbën një bazë të mirë për zhvillimin e ekonomisë shqiptare në vitin 2005.

Deficiti buxhetor ka patur një tendencë zbritëse, ndërkohë që financimi i brendshëm i deficitit është mbajtur brenda vlerave të programuara. Nga ana tjetër, situata dhe kushtet monetare kanë qenë gjithashtu nën kontroll, duke kontribuar ndjeshëm në ruajtjen e inflacionit në nivelet e programuara. Kjo situatë, e kombinuar me zhvillimet pozitive në prodhimin e brendshëm bujqësor dhe energjitik gjatë vitit 2004, ka rezultuar në nivele inflacioni brenda objektivit të Bankës së Shqipërisë dhe stabilizimin e pritjeve inflacioniste. Duke kapitalizuar mbi këto zhvillime, Banka e

**Tabelë 23. Treguesit kryesorë makroekonomikë.**

| | 2002 | 2003 | 2004 | 2005 |
|---|---|---|---|---|
| Treguesit monetarë (në përqindje) | | | | |
| Rritja PBB | 4.7 | 6.0 | 6.0 | 6.0 |
| IÇK vjetor (mesatar) | 5.2 | 2.4 | 2.9 | 3.0 |
| PBB nominale (miliardë lekë) | 677.7 | 746.6 | 841.8 | 919.7 |
| Treguesit fiskalë (në përqindje ndaj PBB-së) | | | | |
| Deficiti fiskal | -6.9 | -4.7 | -4.9 | 4.0 |
| Huamarrja e brendshme | 3.2 | 2.7 | 1.9 | 3.1 |
| Treguesit monetarë (në përqindje) | | | | |
| Rritja M3 | 7.0 | 9.5 | 12.4 | 9.4 |
| Rritja e kredisë për ekon. | 32.1 | 28.5 | 31.3 | 39.6 |
| Normat e interesit të bth 3m | 11.2 | 7.3 | 6.1 | ... |

Burimi: Banka e Shqipërisë, INSTAT, Ministria e Financave.

Shqipërisë ka vazhduar të ndjekë një politikë monetare zbutëse, duke e sjellë koston e huamarrjes në ekonomi në nivelet minimale historike.

### *Sektori fiskal*

Treguesit e përgjithshëm fiskalë të paraqitur në buxhetin e vitit 2005, flasin për një qëndrim të moderuar të politikës fiskale, duke theksuar kontributin pozitiv të saj në ruajtjen e stabilitetit makroekonomik në vend. Gjatë vitit 2005, shpenzimet buxhetore në raport me PBB-në planifikohet të shënojnë një rënie me rreth 0.7 pikë përqindjeje, duke arritur në 26.3 për qind. Kjo do të reflektohet në rënien e shpenzimeve kapitale nga 5.1 për qind në 4.7 për qind të PBB-së. Bazuar në një këndvështrim realist, të ardhurat buxhetore parashikohen pothuajse të pandryshuara, në nivelin 22.3 për qind të PBB-së.

Në linjë me politikën e konsolidimit fiskal të shprehur në projektbuxhetin afatmesëm për periudhën trevjeçare, deficiti buxhetor në vitin 2005 planifikohet të reduktohet në 4.0 për qind të PBB-së, nga 4.9 për qind që është realizimi i pritshëm për vitin 2004. Pjesa kryesore e këtij deficiti do të përballohet me anë të financimit të brendshëm, i cili planifikohet të arrijë në 28.3 miliardë lekë ose rreth 3.1 për qind të PBB-së, nga 3.8 për qind që ishte në vitin 2004. Rënia e të ardhurave nga privatizimi në 0.5 për qind të PBB-së, do të bëjë që financimi i brendshëm i deficitit në vitin 2005 të mbështetet kryesisht në huamarrjen e brendshme, e cila parashikohet të jetë 23.3 miliardë lekë ose 2.5 për qind e PBB-së. Financimi i huamarrjes së brendshme të qeverisë nga sistemi bankar parashikohet në 17 miliardë lekë ose 1.8 për qind e PBB-së, ndërsa pjesa tjetër pritet të përballohet nga individët dhe subjektet e tjera private.

### *Sektori monetar*

Objektivi kryesor i politikës monetare për vitin 2005, i përfshirë në programin monetar, mbetet ruajtja e normës vjetore të inflacionit në intervalin 2 – 4 për qind. Ky objektiv do të synohet të arrihet nëpërmjet kontrollit të rritjes së ofertës monetare në nivel të përafërt me rritjen e PBB-së nominale, nën supozimin e ecurisë së qëndrueshme të shpejtësisë së qarkullimit të parasë në ekonomi. Mbi këtë bazë, ritmi vjetor i rritjes së ofertës së parasë për vitin 2005 të parashikuar në programin monetar është 9.4 për qind. Ky ritëm është konsistent me plotësimin e kërkesës për para të ekonomisë që vjen nga rritja reale e saj me 6 për qind, duke shërbyer si instrument i ndërmjetëm i politikës monetare për arritjen e objektivit të inflacionit.

Programi monetar parashikon zhvendosjen e strukturës së përdorimit të burimeve financiare nga qeveria në drejtim të sektorit privat të ekonomisë. Kërkesa për para e qeverisë parashikohet e ulët, rreth 1.8 për qind e PBB-së, ndërkohë që ritmi i rritjes së kërkesës së ekonomisë pritet të përshpejtohet ndjeshëm, me rritjen e tepricës së kredisë me 2.3 për qind të PBB-së. Reduktimi i diferencës midis normave të interesit të kredive në lekë dhe në valutë, si rezultat i politikës monetare lehtësuese të ndjekur nga Banka e Shqipërisë, pritet të shoqërohet me një kontribut më të madh të kredisë në lekë në rritjen e tepricës së kredisë gjithsej. Rritja e tepricës së kredisë gjithsej me 27.2 miliardë lekë, do të vijë si rezultat i rritjes me 6.5 miliardë lekë të tepricës së kredisë në lekë dhe 20.7 miliardë lekë të tepricës së kredisë në valutë.

Programi monetar parashikon zhvendosjen e strukturës kohore të ofertës monetare drejt mjeteve më pak likuide. Ky zhvillim do të pasqyrohet në rënien e mëtejshme të raportit të parasë jashtë bankave ndaj agregatit M3, duke reflektuar zhvillimet pozitive në sistemin bankar dhe një sërë masash të planifikuara në kuadrin e programit të reduktimit të parasë *cash* në ekonomi, gjatë vitit 2005. Raporti i parasë jashtë bankave ndaj M3 pritet të shënojë një rënie me 0.7 pikë përqindjeje, duke arritur në nivelin 26.5 për qind në fund të vitit 2005. Si rezultat, pritet një ritëm i ulët rritjeje për treguesit e parasë jashtë bankave dhe agregatit M1, ndërkohë që kontributi i depozitave në lekë në rritjen e ofertës së parasë pritet të shënojë rritje të dukshme. Norma vjetore e rritjes së depozitave në lekë në fund të vitit 2005 parashikohet të arrijë në 10.7 për qind, duke përfaqësuar komponentin me ritmin më të lartë të rritjes në ofertën monetare. Me stabilizimin e flukseve valutore nga dërgesat e emigrantëve, raporti i depozitave në valutë ndaj agregatit M3 pritet të ndjekë një ecuri të qëndrueshme, duke mbetur i pandryshuar në nivelin 22.2 për qind. Bazuar në këtë supozim, norma vjetore e rritjes së depozitave në valutë për vitin 2005 parashikohet të jetë 9.9 për qind, duke mbetur

në linjë me normën vjetore të rritjes së ofertës monetare.

Rritja e kënaqshme e depozitave në lekë do t'u mundësojë bankave të nivelit të dytë financimin e plotë të kërkesës së qeverisë dhe ekonomisë, duke ruajtur në të njëjtën kohë një gjendje teprice likuiditeti. Programi monetar për vitin 2005 nuk parashikon pjesëmarrjen e Bankës së Shqipërisë në tregun primar apo kreditimin direkt të qeverisë nga ana e saj. Megjithatë, në varësi të ecurisë së likuiditetit në sistemin bankar, Banka e Shqipërisë mund të vlerësojë të nevojshme ndërmarrjen e këtyre veprimeve në momente të caktuara.

# DOKUMENTI I POLITIKËS MONETARE PËR VITIN 2005

## HYRJE

Banka e Shqipërisë, si autoriteti monetar i Republikës së Shqipërisë, është institucioni përgjegjës për hartimin, për miratimin dhe për zbatimin e politikës monetare. Politika monetare hartohet në funksion të përmbushjes së objektivit kryesor të Bankës së Shqipërisë, arritjes dhe ruajtjes së stabilitetit të çmimeve.

Politika monetare, së bashku me politikën fiskale, është një ndër politikat bazë makroekonomike. Ajo synon administrimin e variablave monetarë të ekonomisë – ofertën monetare dhe nivelin e normave të interesit – në funksion të arritjes së objektivit të stabilitetit të çmimeve në një periudhë afatmesme. Politika monetare realizohet nëpërmjet ndërhyrjes së Bankës së Shqipërisë në tregjet financiare. Në tërësinë e saj, politika monetare përfshin: bazën ligjore në të cilën mbështetet, kuadrin e objektivave, aparatin teorik që përdoret për modelimin e saj, si dhe instrumentet e përdorura për zbatimin e saj. Qëllimi i këtij dokumenti është të përcaktojë dhe të publikojë parimet mbi të cilat do të bazohet hartimi dhe zbatimi i politikës monetare gjatë vitit në vazhdim.

Duke u nisur nga rëndësia që ka kuptimi i drejtë i vendimeve të politikës monetare në publik, një pjesë integrale e politikës monetare janë edhe kanalet e komunikimit në publik të vendimeve të politikës monetare. Në këtë dokument jepet një përmbledhje e rrugëve kryesore të komunikimit, të përdorura nga Banka e Shqipërisë për komunikimin e politikës monetare.

## BAZA LIGJORE

Në bazë të nenit 161 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Banka e Shqipërisë "… ka të drejtën ekskluzive të zbatimit të pavarur të politikës monetare".

Në bazë të nenit 3, pika 4a[1], të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", ky institucion ka si detyrë kryesore "të hartojë, të miratojë dhe të zbatojë në mënyrë të pavarur politikën monetare të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me objektivin e saj kryesor".

Në bazë të nenit 3, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", si objektiv kryesor i Bankës së Shqipërisë përcaktohet "arritja dhe ruajtja e stabilitetit të çmimeve".

Në bazë të nenit 43, pika a, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë ka këto kompetenca: "Të miratojë politikën monetare të Republikës së Shqipërisë, duke përcaktuar kufijtë e operacioneve të Bankës së Shqipërisë në treg të hapur, përqindjen e interesave për depozitat në Bankën e Shqipërisë dhe për skontimet dhe huatë ose kreditë e Bankës së Shqipërisë, si dhe të rezervave dhe nivelit të rezervave të detyruara, që bankat e nivelit të dytë duhet të mbajnë në Bankën e Shqipërisë".

Banka e Shqipërisë bashkërendon politikën e saj monetare me nevojat e zhvillimit ekonomik të vendit dhe me strategjitë e hartuara për të. Në veçanti, një vëmendje e posaçme i kushtohet bashkërendimit me politikën fiskale, si një përcaktuese tjetër e rëndësishme e zhvillimeve ekonomike në vend.

Në të njëjtën kohë dhe pa cënuar parimin e bashkërendimit të politikave ekonomike të vendit, miratimi i politikës monetare nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë dhe zbatimi i saj me anë të instrumenteve monetare përcaktohen në mënyrë të pavarur nga Banka e Shqipërisë. Vendimet e politikës monetare nuk shkojnë në kundërshtim me nevojën e përmbushjes së objektivit të mandatuar nga ligji, arritjen dhe ruajtjen e stabilitetit të çmimeve.

[1] Sipas amendamentit të bërë me ligjin nr. 8893, datë 25.07.2002.

Konceptimi, hartimi dhe zbatimi i politikës monetare të Bankës së Shqipërisë mbështeten në një kuptim të drejtë të rolit që mund të luajë politika monetare, nëpërmjet analizës së ndikimit të saj në ekonomi. Vlerësimi i këtij roli mbështetet si në mendimin teorik bashkëkohor, ashtu edhe në praktikën e huaj dhe shqiptare.

## ROLI I POLITIKËS MONETARE NË ZHVILLIMIN EKONOMIK

Politika monetare synon të ndikojë variablat ekonomikë me anë të ndryshimit të normave afatshkurtra të interesit. Ajo përfshin të gjitha aspektet teorike, analizuese dhe operacionale të lidhura me këtë proces. Banka qendrore është në gjendje të ndikojë normat afatshkurtra të interesit në sajë të monopolit që i është njohur asaj për krijimin e parasë: parasë fizike dhe rezervave të bankave të nivelit të dytë.

Në periudhën afatshkurtër, një ndryshim i ofertës monetare apo i normave të interesit në tregun e parasë, vë në lëvizje një sërë mekanizmash të cilët ndikojnë në tërësi aktivitetin ekonomik: prodhimin, punëzënien dhe nivelin e çmimeve. Ndërkohë, **në periudhën afatgjatë, domethënë pasi në ekonomi të kenë ndodhur të gjitha ndryshimet dhe korrigjimet e sjelljes së agjentëve ekonomikë, ndryshimi në sasinë e parasë do të reflektohej vetëm në një ndryshim në nivelin e çmimeve, pa prekur variablat realë të ekonomisë: prodhimin, të ardhurat dhe punësimin.**

Nga ana tjetër, eksperienca botërore dhe konsensusi i përgjithshëm i mendimit ekonomik sugjerojnë se luhatjet e nivelit të çmimeve, situatat inflacioniste apo deflacioniste, janë të dëmshme për ekonominë.

Stabiliteti i çmimeve nxit potencialin e rritjes së ekonomisë në periudha afatgjata nëpërmjet ndikimit pozitiv që ka në shpërndarjen e burimeve dhe në stabilitetin financiar të vendit.

### SHPËRNDARJA E BURIMEVE DHE MIRËQENIA SOCIALE

Alokimi i burimeve në ekonomi, marrja e vendimeve për investime, prodhimi dhe konsumi varen nga çmimet relative të produkteve. Raportet e këtyre çmimeve japin një informacion të dobishëm në lidhje me produktet ose aktivitetet më fitimprurëse, duke orientuar më pas shpërndarjen e burimeve drejt tyre. Por, në një mjedis inflacionist, agjentët ekonomikë e kanë të vështirë të dallojnë një ndryshim në çmimet relative nga një rritje e nivelit të përgjithshëm të çmimeve, pra nga inflacioni. Si rezultat, gjatë periudhave inflacioniste, faktorët e prodhimit mund të drejtohen në përdorime të gabuara, duke iu shmangur shpërndarjes optimale të tyre.

Inflacioni vështirëson vlerësimin e normës reale të interesit, e cila udhëheq vendimet e individëve për konsum apo për kursim, dhe vendimet e firmave për investime. Për më tepër, luhatjet e normës së inflacionit bëjnë që kreditorët të kërkojnë një *prim inflacioni* për të kompensuar rrezikun e mbajtjes së vlerave nominale për periudha të gjata kohe. Duke reduktuar këtë rrezik, politika monetare ndikon pozitivisht në zgjerimin e ndërmjetësimit financiar dhe në rritjen e efektivitetit me të cilin tregjet financiare shpërndajnë burimet në ekonomi. Një situatë e tillë do të rezultojë në rritje të investimeve në ekonomi.

Inflacioni ndikon në rishpërndarjen e burimeve nga shtresat me të ardhura fikse (nëpunësit, pensionistët) tek ata me të ardhura të indeksuara me inflacionin (prodhuesit dhe tregtarët). Gjithashtu, në mungesë të një sistemi tatimor të indeksuar me inflacionin, ky i fundit mund të rezultojë në rritje jo të drejta të detyrimeve fiskale, duke zbehur nxitjen për investime dhe punë.

### STABILITETI FINANCIAR

Stabiliteti financiar është i domosdoshëm për një ekonomi të shëndetshme. Ai rrit aftësitë e një ekonomie për të zbutur efektin e goditjeve të mundshme: rritjen e çmimeve të energjisë, ndryshime të theksuara teknologjike, zhvillime të paparashikuara në ekonomitë e shteteve partnere në tregti, e kështu me radhë. Ngjarje të tilla sjellin keqpërdorim të burimeve, por një sistem financiar i shëndoshë mund t'i absorbojë këto goditje pa lejuar që ato të dëmtojnë aktivitetin ekonomik. Në këto rrethana, aktiviteti ekonomik do të ndikohej më pak nga ç'do të ndikohej në kushtet ku sektori financiar do të zmadhonte dhe përhapte efektet e goditjes.

Një ekonomi me inflacion të ulët ka më pak të ngjarë të përjetojë luhatje të theksuara në çmimet e aseteve dhe në pritshmëritë për këto çmime.

Problemet e lidhura me keqvlerësimin e çmimeve të aseteve financiare dhe parashikimet për to, janë afërsisht të njëjta me problemet e vlerësimit të ndryshimeve të çmimeve relative në prani të inflacionit, situatë kjo e përshkruar më sipër. Investitorët dhe kreditorët mund t'i keqintepretojnë sinjalet që marrin nga çmimet. Në këto rrethana, burimet financiare nuk shfrytëzohen siç duhet ose mbrojtja nga ky rrezik do të kërkonte një kosto shtesë financiare.

Duke u nisur nga argumentet e paraqitura më lart, Banka e Shqipërisë gjykon se ruajtja e stabilitetit të çmimeve përbën kontributin më të qenësishëm të saj në drejtim të përmbushjes së objektivave më të gjerë ekonomikë: rritjes ekonomike dhe rritjes së standardit të jetesës.

## OBJEKTIVI I INFLACIONIT PËR VITIN 2005

Në shërbim të transparencës dhe të rritjes së përgjegjshmërisë së saj, Banka e Shqipërisë është e interesuar të shpjegojë publikisht mandatin e saj, domethënë interpretimin e stabilitetit të çmimeve. Ky proces i shërben orientimit të pritjeve të publikut drejt objektivit të inflacionit të synuar. Paralelisht me të, Banka e Shqipërisë informon edhe në lidhje me rrugët dhe instrumentet që ajo do të përdorë për arritjen e këtij objektivi.

Të arrish stabilitetin e çmimeve do të thotë të arrish norma të ulëta pozitive të inflacionit ose të ndryshimit të çmimeve të konsumit. Të ruash stabilitetin e çmimeve do të thotë të sigurosh norma të ulëta pozitive inflacioni për periudha relativisht të gjata kohe.

Banka e Shqipërisë ka përcaktuar në strategjinë e saj trevjeçare "Plani i zhvillimit afatmesëm të Bankës së Shqipërisë (2003 - 2005)", objektivin e inflacionit për këtë periudhë. Objektivi strategjik afatmesëm i politikës monetare është mbajtja e inflacionit në nivele të ulëta pozitive të cilat, sigurojnë qëndrueshmëri në tregje dhe mbështesin rritjen ekonomike.

Për të konkretizuar këtë angazhim, Banka e Shqipërisë do të vazhdojë të ruajë objektivin e inflacionit në formën e një bande, në intervalin 2 - 4 për qind për vitin 2005. Si objektiv i inflacionit vlerësohet rritja vjetore e indeksit të çmimeve të konsumit, matur dhe publikuar nga INSTAT.

### NIVELI I OBJEKTIVIT

Ruajtja e inflacionit në nivele të ulëta do të ketë një kontribut pozitiv në zhvillimin e ekonomisë shqiptare.

Së pari, duke qenë një normë pozitive inflacioni ajo mban parasysh evolucionin teknologjik të produkteve dhe përmirësimin cilësor të tyre. Gjithashtu, shumë studime kanë treguar se ecuria e inflacionit ka një prirje të brendshme statistikore për të regjistruar vlera pozitive. Në realitet, një nivel inflacioni afër 0 mund t'i korrespondojë një situate deflacioniste.

Së dyti, norma e ulët e inflacionit ndihmon në ruajtjen e normave pozitive të interesit real. Normat reale pozitive të interesit ndihmojnë në thithjen e kursimeve të qytetarëve në sistemin bankar, duke ndikuar në stabilitetin e këtij të fundit dhe në ruajtjen e aftësisë së tij për të plotësuar nevojat e ekonomisë dhe të qeverisë për mjete monetare.

Së treti, një normë e tillë inflacioni i përshtatet nevojave të zhvillimit të ekonomisë shqiptare, si një ekonomi në tranzicion. Ajo lehtëson lëvizjen e çmimeve relative duke kontribuar pozitivisht në rolin informues që përmban ky mekanizëm në shpërndarjen e fondeve në ekonomi. Shumica e vendeve të zhvilluara e përkufizojnë stabilitetin e çmimeve si një nivel inflacioni rreth 2 për qind. Duke qenë se Shqipëria është një vend në tranzicion, një nivel më i lartë inflacioni reflekton një rrezik më të lartë strukturor të pranishëm në ekonominë shqiptare si dhe një lëvizje më të madhe të çmimeve relative në të.

Së katërti, duke qenë në të njëjtin nivel me objektivin e inflacionit gjatë katër viteve të fundit, ai do të ndikojë pozitivisht në stabilizimin e pritjeve inflacioniste në ekonomi dhe në rritjen e sigurisë në marrjen e vendimeve ekonomike. Nga ana tjetër, një nivel i tillë inflacioni dhe politika monetare e kërkuar për përmbushjen e tij ndikojnë pozitivisht në ritmet e rritjes ekonomike, ashtu siç është provuar gjatë viteve të fundit.

### FORMA E OBJEKTIVIT

**Objektivi i inflacionit për vitin 2005 do të jetë në formën e intervalit 2 - 4 për qind.** Siç u parashtrua edhe më përpara, inflacioni është shpesh subjekt i veprimit të faktorëve të ofertës ose të rritjeve të administruara të çmimeve. Këto burime të lëvizjes së çmimeve janë jashtë ndikimit të politikës monetare. Megjithëse politika monetare është e vëmendshme edhe ndaj këtyre faktorëve, ata nuk janë subjekt i ndërhyrjeve të vazhdueshme të politikës monetare. Për këtë arsye, përcaktimi i objektivit në formë intervali ndikon pozitivisht në qëndrueshmërinë afatmesme të politikës monetare.

### MATJE TË TJERA TË INFLACIONIT

Banka e Shqipërisë, në funksion të rritjes së cilësisë së vendimmarrjes do të përdorë dhe matje të tjera të inflacionit. Këto matje krijojnë një bazë më të plotë për të marrë vendime sa më realiste. Kategoritë e tjera të inflacionit janë:

- **Inflacioni bazë.** Banka e Shqipërisë do të punojë në vazhdimësi gjatë vitit 2005 për të ndërtuar serinë e inflacionit bazë dhe për të perfeksionuar metodologjinë e llogaritjes së tij. Me ndërtimin dhe testimin e kësaj serie, inflacioni bazë do të jetë një input i rëndësishëm në marrjen e vendimeve të politikës monetare.
- **Inflacioni vjetor në nivel mesatar.** Kjo kategori përfaqëson nivelin mesatar të inflacionit vjetor për dymbëdhjetë muajt e fundit, duke dhënë një informacion të vlefshëm në lidhje me prirjet e zhvillimeve në çmimet e konsumit. Si i tillë, inflacioni vjetor në nivel mesatar do të jetë një orientues i rëndësishëm në procesin e marrjes së vendimeve të politikës monetare.

## OBJEKTIVAT E NDËRMJETËM DHE OBJEKTIVAT OPERACIONALË

Kontrolli i inflacionit bazohet në kontrollin e treguesve të tjerë, të cilët, nga njëra anë, kanë lidhje të fortë me objektivin e inflacionit dhe, nga ana tjetër, janë nën një kontroll më direkt të Bankës së Shqipërisë. Këta janë objektivat e ndërmjetëm dhe operacionalë (sasiorë). Objektivat e ndërmjetëm janë orientues (tregues), ndërsa objektivat operacionalë ndiqen me rigorozitet. Këta objektiva, së bashku me objektivin kryesor të Bankës së Shqipërisë, formojnë kuadrin e objektivave të saj.

**Objektivi i ndërmjetëm për vitin 2005 është rritja vjetore e ofertës së parasë (M3).** Përcaktimi i rritjes vjetore të M3 si objektiv i ndërmjetëm mbështetet në argumentin se inflacioni, duke qenë në përgjithësi fenomen monetar, ndikohet nga rritja në ofertën e parasë. Për këtë arsye, Banka e Shqipërisë synon të kontrollojë rritjen e mjeteve monetare në ekonomi në mënyrë që oferta e mjeteve monetare të korrespondojë me nevojën e ekonomisë për mjete monetare reale. **Duke u nisur nga parashikimi i rritjes ekonomike për vitin 2005, nga objektivi i Bankës së Shqipërisë për nivelin e inflacionit, si dhe nga trendet e zhvillimeve monetare, Banka e Shqipërisë do të synojë të kontrollojë rritjen e ofertës monetare në nivelin 9.4 për qind për vitin 2005.**

Banka e Shqipërisë do të vazhdojë të ruajë një regjim të lirë të kursit të këmbimit. Vlera e lekut kundrejt valutave të huaja do të përcaktohet lirisht në tregun e këmbimit, në përgjigje të ligjeve të kërkesës dhe ofertës. Banka e Shqipërisë do të jetë e pranishme me ndërhyrje të veçanta në tregun valutor, duke synuar zbutjen e lëvizjeve afatshkurtra të kursit të këmbimit të lekut, të cilat janë në kundërshtim me prirjet afatgjata dhe respektimin e objektivit të rezervës ndërkombëtare neto.

Kuadri i objektivave të politikës monetare plotësohet me përcaktimin e objektivave operacionalë të politikës monetare. Këta vendosin një lidhje më të ngushtë midis operacioneve të politikës monetare, objektivit të saj të ndërmjetëm dhe atij kryesor, arritjes dhe ruajtjes së stabilitetit të çmimeve. Objektivat operacionalë për vitin 2005, janë mjetet e brendshme neto të Bankës së Shqipërisë dhe rezervat ndërkombëtare neto të Bankës së Shqipërisë. Për secilin nga këta objektiva është vendosur një nivel sasior kundrejt të cilit kontrollohet puna e bërë për arritjen e tyre. Gjithashtu, Banka e Shqipërisë, për efekte të politikës monetare, ndjek dhe monitoron edhe kreditin e brendshëm neto për qeverinë, ndonëse ky nuk është objektiv operacional i saj.

- **Mjetet e brendshme neto të Bankës së Shqipërisë** përfaqësojnë shumën e pretendimeve të Bankës së Shqipërisë, përjashtuar pretendimet valutore të saj ndaj jorezidentëve. Më konkretisht, këtu bëjnë pjesë pretendimet e Bankës së Shqipërisë ndaj Qeverisë (për neto) si dhe pretendimet e Bankës së Shqipërisë ndaj bankave të nivelit të dytë. Për to vendoset një kufi i sipërm, që do të thotë se Banka e Shqipërisë nuk mund të rrisë gjendjen e mjeteve të brendshme neto përtej shifrës së vendosur kufi.
- **Rezervat ndërkombëtare neto të Bankës së Shqipërisë** përfaqësojnë mjetet valutore neto të Bankës së Shqipërisë minus të gjitha zotërimet valutore të bankave të nivelit të dytë të vendosura në Bankën e Shqipërisë (rezerva të detyrueshme në valutë plus rezervat e tepërta në valutë). Për to vendoset një kufi i poshtëm dhe përllogaritjet bazohen në kursin e këmbimit të fundit të muajit dhjetor të vitit 2003.
- **Krediti i brendshëm neto për Qeverinë** përfaqëson totalin e pretendimeve të sistemit bankar ndaj qeverisë minus depozitat e kësaj të fundit si në Bankën e Shqipërisë ashtu dhe në bankat e nivelit të dytë. Vendosja e një niveli kufi të sipërm ka si synim të vërë nën kontroll, brenda niveleve të paracaktuara, kreditimin e deficitit buxhetor nga ana e sistemit bankar. **Për vitin 2005, kufiri i sipërm i financimit të brendshëm të deficitit buxhetor është 23.4 miliardë lekë.**

Këto nivele sasiore rishikohen gjatë vitit, në përputhje me ecurinë e zhvillimeve monetare dhe të masave korrektuese të propozuara nga Banka e Shqipërisë në programin monetar.

Në përputhje me zgjerimin dhe me rritjen e konkurrencës në tregun bankar shqiptar, Banka e Shqipërisë do t'i kushtojë një rëndësi në rritje kontrollit të normave të interesit në tregun ndërbankar. Ndonëse ato nuk do të shërbejnë si një objektiv operacional i Bankës së Shqipërisë, normat e interesit të tregut ndërbankar janë një tregues i gjendjes monetare në ekonomi dhe një përcaktues i rëndësishëm i zhvillimit të ekonomisë.

## INSTRUMENTET E POLITIKËS MONETARE

Banka e Shqipërisë do të mbështetet në instrumentet indirekte të politikës monetare për të përmbushur objektivat e saj. Instrumentet e politikës monetare do të orientohen drejt përmbushjes së objektivave operacionalë të Bankës së Shqipërisë. Në përputhje me parimet e politikës monetare për vitin 2005, të përcaktuara më parë në këtë dokument, Banka e Shqipërisë nuk ka asnjë angazhim konkret në lidhje me ndërhyrjet në tregun valutor.

- **Operacionet e tregut të hapur[2]**

Operacionet e tregut të hapur kanë për qëllim administrimin e normave të interesit në ekonomi, administrimin e gjendjes së likuiditetit në treg si dhe sinjalizimin e politikës monetare.

Operacionet e tregut të hapur përfshijnë:

- **marrëveshjet e riblerjeve dhe marrëveshjet e anasjellta të riblerjeve**;
- **transaksionet e shitblerjeve me të drejta të plota;**
- **operacionet në tregun valutor.**

**Instrumenti kryesor** që përdoret për të përçuar sinjalet e politikës monetare është norma e interesit që aplikohet në marrëveshjet e riblerjes dhe marrëveshjet e anasjellta të riblerjes me afat njëjavor[3]. **Norma e interesit e aplikuar nga Banka e Shqipërisë në këto operacione luan rolin e normës bazë të interesit në ekonomi.** Norma bazë e interesit vendoset nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë dhe përdoret nga Banka e Shqipërisë në ankandet javore të marrëveshjeve të riblerjes (repove). Kjo normë përcakton edhe normën e interesit të depozitave dhe të huave njëditore të Bankës së Shqipërisë. Ajo ndikon normën e interesit të tregut ndërbankar, të depozitave në lekë pranë bankave tregtare si dhe të bonove të thesarit dhe të kredisë së akorduar në lekë për ekonominë.

[2] Në fjalorin bashkëngjitur jepet një sqarim më i detajuar i funksionimit të instrumenteve monetare.
[3] Operacionet e marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes njihen respektivisht si repo dhe repo të anasjellta.

- **Lehtësitë e përhershme**

Lehtësitë e përhershme ndikojnë në gjendjen e likuiditetit në sistemin bankar dhe pengojnë luhatjet e mëdha të normave të interesit. Lehtësitë e përhershme realizohen gjithmonë dhe ekskluzivisht me nismën e bankave të nivelit të dytë. Palë e Bankës së Shqipërisë në këto operacione janë vetëm bankat e nivelit të dytë. Lehtësitë e përhershme të ofruara nga Banka e Shqipërisë janë:

- **depozita njëditore;**
- **kredia njëditore;**
- **kredia lombard.**

- **Rezerva e detyruar**

Rezerva e detyruar është një instrument me anë të të cilit Banka e Shqipërisë i detyron bankat e nivelit të dytë, të vendosin një rezervë të caktuar në lekë dhe në valutë pranë saj. Nëpërmjet këtij instrumenti Banka e Shqipërisë synon në rregullimin e ofertës së parasë, të likuiditeteve dhe të normës së interesit në sistemin bankar si dhe në ruajtjen e sigurisë së sistemit.

Banka e Shqipërisë, në varësi të kushteve të tregut financiar shqiptar dhe të nevojave të politikës monetare do të vazhdojë të rishikojë në vazhdimësi instrumentet e saj të politikës monetare gjatë vitit 2005. Këto rishikime do të bëhen me synimin e rritjes së eficiencës së përdorimit të tyre.

## KOMUNIKIMI I VENDIMEVE TË POLITIKËS MONETARE

Politika monetare dhe vendimet e marra në zbatim të saj i komunikohen publikut nëpërmjet këtyre dokumenteve:

- Dokumenti i politikës monetare që përshkruan parimet kryesore të kësaj politike të miratuar për një vit.
- Deklarata e politikës monetare, e cila përshkruan zhvillimet monetare në gjashtë muajt e kaluar dhe perspektivën për gjashtë muajt e ardhshëm.
- Opinion mbi gjendjen e ekonomisë gjatë tremujorit ku jepen zhvillimet tremujore ekonomike dhe monetare.
- Raporti Mujor i Politikës Monetare, i cili përshkruan zhvillimet monetare mujore dhe jep vlerësimin mbi qëndrimin që duhet mbajtur në të ardhmen.
- Publikimi i vendimeve të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë në lidhje me normat e interesit brenda 48 orëve nga marrja e vendimit.
- Konferencat e shtypit të Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë për të komunikuar dhe shpjeguar vendimet e politikës monetare.

Gjithashtu, komunikimi i politikës monetare realizohet edhe nëpërmjet publikimit të të gjitha rregulloreve dhe akteve të tjera, që kanë të bëjnë me instrumentet e përdorura për zbatimin e politikës monetare.

## FJALOR

- **Marrëveshjet e riblerjes / të anasjellta të riblerjes**

Këto marrëveshje përbëjnë një instrument me anë të të cilit Banka e Shqipërisë tërheq ose hedh *përkohësisht* likuiditet në sistemin bankar. **Marrëveshja e riblerjes** është një instrument që përdoret për të pakësuar *përkohësisht* likuiditetin në sistemin bankar. **Marrëveshja e anasjelltë e riblerjes** përbën një instrument që përdoret për të shtuar *përkohësisht* likuiditetin në sistemin bankar ose aftësinë e bankave për të rritur kredidhënien apo për të rritur paranë në qarkullim. Marrëveshjet e riblerjeve dhe të anasjellta të riblerjeve me afat njëjavor realizohen nëpërmjet **ankandeve standarde.** Ndërsa marrëveshjet me afat njëditor, njëmujor dhe tremujor realizohen nëpërmjet **ankandeve të shpejta**.

- **Transaksionet e shitblerjeve me të drejta të plota**

Banka e Shqipërisë, pakëson likuiditetin në treg nëpërmjet transaksioneve të shitjeve me të drejta të plota dhe e shton atë nëpërmjet transaksioneve të blerjeve me të drejta të plota. Këto transaksione kryhen në formën e blerjeve apo të shitjeve të bonove të thesarit me afat maturimi deri një vit apo të letrave të borxhit me kredibilitet të lartë.

- **Operacionet në tregun valutor**

Operacionet në tregun valutor kryhen nga Banka e Shqipërisë nëpërmjet blerjes dhe shitjes së valutës në treg, kur ajo synon të veprojë në treg. Këto operacione kryhen në funksion të përmbushjes së politikës së përcaktuar në këtë Dokument.

- **Depozita njëditore**

Depozita njëditore ndihmon bankat e nivelit të dytë të veprojnë me likuiditetin e tepërt, duke e depozituar atë vetëm për një ditë në Bankën e Shqipërisë. Gjithashtu, depozita njëditore ndihmon në tërheqjen e likuiditetit të tepërt nga sistemi bankar dhe në zbutjen e luhatjeve të mëdha në normat afatshkurtra të interesit. Norma e interesit për depozitën njëditore përfaqëson normën më të ulët të interesit në treg, që ofrohet nga Banka e Shqipërisë.

- **Kredia njëditore**

**Kredia njëditore** është një kredi plotësisht e garantuar, që akordohet për të ndihmuar bankat e nivelit të dytë të zgjidhin problemet njëditore të likuiditetit. Gjithashtu, ajo ndihmon për të zbutur luhatjet e normave afatshkurtra të interesit. Norma e interesit të kredisë njëditore është më e lartë se norma bazë e interesit.

- **Kredia lombard**

Kredia lombard përdoret për të ndihmuar bankat e nivelit të dytë të kapërcejnë problemet e përkohshme të likuiditetit. Kjo është kredi plotësisht e garantuar me afat maturimi deri në tre muaj. Norma e interesit të kësaj kredie përfaqëson normën më të lartë të interesit të vendosur nga Banka e Shqipërisë.

# ZHVILLIMET NË SEKTORIN E JASHTËM TË EKONOMISË PËR NËNTËMUJORIN E VITIT 2004

Bilanci i përgjithshëm i pagesave, për nëntëmujorin e parë të vitit 2004 rezultoi me një tepricë prej 228 milionë usd. Flukset hyrëse të kapitalit kanë qenë plotësisht të mjaftueshme për të përballuar nivelin e deficitit korent.

Zhvillimet kryesore në sektorin e jashtëm të ekonomisë shqiptare mund t'i përgjithësojmë në:

- Zvogëlim të deficitit korent, në krahasim[1] me një vit më parë, si në vlerë absolute ashtu edhe në përqindje ndaj Produktit të Brendshëm Bruto (PBB).
- Rritje të qëndrueshme në eksporte pavarësisht nga përkeqësimi në konkurrueshmëri (zhvillimet në kursin e këmbimit).
- Përmirësim në raportin e mbulimit të importeve nga eksportet.
- Dyfishim i flukseve hyrëse në formën e investimeve të huaja direkte.
- Rritje në detyrimet financiare ndaj jorezidentëve, shkaktuar kryesisht prej rritjes së fluksit të investimeve të huaja direkte, si dhe rritjes së huamarrjes private.
- Rritje e pretendimeve të vendit ndaj jorezidentëve, e shprehur kryesisht në rritje të depozitave të njësive rezidente jashtë.
- Rritje në stokun e rezervave valutore të autoritetit monetar si dhe e koeficientit të mjaftueshmërisë së rezervave valutore për importe mallrash dhe shërbimesh.
- Vazhdon zhvlerësimi i dollarit amerikan si ndaj monedhës evropiane, ashtu edhe ndaj lekut. Efekti i zhvlerësimit të dollarit duhet të merret parasysh sidomos në transaksionet e kryera në monedha të tjera (euro).

## I. LLOGARIA KORENTE

Transaksionet korente vlerësohen në rreth 4.3 miliardë usd ose 21 për qind më të larta se në vitin paraardhës. Përveç tregtisë së jashtme në mallra dhe shërbime, në këtë rritje kanë kontribuar dhe transfertat korente. Deficiti korent vlerësohet në rreth 212 milionë dollarë ose 19 për qind më i vogël se në vitin 2003 (në vlerë absolute zvogëlimi i deficitit korent vlerësohet në 49 milionë usd).

Përmirësimi i pozicionit të deficitit korent erdhi si rezultat i rritjes së transfertave pa shpërblim dhe suficitit në shërbime, si dhe i luhatjeve të vërejtura në këmbimin e dollarit kundrejt euros dhe lekut. Ndërkohë që, është thelluar deficiti i tregtisë në mallra dhe janë zvogëluar të ardhurat neto nga investimet.

### I. 1. TREGTIA E JASHTME.

Vëllimi i tregtisë së jashtme, importe plus eksporte, për nëntëmujorin e parë të vitit 2004 vlerësohet në rreth 1.97 miliardë usd, duke përfaqësuar rreth 45 për qind të totalit të transaksioneve korente. Shpenzimet për import mallrash shënuan afërsisht vlerën 1.5 miliardë usd ose 242 milionë usd më shumë, ndaj të njëjtës periudhë në vitin 2003. Të ardhurat nga eksporti i mallrave u rritën me 36 për qind, duke arritur në 442 milionë dollarë.

Analiza e dinamikës strukturore të importit nxjerr në pah rritjen e vazhdueshme të importeve në mallra kapitale, si dhe në importe të lëndëve të para për industrinë e përpunimit aktiv në vend. Gjithashtu e lartë mbetet kërkesa për mallra ushqimorë.

[1] Të gjitha krahasimet bëhen me nëntëmujorin e parë të vitit 2003.

Struktura e eksporteve vuan nga shkalla e ulët e diversifikimit. Kështu, këtë nëntëmujor rreth 76 për qind e vëllimit të eksporteve përbëhet nga eksportet në grupmallrat e lartpërmendur.

Në vlera absolute, rritja e importeve, nga viti në vit, është shoqëruar me rritje modeste të eksporteve. Megjithatë, gjatë dy viteve të fundit rritja e eksporteve ka qenë më premtuese. Shkalla e mbulimit të importeve nga eksportet këtë periudhë arriti në 29 për qind nga 25 për qind në vitin 2003.

### I. 2. ZHVILLIMET NË ZËRAT E TJERË TË LLOGARISË KORENTE.

Pas deficiteve të njëpasnjëshme, të regjistruara gjatë dy viteve të fundit, bilanci i shërbimeve këtë nëntëmujor iu kthye përsëri shifrave pozitive (22 milionë usd).

Eksporti i shërbimeve vazhdon të dominohet nga aktiviteti i turizmit. Sipas vlerësimeve të Bankës së Shqipërisë, turizmi ka gjeneruar rreth 492 milionë usd flukse të ardhurash në shërbime ose rreth 11 për qind më shumë se eksporti i mallrave, si pasojë e rritjes si në numrin e turistëve ashtu edhe në shpenzimet ditore të tyre.

Ndërkohë, shqiptarët kanë shpenzuar në udhëtimet e tyre jashtë shtetit rreth 395 milionë usd ose sa 58 për qind të totalit të dërgesave nga emigrantët. Të ardhurat nga turizmi janë rritur më shpejt se sa shpenzimet në krahasim me vitin e kaluar. Në fund të nëntëmujorit, bilanci pozitiv i kësaj kategorie vlerësohej 98 milionë usd nga 35 në vitin 2003.

Shërbimet e transportit dhe ato të sigurimit ndjekin zhvillimet në aktivitetin tregtar të mallrave. Rritja e vëllimit të importit ka shkaktuar rritjen e importit të shërbimeve në këto kategori. Njëkohësisht, pjesëmarrja gjithnjë e më e madhe e shoqërive rezidente të transpedicionit, që ofrojnë shërbime në tregtinë e jashme, ka rritur, gjithashtu, të ardhurat e kësaj kategorie. Megjithatë, në fund të nëntëmujorit, deficitet në shërbime transporti dhe sigurimi vlerësohen në rritje ndaj vitit të kaluar, respektivisht me 13 dhe 33 për qind.

Kategoria "shërbime të tjera" ka regjistruar një suficit prej 13 milionë usd. Eksportet e kësaj kategorie vlerësohen në nivelin 126 milionë usd, nga të cilat 39 për qind i zënë shërbimet e komunikacionit, kryesisht ato të telefonisë.

Bilanci pozitiv i të ardhurave, në fund të nëntëmujorit, vlerësohet rreth 128 milionë usd. Rreth 63 për qind e të ardhurave ose 92 milionë usd, janë të ardhura nga puna, të cilat vlerësohen si një pjesë e prurjeve të emigrantëve, nën supozimin që një pjesë e numrit të përgjithshëm të emigrantëve, futet në kategorinë e punonjësve sezonalë apo kufitarë. Të ardhurat e kësaj kategorie vlerësohen 7 për qind më të larta ndaj një viti me parë, ndikuar nga rritja e kërkesës për fuqi punëtore në shtetin fqinjë Greqi, gjatë organizimit të Lojërave Olimpike 2004. Pjesa tjetër e të ardhurave që sigurohen nga investimet regjistroi rënie, duke bërë që suficiti i kategorisë "të ardhura" të zvogëlohet me 4 për qind ndaj një viti më parë.

Transfertat korente, ashtu si edhe gjatë viteve të kaluara, kanë marrë formë prej prurjeve nga emigrantët. Këto të fundit përfaqësojnë burimin kryesor të financimit të deficitit në tregti mallrash dhe shërbimesh, në masën 64 për qind. Gjatë nëntëmujorit të vitit 2004, fluksi hyrës i dërgesave nga emigrantët u vlerësua në nivelin 679 milionë usd duke qenë 21 për qind më të larta se ato të vitit të kaluar. Megjithatë, duke pasur parasysh monedhat në të cilat kryhen këto transferta, mund të themi se edhe në këtë zë, efekti i kursit të këmbimit është i ndjeshëm.

Prurjet nga emigrantët (679 milionë usd) janë shoqëruar edhe nga transferta shtetërore, kryesisht në formë të asistencës teknike (28 milionë usd), të cilat vlerësohen në rënie (23 për qind).

## II. LLOGARIA KAPITALE DHE FINANCIARE

Lëvizjet e kapitalit, gjatë nëntëmujorit të parë të vitit 2004, regjistruan një fluks neto prej rreth 327 milionë usd, duke mundësuar plotësisht financimin e deficitit korent, si dhe kanë çuar në rritjen e rezervës valutore. Transfertat kapitale shënojnë 93.4 milionë usd ose 20 milionë më pak krahasuar me nëntëmujorin e vitit 2003, ndërkohë që, llogaria financiare u mbyll me një bilanc pozitiv prej 223.6 milionë usd. Ky import kapitalesh i realizuar në masën më të madhe prej thithjes së investimeve të huaja direkte dhe prej lëvrimeve të kredive afatgjata dhe të zbutura nga jashtë, ka shkaktuar rritjen e detyrimeve

financiare të Shqipërisë ndaj pjesës tjetër të botës, me rreth 441 milionë usd. Kjo rritje vlerësohet 78 për qind më e lartë se ajo e një viti më parë.

Investimet e huaja direkte, për nëntëmujorin e parë të vitit 2004, vlerësohen në nivelin 284 milionë usd. Këto flukse kapitali janë shndërruar në një faktor dominues në rritjen e detyrimeve financiare dhe në zhvillimet e transaksioneve kapitale e financiare të vendit. Këtë vit ato prezantohen kryesisht në formën e privatizimit të sistemit bankar, me një fluks 2.2 herë më të lartë kundrejt të njëjtës periudhë në vitin 2003.

Faktor tjetër i rëndësishëm në rritjen e detyrimeve financiare kanë qenë lëvrimet e kredive afatgjata dhe atyre të buta nga jashtë, të cilat e kanë shtuar borxhin e jashtëm të Shqipërisë me 160 milionë usd. Në këtë borxh, përfshihet edhe përdorimi i huave dhe kredive në Fond prej 12 milionë usd. Në masë të konsiderueshme (47 për qind) huamarrja është përdorur nga sektori privat dhe vlerësohet rreth 5.5 herë më e lartë, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2003. Shërbimet e borxhit të jashtëm në formën e pagesave të principalit, gjatë periudhës arritën në 31 milionë usd.

Detyrimet financiare në formën e depozitave të jorezidentëve në sistemin tonë bankar, gjatë këtij nëntëmujori, kanë rënë me rreth 4.4 milionë usd. Detyrimet në formën e kredisë tregtare u rritën me 16 milionë usd, e reflektuar kjo edhe në rritje të importeve për këtë periudhë.

Pretendimet financiare të Shqipërisë ndaj pjesës tjetër të botës janë rritur me 207.4 milionë usd ose rreth 86 për qind më shumë se në një vit më parë. Rreth 60 për qind e kësaj rritjeje është regjistruar gjatë tremujorit të tretë, kryesisht si pasojë e rritjes në depozitat e njësive rezidente jashtë. Ky fluks i madh depozitash nga brenda-jashtë ka ardhur kryesisht nga konvertimi i kapitalit të Bankës "Raiffeisen" si dhe nga një zhvendosje në formën e investimit – nga investime portofoli në depozita. Investimet e portofolit për periudhën ranë me rreth 122 milionë usd.

Flukset hyrëse të mjeteve valutore në formën e kapitaleve financiare u reflektuan në rritje të rezervave valutore të autoritetit monetar, me rreth 228 milionë usd. Niveli i rezervave valutore bruto, në fund të periudhës, u vlerësua në 1 miliardë e 244 milionë usd, i mjaftueshëm për të përballuar 5.1 muaj importe mallrash dhe shërbimesh.

**Bilanci i Pagesave**

Në milionë dollarë amerikanë

| | 9m 2003 | 3m-I 2004 | 3m-II 2004 | 3m-III 2004 | 9m 2004 |
|---|---|---|---|---|---|
| Llogaria korente | -261.2 | -77.9 | -108.4 | -25.7 | -212.1 |
| Eksporti i mallrave | 324.3 | 136.5 | 156.5 | 148.7 | 441.7 |
| Importi i mallrave | -1281.9 | -454.4 | -514.6 | -554.5 | -1523.4 |
| Bilanci tregtar | -957.6 | -317.9 | -358.0 | -405.8 | -1081.8 |
| Shërbimet: Kredi | 521.7 | 196.7 | 237.9 | 255.4 | 690.0 |
| Shërbimet: Debi | -565.8 | -202.8 | -237.2 | -228.3 | -668.4 |
| Të ardhurat: Kredi | 150.0 | 41.6 | 40.4 | 65.2 | 147.2 |
| Të ardhurat: Debi | -16.8 | -5.3 | -8.3 | -5.8 | -19.5 |
| Transferta private pa shpërblim | 564.8 | 196.8 | 200.5 | 281.7 | 679.0 |
| Transferta shtetërore pa shpërblim | 42.5 | 13.0 | 16.4 | 11.9 | 41.3 |
| Llogaria kapitale | 113.1 | 34.0 | 25.7 | 33.6 | 93.4 |
| Llogaria financiare | 124.8 | 22.9 | 203.2 | -4.3 | 221.7 |
| Investime direkte | 128.3 | 35.0 | 176.7 | 71.9 | 283.6 |
| Investime portofoli | -20.9 | -1.3 | 4.0 | 119.8 | 122.5 |
| Kapitale të tjera* | 17.4 | -10.8 | 22.5 | -196.0 | -184.3 |
| Gabime dhe harresa neto | 90.7 | 29.9 | -3.0 | 85.9 | 112.8 |
| Bilanci i përgjithshëm | 78.5 | 14.9 | 117.4 | 95.3 | 227.6 |
| Rezervat dhe zëra të lidhur me to | | | | | |
| Mjetet e rezervës | -78.5 | -14.9 | -117.4 | -95.3 | -227.6 |
| Përdorim huash e kredish nga FMN | 11.1 | 6.0 | 0.0 | 5.9 | 11.9 |
| Për t'u mbajtur në vëmendje | | | | | |
| Ndryshimi total në rezerva | -120.9 | -2.6 | -113.9 | -103.2 | -219.6 |
| nga të cilat: ndryshim nga kursi i këmbimit | 42.4 | -12.3 | -3.6 | 7.8 | -8.0 |

*/ nuk përfshihen përdorime huash e kredish nga FMN.

# DEKLARATË E BANKËS SË SHQIPËRISË MBI STABILITETIN E SISTEMIT FINANCIAR NË SHQIPËRI

Banka e Shqipërisë konstaton se në pjesën e dytë të vitit 2004, u evidentuan zhvillime pozitive në sistemin bankar, të cilat lidhen kryesisht me forcimin e kushteve të konkurrencës në vend. Qëndrueshmëria në zgjerimin e numrit të degëve të bankave, është shoqëruar nga një lëvizje më e shpejtë në drejtim të prezantimit të instrumenteve bashkëkohore të pagesave, veçanërisht të veprimtarisë me kartat e debitit dhe të kreditit. Vendosja në funksionim e mbi 76 makinave automatike për tërheqjen e *cash*-it, është pasuar gjithashtu nga përpjekjet për të instaluar terminale të shitjeve me karta debiti dhe krediti, fillimisht pranë institucioneve të rëndësishme sociale. Ndër treguesit kryesorë financiarë të sistemit bankar për periudhën e kaluar, përmendim:

| Treguesi | Qershor '04 | Nëntor '04* |
|---|---|---|
| Mjaftueshmëria e kapitalit | 26.97% | 25.12% |
| Kapitali aksioner (milionë lekë) | 23,291.71 | 26,471.70 |
| Rezultati neto (milionë lekë) | 2,550.61 | 4,950.70 |
| Kredia e re (milionë lekë) | 56,400.00 | 88,800,00 |
| Kredia me probleme neto / kredia neto | 1.02% | 1.28% |
| Kredia me probleme, bruto / totali i bilancit | 0.61% | 0.64% |

* Në fundin e muajit shtator 2004

Banka e Shqipërisë i vlerëson si të rëndësishme dhe aktuale, çështjet e ngritura në të njëjtin dokument, të publikuar në muajin gusht 2004, për zhvillimet në gjashtëmujorin e parë të vitit të kaluar. Nisur nga rëndësia që ne i japim, e shohim të nevojshme të theksojmë këto elemente të tij, dhe konkretisht:

· **Forcimi i sistemeve të kontrollit.** Bankat duhet të forcojnë në vazhdimësi sistemet e tyre të identifikimit dhe të administrimit të rrezikut, në një kohë kur konkurrenca në treg është në rritje. Theksi duhet vendosur në përshtatjen e praktikave të nevojshme për monitorimin e veprimtarive kryesore dhe delikate të bankave, që lidhen kryesisht me sistemet e teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit, me veprimtarinë e këmbimit valutor dhe të investimit të fondeve etj.. Një vëmendje e veçantë i duhet kushtuar veprimtarisë së kreditimit, ku ka nevojë për përmirësimin dhe për plotësimin e procedurave, për identifikimin dhe për zhvillimin e mënyrave që lejojnë shkëmbimin e informacionit midis bankave mbi huamarrësit dhe cilësinë e tyre etj..

· **Përgjegjësia e strukturave drejtuese.** Strukturat drejtuese të bankës, duke përfshirë këshillin drejtues, komitetin e kontrollit dhe drejtuesit ekzekutivë, kanë përgjegjësinë kryesore për të krijuar kushtet dhe për të zbatuar kërkesat e mësipërme.

· **Roli i publikut.** Është e rëndësishme që në këtë proces, klientët dhe publiku në përgjithësi, të njohin dhe të luajnë rolin që iu takon. Klientët dhe publiku kanë të drejtë të kërkojnë transparencë veprimi në praktikat bankare, trajtim të barabartë sipas kategorive të klientëve, si edhe të ushtrojnë monitorim të vazhdueshëm për të drejtat dhe detyrimet e tyre financiare me bankën. Nëpërmjet ushtrimit të të drejtave të tyre, klientët dhe publiku në përgjithësi ushtron një rol kontrollues mbi veprimtarinë bankare dhe kontribuon në kryerjen e saj sipas praktikave më të mira.

· **Pakësimi i *cash*-it në ekonomi.** Sistemi bankar mund të luajë një rol edhe më aktiv në qëllimin e përbashkët për reduktimin e transaksioneve në *cash* dhe reduktimin e ekonomisë informale. Zgjerimi i aktivitetit bankar dhe afrimi i tij i mëtejshëm pranë publikut si edhe prezantimi i produkteve të reja që nxisin format e reja të pagesës dhe ofrojnë komoditetin e dëshiruar, janë zhvillime të cilat mbështeten

fuqishëm nga Banka e Shqipërisë për t'u vijuar edhe në të ardhmen. Ne besojmë se ky proces do të ishte më i suksesshëm, nëse do të kishte një angazhim edhe më të madh të të gjitha institucioneve përkatëse të shtetit. Në vazhdim, Banka e Shqipërisë tërheq vëmendjen e bankave, të institucioneve të tjera të vendit dhe të publikut, për çështjet që vijojnë:

· **Zbatimi i standardeve.**
Standardet ndërkombëtare në fushën e kuadrit rregullativ dhe të ndjekjes së veprimtarisë bankare, kanë njohur zhvillime të reja. Këto zhvillime, lidhen me publikimin përfundimtar të dokumentit të Akordit të Ri të Bazelit (i njohur ndryshe, si Bazel II) dhe me zhvillimet në drejtim të standardeve të mbajtjes së kontabilitetit dhe të raportimit të pasqyrave financiare (të njohura ndryshe si IAS/IFRS). Detyrimet që rrjedhin nga kërkesat e kuadrit ligjor vendas, nga llojshmëria dhe origjina e institucioneve bankare që operojnë në vend, si edhe nga nevoja që veprimtaria e tyre të orientohet gjithnjë e më tepër sipas standardeve më të mira ndërkombëtare, e bëjnë të pashmangshëm ndikimin e këtyre ndryshimeve në veprimtarinë e sistemit bankar dhe financiar në vendin tonë, si edhe në marrëdhëniet e tij me të tretët.

· **Harmonizimi i veprimeve.**
Bankat dhe institucionet e tjera financiare, të cilat kanë rol në zbatimin në praktikë të standardeve të përmendura më sipër, duhet të kenë një strategji të qartë për mënyrën se si do të realizojnë këtë rol dhe objektivat e tyre. Banka e Shqipërisë mendon se është i nevojshëm të institucionalizohet një proces i përbashkët diskutimi, ku të diskutojmë problemet që do të dalin në fazën përgatitore, në mënyrë që problemet, jo vetëm të kuptohen, por edhe zgjidhja e tyre të jetë e harmonizuar dhe e qëndrueshme në kohë.

Së fundi, Banka e Shqipërisë pret që gjatë vitit 2005, sistemi bankar dhe ai financiar të konsolidojnë arritjet e deritanishme nëpërmjet vazhdimit të një veprimtarie të qëndrueshme, duke dhënë një kontribut më të rëndësishëm në zhvillimin e ekonomisë në vend.

# LAJMET PËR PERIUDHËN TETOR - DHJETOR 2004

### *Z. Ardian Fullani zgjidhet Guvernator i Bankës së Shqipërisë*

Me vendimin nr. 152 të datës 28.10.2004, Kuvendi i Shqipërisë zgjodhi z. Ardian Fullani në detyrën e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë. Në të njëjtën kohë, me vendimin nr. 148 të datës 07.10.2004 dhe me vendimin nr. 159 të datës 18.11.2004, z. Ardian Fullani, z. Fatos Ibrahimi, z. Andis Harasani, zj. Elisabeta Gjoni, z. Ksenofon Krisafi, zj. Tefta Çuçi dhe z. Limos Malaj u zgjodhën anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës.

### *Mbi takimin me drejtuesit e Misionit të Programit të Vlerësimit të Sektorit Finaciar*

Në datat 9-10 nëntor 2004, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Ardian Fullani, priti në takim përfaqësuesit e Bankës Botërore (BB) dhe të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), përkatësisht Kryespecialistin e Sektorit Financiar në BB dhe Asistenten e Drejtorit të Kërkimeve në FMN, të cilët do të drejtojnë Programin e Vlerësimit të Sektorit Financiar (FSAP), që do të zhvillohet në vendin tonë në fillim të vitit të ardhshëm.

Siç dihet, FSAP është një program i përbashkët i FMN-së dhe BB-së, që ka për qëllim identifikimin e pikave të forta dhe të dobëta të sistemeve financiare të vendeve anëtare, përcaktimin e rrugëve dhe të mënyrave të administrimit të rreziqeve kryesore, evidentimin e nevojave për asistencë teknike duke kontribuar kështu në formulimin e politikave për të ardhmen. Një element kyç për të, janë vlerësimet e hollësishme të këtyre institucioneve mbi zbatimin e kodeve e standardeve të ndryshme ndërkombëtare.

Në takim, u theksua nevoja e pjesëmarrjes aktive të sektorit bankar në këtë program dhe në veçanti, u diskutua rreth rolit të Bankës së Shqipërisë, kryesisht lidhur me transparencën e kryerjes së funksionit mbikëqyrës dhe të politikës monetare, si dhe në lidhje me sigurinë dhe funksionimin normal të sistemeve të rëndësishme të pagesave. Nga ana e tij, Guvernatori shprehu gatishmërinë për një bashkëpunim të plotë të Bankës së Shqipërisë për sa i përket zbatimit të programit FSAP dhe siguroi palën tjetër për një organizim të punës brenda institucionit në shërbim të plotësimit të shpejtë dhe cilësor të kërkesave të misionit.

Në përfundim, të dyja palët vlerësuan bashkëpunimin e deritanishëm midis institucioneve përkatëse dhe shprehën sigurinë se Programi i Vlerësimit të Sektorit Financiar do të ofrojë jo vetëm një vlerësim real të situatës së sistemit financiar në vend, por edhe rekomandime të vlefshme për fuqizimin dhe mirëfunksionimin e tij në të ardhmen.

### *Rreth takimit me Drejtorin Ekzekutiv për Shqipërinë në Bankën Botërore, z. Biagio Bossone*

Më datë 16 nëntor 2004, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Ardian Fullani, priti në takim Drejtorin Ekzekutiv për Shqipërinë, z. Biagio Bossone.

Biseda ndërmjet z. Fullani dhe z. Bossone u fokusua mbi fushat konkrete të asistencës së Bankës Botërore si, mbështetja financiare për realizimin e dy sistemeve moderne të pagesave, RTGS dhe AECH, programin FSAP për modernizimin e mbikëqyrjes bankare si element shumë i rëndësishëm në konsolidimin e sistemit bankar, zhvillimin dhe modernizimin e statistikave të Bankës së Shqipërisë, administrimin e burimeve njerëzore etj.. Në të njëjtën kohë, z. Fullani theksoi rëndësinë e veçantë të zhvillimit të sistemit financiar duke filluar nga shoqëritë e sigurimeve, mbikëqyrja e të cilave do të rritet në të ardhmen.

Nga ana e tij, z. Bossone shprehu mbështetjen e Bankës Botërore dhe sigurinë që projektet e bashkëpunimit midis Bankës së Shqipërisë dhe Bankës Botërore do të vazhdojnë të jenë të suksesshme edhe në të ardhmen, me synim konsolidimin dhe qëndrueshmërinë e sistemit bankar shqiptar.

Z. Bossone mori pjesë edhe në përurimin e punës për Projektin e Kryqëzimit të Pagesave në Vlerë të Vogël, i cili po realizohet nga Banka e Shqipërisë me mbështetjen financiare të Bankës Botërore.

### *Mbi fillimin e punës për sistemin e kryqëzimit të pagesave në vlerë të vogël*

Më datë 16 nëntor 2004, në Hotel "Sheraton" u përurua projekti për ndërtimin e sistemit të kryqëzimit të pagesave në vlerë të vogël (AECH – *Automated Electronic Clearing House*), një nismë e re e Bankës së Shqipërisë për modernizimin e sistemit të pagesave, mbështetur financiarisht nga Banka Botërore, i cili pritet të përfundojë në qershor 2005. Në këtë ceremoni morën pjesë Drejtori Ekzekutiv për Shqipërinë në Bankën Botërore në Washington, z. Biaggio Bossone, përfaqësuesi i Bankës Botërore në Tiranë, përfaqësues të lartë nga Kuvendi, Ministria e Financave, Ministria e Ekonomisë, bankat e nivelit të dytë, kompania amerikane "Montran", Dhoma e Tregtisë dhe e Industrisë etj..

Në fjalën e tij, Guvernatori u shpreh se qëllimi i projektit ishte ulja e kostove, rritja e shpejtësisë dhe përmirësimi i sigurisë në pagesat bankare. Fjalën e morën edhe Drejtori Ekzekutiv për Shqipërinë në Bankën Botërore, z. Bossone, si dhe z. Dimitris Karavias, Zëvendëskryetar i Shoqatës Shqiptare të Bankave (AAB), të cilët vunë në dukje rëndësinë e këtij projekti së bashku me mbështetjen e vazhdueshme ndaj tij të institucioneve që ata përfaqësojnë.

Në takim u theksuan edhe objektivat e projektit si zhvillimi i mëtejshëm dhe përafrimi me standartet ndërkombëtare të sistemit të pagesave në Shqipëri, rritja e eficiencës dhe sigurisë në realizimin e pagesave jo*cash*, ulja e mëtejshme e përdorimit të *cash*-it si mjet pagese, përmirësimi i sistemit të faturimit dhe shlyerjes së kompanive të shërbimeve "utilitare", përmirësimi i shpërndarjes së pensioneve apo përfitimeve sociale, veçanërisht në zonat rurale, si dhe arritja e një sistemi të besueshëm, të sigurtë e të integruar për pagesat.

Sistemi do të jetë i vendosur fillimisht në Bankën e Shqipërisë dhe anëtarë të tij do të jenë pothuajse të gjitha bankat e nivelit të dytë.

### *Rreth takimit me përfaqësuesit e Misionit të Fondit Monetar Ndërkombëtar*

Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Ardian Fullani, zhvilloi në datën 1 dhjetor 2004 takimin e parë zyrtar me përfaqësuesit e Misionit të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) të Departamentit të Çështjeve Evropiane EU1, të kryesuar nga z. Julio Escolano. Qëllimi i këtij Misioni ishte vlerësimi i zbatimit të marrëveshjes që autoritetet shqiptare kanë nënshkruar me FMN-në, si dhe vlerësimi i efektivitetit të të gjitha marrëveshjeve të mëparshme, me qëllim vlerësimin e përshtatshmërisë së nënshkrimit të një marrëveshjeje të re me Shqipërinë.

Z. Fullani theksoi se përparësi për Bankën e Shqipërisë do të vazhdojë të mbetet qëndrueshmëria e përgjithshme makroekonomike dhe ajo e sektorit financiar të vendit. Edhe shefi i Misionit, z. Escolano, shprehu rëndësinë e veçantë të këtij misioni, për faktin se do të bëhej një vlerësim i frytshmërisë të marrëveshjeve të nënshkruara deri më tani me autoritetet shqiptare. Në të njëjtën kohë, ai u fokusua në disa probleme, të cilat mund të përmblidhen në: rishikimin e kujdesshëm të rritjes së pritshme të PBB-së; nevojën për një vlerësim të Shqipërisë nga një agjenci e specializuar; perfeksionimin e mëtejshëm të tregut financiar; rritjen cilësore të statistikave makroekonomike etj.. Gjatë qëndrimit të Misionit në Shqipëri, u diskutua rreth këtyre problemeve në nivel ekspertësh.

### *Sfidat e politikës monetare në kuadër të përafrimit të Bankës së Shqipërisë me Bankën Qendrore Evropiane*

Më datë 6 dhjetor 2004, në mjediset e Hotel "Rogner", u organizua seminari me temë "Sfidat e politikës monetare në kuadër të përafrimit të Bankës së Shqipërisë me Sistemin Evropian të Bankave Qendrore", bashkëpunim i Bankës së Shqipërisë me GTZ-në.

Qëllimi i seminarit ishte përcaktimi i një programi të qartë për hapat e mëtejshëm të asistencës

teknike që do të ofrohet nga ekspertë evropianë në kuadër të procesit të përafrimit, si dhe hapat e nevojshëm për zbatimin e kësaj asistence. Në mënyrë të veçantë, gjatë këtij seminari u detajuan kontributet dhe skemat e mundshme të bashkëpunimit me partnerët evropianë me synim mbështetjen e politikës monetare shqiptare drejt suksesit.

Në fjalën e tij përshëndetëse, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Ardian Fullani, shprehu angazhimin për përafrimin e Bankës së Shqipërisë me Sistemin Evropian të Bankave Qendrore si njërën prej sfidave kryesore të tij, si dhe parashtroi disa nga hapat kryesorë që duhen ndërmarrë nga Banka e Shqipërisë gjatë këtij procesi. Si hapa kryesorë z. Fullani përcaktoi rishikimin e kuadrit ligjor dhe rregullues të Bankës së Shqipërisë, rishikimin e sistemit organizativ dhe institucional, si dhe përmirësimin e politkës monetare dhe të kuadrit operacional.

### *Mbi takimin me drejtorët e bankave të nivelit të dytë që operojnë në Shqipëri*

Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Ardian Fullani, zhvilloi në datën 9 dhjetor 2004, në mjediset e Bankës së Shqipërisë, një takim me drejtorët e bankave të nivelit të dytë. Në fjalën e tij, Guvernatori theksoi rëndësinë e këtij takimi si një shenjë e hapur e bashkëpunimit dhe e përgjegjësisë së Bankës së Shqipërisë në raport me sistemin bankar në vend, si dhe u përqendrua në pritshmëritë e Bankës së Shqipërisë për fundin e vitit 2004 e më tej. Në të njëjtën kohë, z. Fullani shprehu bindjen se reduktimi i parasë në ekonomi dhe formalizimi i ekonomisë shqiptare do të vijë nëpërmjet shërbimeve të reja bankare me një theks të veçantë në zhvillimin e kartave të kreditit.

Nga ana tjetër, një nga problemet kryesore të ngritura nga bankat e nivelit të dytë kishte të bënte me kreditimin e bujqësisë si një nga sektorët e ekonomisë që mbetet pak i krediturar. Bankat u treguan të gatshme për të marrë pjesë në administrimin e fondeve në kuadër të programeve të zhvillimit si institucione të specializuara në këtë drejtim, gjë që do të ndihmonte në të njëjtën kohë dhe për përmirësimin e informacionit të tyre rreth këtij sektori kaq të rëndësishëm të ekonomisë.

Njëkohësisht, drejtuesit e bankave të nivelit të dytë u shprehën të gatshëm të rrisin shkallën e bashkëpunimit me Bankën e Shqipërisë, sidomos në lidhje me shkëmbimin e informacionit dhe të analizave, si dhe përshtatjen e ligjeve dhe rregulloreve për të ndihmuar zgjerimin e ndërmjetësimit financiar në Shqipëri.

### *Marrëdhëniet biznes-bankë – një kapitull i ri*

Më datë 13 dhjetor 2004, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë z. Ardian Fullani, zhvilloi një takim me komunitetin e biznesit në vend. Qëllimi i këtij takimi ishte hapja e një kapitulli të ri komunikimi dhe bashkëpunimi, një marrëdhënieje të re, të bazuar në përfitimin dhe besimin e ndërsjellë ndërmjet dy komuniteteve: të atij bankar dhe të biznesit.

Z. Fullani u fokusua në rëndësinë e krijimit të një mjedisi të qëndrueshëm ekonomik si kusht lehtësues për bizneset në marrjen e vendimeve të rëndësishme lidhur me zgjerimin dhe rritjen cilësore të bizneseve, gjetjen e klientëve potencialë etj.. Njëkohësisht, z. Fullani u zotua për angazhimin e Bankës së Shqipërisë për mbrojtjen e vlerës së kursimeve të përfaqësuesve të biznesit.

Në vazhdim, z. Fullani u ndal në çështje të tilla të rëndësishme siç janë: kreditimi i ekonomisë, krijimi i byrosë së informacionit të kredive, fillimi i punës për krijimin e sistemit të kryqëzimit të pagesave me vlerë të vogël, hapat e ndërmarrë nga Banka e Shqipërisë në drejtim të reduktimit të parasë *cash* në ekonomi, si dhe nevoja për rritjen e shkallës së informacionit mbi ecurinë e prodhimit, gjendjen e punësimit, pritshmëritë dhe ndjesitë që biznesi ka për të ardhmen e për një sërë treguesish të tjerë që lidhen me veprimtarinë ekonomike në nivel vendi, si kusht për arritjen nga Banka e Shqipërisë të përfundimeve më të sakta mbi zhvillimet aktuale dhe ato të pritshme të vendit.

### *Mbi takimet e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë në qytetin e Korçës*

Më datë 15 dhjetor 2004, në qytetin e Korçës, u zhvillua takimi rajonal i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë me drejtorët e degëve të bankave të nivelit të dytë, përfaqësuesit të biznesit dhe pedagogëve të Fakultetit Ekonomik të këtij qyteti. Qëllimi i këtij takimi ishte lançimi i vizionit të ri në lidhje me ristrukturimin e Bankës së

Shqipërisë, pjesë e së cilës janë dhe degët e saj në qytete të ndryshme të vendit.

Ky vizion ka në qendër të vëmendjes ridimensionimin e funksioneve të degëve të BSH-së nëpër rrethe, duke i shndërruar ato nga magazina dhe distributorë të thjeshtë *cash*-i, në modele të përparuara të prezencës së Bankës së Shqipërisë nëpër rajone të ndryshme të vendit, me qëllim kthimin e tyre në stacione të mirëfillta të grumbullimit të informacionit në lidhje me aktivitetin ekonomiko-financiar të rajonit. Ristrukturimi do të synojë edhe në eliminimin e disa veprimeve që janë jashtë natyrës së bankingut qendror e që gradualisht do të thithen nga ana e bankave tregtare.

Z. Fullani shprehu rëndësinë e angazhimit të përbashkët të Bankës së Shqipërisë dhe aktorëve të tjerë në rajone të ndryshme të vendit, për krijimin e mundësive reale për një zhvillim të harmonizuar gjeografikisht, duke dhënë një kontribut të vërtetë në rritjen e mirëqënies në shkallë vendi.

# NGJARJET JURIDIKE
## TETOR - DHJETOR

### ZGJEDHJA E GUVERNATORIT DHE E ANËTARËVE TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË BANKËS SË SHQIPËRISË

Në datën 07.10.2004, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi vendimin nr. 148 "Për zgjedhjen e disa anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë". Në bazë të këtij vendimi, z. Ardian Fullani, z. Fatos Ibrahimi, z. Andis Harasani, zj. Elisabeta Gjoni, z. Ksenofon Krisafi dhe zj. Tefta Çuçi u zgjodhën anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

***

Në datën 28.10.2004, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi vendimin nr. 152 "Për zgjedhjen e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë". Në bazë të këtij vendimi, z. Ardian Fullani u zgjodh Guvernator i Bankës së Shqipërisë.

***

Në datën 18.11.2004, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi vendimin nr. 159 "Për zgjedhjen e një anëtari të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë". Në bazë të këtij vendimi, z. Limos Malaj u zgjodh anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

***

Në datën 24.11.2004, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi vendimin nr. 74 "Për zgjedhjen dhe emërimin e Zëvendësguvernatorëve të Bankës së Shqipërisë". Në bazë të këtij vendimi, z.Fatos Ibrahimi dhe z.Limos Malaj zgjidhen dhe emërohen përkatësisht në pozicionet e Zëvendësguvernatorit të Parë dhe të Zëvendësguvernatorit të Dytë të Bankës së Shqipërisë.

### POLITIKA MONETARE

Në datën 04.11.2004, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi vendimin nr. 68 "Për miratimin e uljes së përqindjes së interesave të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes". Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, vendosi uljen me 0.25 pikë përqindjeje të normës bazë të interesit. Pas këtij ndryshimi, norma e interesit e zbatuar në ankandet njëjavore të marrëveshjeve të riblerjes (Repo) është 5.25 për qind. Ky nivel përbën një minimum të ri historik për normën bazë të interesit në Shqipëri.

### OPERACIONET MONETARE

Në datën 10.11.2004, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi vendimin nr. 71 "Për garantimin e shumës deri në 29 miliardë lekë bono thesari të Qeverisë Shqiptare si pjesë e portofolit të "Raiffeisen Bank", në mbështetje të nenit 1, pika 4, shkronja (ç) të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë"". Me këtë akt u vendos që Banka e Shqipërisë të bëhet garante për shumën deri në 29 miliardë lekë bono thesari të Qeverisë Shqiptare, si pjesë e portofolit të "Raiffeisen Bank". Çmimi i letërgarancisë do të jetë 0.2 për qind me bazë vjetore.

***

Në datën 08.12.2004, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi vendimin nr.76 "Për një ndryshim në rregullat dhe procedurat e sistemit shqiptar të pagesave ndërbankare – AIPS". Ndryshimi i kryer në "Rregullat dhe procedurat e sistemit shqiptar të pagesave ndërbankare – AIPS", miratuar me vendimin nr. 103, datë 10.12.2003, konsiston në specifikimin se operatorë të sistemit, të cilët shlyejnë veprimet nëpërmjet AIPS-it, do të jenë Banka e Shqipërisë dhe institucione të tjera, që përcaktohen nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë.

***

Në datën 08.12.2004, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, miratoi vendimin nr.77 "Për miratimin e një operatori shlyerjeje të sistemit

AIPS". Me anë të këtij vendimi, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, vendosi të miratojë në parim shoqërinë VISA, si një operator sistemi për shlyerje të veprimeve, nëpërmjet sistemit AIPS. Shlyerjet në sistemin AIPS do të kufizohen vetëm në veprimet që shoqëria VISA kryen në lekë dhe për llogari të bankave që operojnë në Shqipëri.

## EMISIONI

Në datën 08.12.2004, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi vendimin nr. 78 "Për miratimin e kritereve për caktimin e çmimeve të blerjes dhe të shitjes për kartëmonedhat dhe monedhat metalike, vlera të tjera numizmatike, ambalazhe dhe katalogë", si dhe të "Metodikës për llogaritjen e çmimeve të tyre". Ky akt synon formalizimin e politikave për hartimin dhe për miratimin e kritereve të përgjithshme, që ndiqen nga Banka e Shqipërisë, në procedurat e përcaktimit të çmimeve të blerjes dhe të shitjes së kartëmonedhave e monedhave metalike për qëllime numizmatike.

## PRIVATIZIM

Ligji nr. 9313, datë 11.11.2004, "Për privatizimin e aksioneve, pronë e Shtetit Shqiptar, të Bankës Italo-Shqiptare" dhe ligji nr. 9314, datë 11.11.2004, "Për privatizimin e aksioneve, pronë e Shtetit Shqiptar, të Bankës së Bashkuar së Shqipërisë". Këto dy ligje sanksionojnë që Ministria e Financave, në cilësinë e pronarit, lejohet të transferojë në emër të Shtetit Shqiptar, të drejtën e pronësisë nëpërmjet shitjes së 40 për qind të aksioneve, përkatësisht në Bankën Italo-Shqiptare dhe Bankën e Bashkuar të Shqipërisë. Në të njëjtën kohë, dy ligjet përcaktojnë procedurat që duhet të ndiqen gjatë procesit të shitjes së aksioneve.

## POLITIKA EKONOMIKE

Ligji nr. 9309, datë 11.11.2004, "Për ratifikimin e "Marrëveshjes së garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe të Marrëveshjes së kredisë ndërmjet Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare (KESH) dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për projektin e prodhimit të energjisë termike në Vlorë"". Kjo kredi, e cila i akordohet KESH-it, ka një vlerë prej 40 000 000 eurosh dhe do të shfrytëzohet për ndërtimin e TEC-it në Vlorë.

***

Ligji nr. 9310, datë 11.11.2004, "Për ratifikimin e "Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë, për realizimin e programit "Ndërtimi i segmentit rrugor Lushnjë-Fier dhe supervizioni i punimeve për dy segmentet rrugore Lushnjë-Fier dhe Fier-Vlorë"". Marrëveshja parashikon akordimin e një kredie ndihme nga Qeveria Italiane me vlerë 24 350 000 euro.

***

Ligji nr. 9311, datë 11.11.2004, "Për ratifikimin e "Marrëveshjes së kredisë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA), për projektin e menaxhimit të burimeve ujore"". Kredia e akorduar ka një vlerë të barazvlefshme me 10 200 000 sdr.

***

Ligji nr. 9337, datë 16.12.2004, "Për ratifikimin e "Marrëveshjes së kredisë për zhvillim ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA), për programin e fazës së tretë të kredisë, në mbështetje të uljes së varfërisë"". Marrëveshja e kredisë konsiston në një shumë të barazvlefshme me 6 900 000 sdr.

***

Ligji nr. 9340, datë 23.12.2004, "Për ratifikimin e "Marrëveshjes së garancisë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve, për kontratën financiare për projektin e ndërtimit të TEC-it në Vlorë"". Kontrata financiare, e nënshkruar më 29.09.2004, ndërmjet KESH-it dhe Bankës Evropiane të Investimeve, konsiston në akordimin e një kredie me vlerë prej 40 000 000 eurosh.

## POLITIKA FISKALE

Ligji nr. 9326, datë 06.12.2004, "Për disa

ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat"". Kuvendi i Republikës së Shqipërisë vendosi që çdo individ që realizon të ardhura, të cilat nuk i ka mbajtur institucioni ku ai punon, duhet t'i deklarojë këto të ardhura në organin tatimor deri në datën 30 janar të vitit në vijim. Shkalla tatimore e tatimit për vitin fiskal 1 janar deri më 31 dhjetor 2005, do të jetë 23 për qind dhe për vitet e tjera fiskale 20 për qind. Gjithashtu, çdo rezident në Shqipëri, organet e qeverisjes qendrore e lokale, OJF-të etj. janë të detyruar të mbajnë tatimin prej 10 për qind nga shuma bruto e pagesave.

***

Ligji nr. 9328, datë 06.12.2004, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8976, datë 12.12.2002, "Për akcizat"". Shtesat dhe ndryshimet e ligjit konsistojnë në një shtojcë të bashkëngjitur me këtë ligj, e cila specifikon zbatimin e akcizës sipas kategorive të ndryshme.

***

Ligji nr. 9331, datë 06.12.2004, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8977, datë 12.12.2002, "Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë"". Ky ligj ka sjellë ndryshime në lidhje me taksën vjetore të qarkullimit rrugor si dhe zbatimin e saj sipas llojeve të ndryshme të automjeteve.

***

Ligji nr. 9332, datë 06.12.2004, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7928, datë 27.04.1995, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar"". Ndryshimet e bëra në këtë ligj specifikojnë zbatimin e tatimit mbi vlerën e shtuar, rastet e përjashtimit nga aplikimi i këtij tatimi si dhe të drejtën e ankimit në Komisionin e Apelimit të Tatimeve.

## POLITIKA BUXHETORE

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 863 , datë 17.12.2004, "Për disa shtesa e ndryshime në vendimin nr.194, datë 22.4.1999, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e strukturës së pagës së punonjësve mësimorë, në arsimin pasuniversitar"". Rritja e pagave të kësaj kategorie punonjësish u miratua mesatarisht në masën 8 për qind, dhe efektet financiare të saj, që do të përballohen nga buxheti i vitit 2004, fillojnë nga data 1 nëntor 2004.

***

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 865 , datë 17.12.2004, "Për disa shtesa e ndryshime në vendimin nr. 306, datë 27.6.1999 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të punonjësve me arsim të lartë në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë"". Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi do të përballohen nga buxheti i vitit 2004 e në vazhdim dhe fillojnë nga data 1 nëntor 2004.

***

Ligji nr. 9339, datë 21.12.2004, "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005". Fondi i konsoliduar për vitin 2005 do të jetë: 169 854 milionë lekë për të ardhurat dhe 212 011 milionë lekë për shpenzimet e buxhetit të shtetit.

**BANKA E SHQIPËRISË**
**31 DHJETOR 2004**

## KËSHILLI MBIKËQYRËS

| | |
|---|---|
| ARDIAN FULLANI | Kryetar |
| FATOS IBRAHIMI | Zëvendëskryetar |
| LIMOS MALAJ | Anëtar |
| SULO HADËRI | Anëtar |
| TONIN KOLA | Anëtar |
| ANDIS HARASANI | Anëtar |
| ELISABETA GJONI | Anëtare |
| KSENOFON KRISAFI | Anëtar |
| TEFTA ÇUÇI | Anëtare |

## GUVERNATORI

**ARDIAN FULLANI**

## ZËVENDËSGUVERNATORËT

FATOS IBRAHIMI - Zëvendësguvernator i Parë
LIMOS MALAJ - Zëvendësguvernator i Dytë

## INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM

**ELSA BIZHGA**

## DEPARTAMENTET DHE NJËSITË E TJERA

| | |
|---|---|
| GRAMOZ KOLASI | Departamenti i Politikës Monetare |
| ERJON LUÇI | Departamenti i Kërkimeve |
| MARJAN GJERMENI | Departamenti i Operacioneve Monetare |
| KLODION SHEHU | Departamenti i Mbikëqyrjes |
| SONILA TAÇI | Departamenti i Emisionit |
| LLAZI BALLIU | Departamenti i Kontabilitetit dhe i Pagesave |
| SOKOL QERAXHIU | Departamenti i Teknologjisë së Informacionit dhe Statistikave |
| DASHAMIR HALILAJ | Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Juridik |
| ESMERALDA URUÇI | Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun |
| ELSA BIZHGA | Departamenti i Kontrollit |
| ERGYS MISHA | Departamenti i Shërbimeve Logjistike |
| ALFONS THEKA | Shtypshkronja |

## DEGËT

| | |
|---|---|
| ERMIRA ISTREFI | Shkodra |
| VALENTINA DEDJA | Elbasani |
| ANILA THOMAJ | Gjirokastra |
| LILJANA ZJARRI | Korça |
| SHPRESA MEÇO | Lushnja |

# LISTA E SUBJEKTEVE TË LICENCUARA NGA BANKA E SHQIPËRISË*

## BANKA DHE DEGË TË BANKAVE TË HUAJA

**1. BANKA ITALO – SHQIPTARE SH.A.**
Licenca nr.1/1996, datë 17.07.1998.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.89, datë 18.06.1998.
Çertifikata nr. 1 "Për sigurimin e depozitave".
Administratori i deleguar: Giovani BOGANI
Adresa: Rruga "Barrikadave", Nr.70, Tiranë.
Tel. Central: 23 56 97, 23 56 98, 22 62 62.
Faks: 23 30 34.

**2. BANKA RAIFFEISEN SH.A.**
Banka e Kursimeve Sh.a." në "Raiffeisen Bank sh.a." me vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë nr. 17426/7, datë 01.10.2004.
Licenca nr.2/1998, datë 11.01.1999.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.163, datë 11.12.1998.
Çertifikata nr. 2 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: Steven GRUNERUD
Adresa: Rruga "Dëshmorët e 4 Shkurtit", Nr.6, Tiranë.
Tel. Central: 22 45 40, 22 26 69, 22 54 16.
Faks: 22 35 87, 22 36 95, 22 40 51.

**3. BANKA E BASHKUAR E SHQIPËRISË SH.A.**
BANKA ARABO-SHQIPTARE ISLAMIKE ka ndryshuar emrin me vendimin nr.4315/7, datë 16.09.2003 të Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë.
Licenca nr.3/1998, datë 11.01.1999.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.165, datë 11.12.1998.
Çertifikata nr.3 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: Abdul Waheed ALAVI
Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr.8, Tiranë.
Tel. Central: 22 84 60, 22 38 73, 22 74 08.
Faks: 22 84 60, 22 83 87.

**4. BANKA DARDANIA SH.A.**
Licenca nr.5/1998, datë 11.01.1999.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.164, datë 01.12.1998.
Çertifikata nr.4 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: Beqir MEZELXHIU
Adresa: Bulevardi "Zogu I" (pranë Fakultetit të Shkencave), Tiranë.
Tel. Central: 22 87 59, 25 93 50, 25 93 51.
Faks: 23 05 66.
Teleks: 2298 db banc ab
Email: db@albaniaonline.net ; dardaniabank@hotmail.com

* Deri në datën 31.12.2004.

**5. BANKA KOMBËTARE TREGTARE SH.A.**
Licenca nr.6/1998, datë 11.01.1999.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.162, datë 11.01.1999.
Çertifikata nr.5 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: Seyhan PENCAPLIGIL
Adresa: Bulevardi "Zhan D'Ark", Tiranë.
Tel: 25 09 55.
Faks: 25 09 56.

**6. BANKA TIRANA SH.A.**
Licenca nr.07, datë 12.09.1996.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.9, datë 12.09.1996.
Çertifikata nr.6 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: Dimitris KARAVIAS
Adresa: Bulevardi "Zogu I", Nr.55/1, Tiranë.
Tel. Central: 23 34 41/42/43/44/45/46/47.
Faks: 23 3417.

**7. BANKA KOMBETARË E GREQISË - DEGA TIRANË**
Licenca nr.08, datë 25.11.1996.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.4, datë 14.03.1996.
Çertifikata nr.7 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: Spiro BRUMBULLI
Adresa: Rruga e Durrësit, Godina "Comfort", Tiranë.
Tel. Central: 23 36 23/24.
Faks: 23 36 13.

**8. BANKA NDËRKOMBËTARE TREGTARE SH.A.**
Licenca nr.09, datë 20.02.1997.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.9, datë 30.04.1996.
Çertifikata nr.8 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: Ooi Kooi KEAT
Adresa: Rruga "Ded Gjon Luli", Tiranë.
Tel. Central: 23 75 67/68/69.
Tel/Faks: 23 75 70.

**9. BANKA ALPHA - DEGA TIRANË**
Licenca nr.10, datë 07.01.1998.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.01/03/96, datë 27.12.1997.
Çertifikata nr. 9 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: Andrea GALATOULAS
Adresa: Bulevardi "Zogu I", Nr.47, Tiranë.
Tel. Central: 23 33 59, 24 04 76 / 77 / 78.
Tel/Faks: 23 21 02.

**10. BANKA AMERIKANE E SHQIPËRISË SH.A.**
Licenca nr.11, datë 10.08.1998.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.105, datë 10.08.1998.
Çertifikata nr.10 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: Lorenzo RONCARI
Adresa: Rruga "Ismail Qemali" Nr.27, P.O. Box 8319, Tiranë.
Tel. Central: 34 87 53/54/55/56.
Tel/Faks: 34 87 62.

**11. BANKA PROCREDIT SH.A.**
BANKA FEFAD SH.A ka ndryshuar emrin me vendimin nr.20797/10, datë 15.09.2003 të Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë.
Licenca nr. 12, datë 15.03.1999.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.22, datë 03.03.1999.
Çertifikata nr. 11 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: Ralf REITEMEIER
Adresa: Rruga "Sami Frashëri", Tirana e Re, P.O. Box. 2395, Tiranë.
Tel: 23 04 99, 23 34 96.
Tel/Faks: 23 34 81.

**12. BANKA E PARË E INVESTIMEVE SH.A. - DEGA TIRANË**
Licenca nr. 13, datë 16.04.1999.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.45, datë 13.04.1999.
Çertifikata nr. 12 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: Petar Gavrillov KRASTEV
Adresa: Bulevardi "Zogu I", Nr. 64, Tiranë.
Tel: 35 64 23, 35 64 24.
Tel/Faks: 35 64 22.

**13. BANKA EMPORIKI – SHQIPËRI SH.A.**
BANKA TREGTARE E GREQISË (SHQIPËRI) SH.A. ka ndryshuar emrin me vendimin nr.20830/5, datë 15.12.2003, të Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë.
Licenca nr. 14, datë 28.10.1999.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.105, datë 19.10.1999.
Çertifikata nr. 13 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: George CARACOSTAS
Adresa: Rruga "Kavajës", "Tirana Tower", Tiranë.
Tel: 25 87 55/56/57/58/59/60.
Tel/Faks: 25 87 52.

**14. BANKA E KREDITIT TË SHQIPËRISË SH.A.**
Licenca nr. 15, datë 28.08.2002.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.66, datë 28.08.2002.
Çertifikata nr. 14 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: Kamal Abdel MONEIM
Adresa: Rruga "Perlat Rexhepi", Al-Kharafi Group Administration Building, Kati 1&2, Tiranë.
Tel: 27 21 68; 27 21 62.
Tel/Faks: 27 21 62.
E-mail: creditbkalb@icc-al.org

**15. BANKA "CREDINS" SH.A.**
Licenca nr. 16, datë 28.03.2003.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.22, datë 26.03.2003.
Çertifikata nr. 15 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: Artan SANTO
Adresa: Rruga ''Ismail Qemali'', Nr.21 Tiranë.
Tel: 22 29 16; 23 40 96.

**16. BANKA POPULLORE SH.A.**
Licenca nr.17, datë 16.02.2004.
Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.06, datë 11.02.2004.
Çertifikata nr.16 "Për sigurimin e depozitave".
Drejtori: Edvin LIBOHOVA
Adresa: Rruga ''Donika Kastrioti'', Pall.11/1, Kati I, Tiranë.
Tel: 27 27 88/89.

# SUBJEKTE JOBANKA

**1. UNIONI FINANCIAR I TIRANËS SH.P.K. (UFT)**
Licenca nr.1, datë 08.12.1999, për ushtrimin e veprimtarive financiare:

- të ofrimit të shërbimit të pagesave dhe të arkëtimeve;
- të ndërmjetësimit të transaksioneve monetare;
- të shërbimit si agjent dhe këshilltar financiar.

Drejtor: Niko Leka; Edmond Leka
Adresa: Rruga "Reshit Çollaku", Pall. "Shallvare", Sh.2, Nr.18, Tiranë.
Tel: 25 06 53.

**2. DINERS CLUB ALBANIA SH.P.K.**
Licenca nr.2, datë 09.10.2000, për ushtrimin e veprimtarisë financiare:

- të ndërmjetësimit të transaksioneve monetare.

Drejtor: Vebi Velia
Adresa: Bulevardi "Zogu I", Qendra e Biznesit VEVE, Tiranë.

**3. POSTA SHQIPTARE SH.A.**
Licenca nr.3, datë 18.04.2001, për ushtrimin e veprimtarive financiare:

- të ofrimit të shërbimit të pagesave dhe të arkëtimeve;
- të shërbimit si agjent dhe këshilltar financiar.

Pronësia : Shtetërore.
Drejtor : Aleksandra Çollaku
Adresa: Rruga "Reshit Çollaku" , Nr.4 Tiranë.
Tel : 22 23 15.

**4. "CREDINS" SH.A. TIRANË**
Licenca nr. 04, datë 13.06.2001, për ushtrimin e veprimtarive financiare:

- të dhënies së kredive;
- të ofrimit të shërbimit të pagesave dhe të arkëtimeve;
- të ndërmjetësimit për transaksionet monetare (duke përfshirë valutat);
- të ofrimit të garancive;
- të shërbimit si agjent dhe këshilltar financiar (këtu nuk përfshihen shërbimet e parashikuara në pikat 3/a dhe 3/b të nenit 26, të ligjit "Për bankat në Republikën e Shqipërisë").

Drejtor: Monika Milo
Adresa: Rruga "Ismail Qemali", Nr.21, Tiranë.
Tel: 22 29 16; 23 40 96.

**5. FONDI I FINANCIMIT TË ZONAVE MALORE**
Licenca nr.5, datë 29.03.2002, si subjekt financiar jobankë, për ushtrimin e veprimtarisë financiare:

- të dhënies së kredive.

Themeluar me vendim të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë.
Drejtori: Arben Jorgji
Adresa: Rruga "Mustafa Matohiti", Vila nr.12, Tiranë.
Tel: 25 06 33.

**6. "AK – INVEST" SH.A.**
Licenca nr.7, datë 03.12.2003, si subjekt financiar jobankë, për ushtrimin e veprimtarive financiare:

- të shërbimit të pagesave dhe të arkëtimeve;
- të ndërmjetësimit për transaksionet monetare (duke përfshirë valutat);
- të agjentit dhe këshilltarit financiar.

Administratori: Ilir Adili
Adresa : Rruga "Ded Gjon Luli", Nr.2/3, Tiranë.
Tel: 24 01 47.

**SUBJEKTET FINANCIARE QË NUK LICENCOHEN NGA BANKA E SHQIPËRISË PËR KRYERJEN E VEPRIMTARISË SË TYRE, NË MBËSHTETJE TË VENDIMIT NR. 26, DATË 29.03.2000, TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË BANKËS SË SHQIPËRISË: "PËR PËRJASHTIMIN E DISA SUBJEKTEVE NGA ZBATIMI I DISPOZITAVE TË LIGJIT NR. 8365, DATË 02.07.1998 "PËR BANKAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"".**

(Këto subjekte nuk licencohen apo mbikëqyren nga Banka e Shqipërisë, por kanë detyrimin të raportojnë në Bankën e Shqipërisë.)

**1. FONDI I FINANCIMIT RURAL**
Themeluar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 207, datë 28.04.1999.
Objekti i veprimtarisë: Financimi i zonave rurale.
Përjashtuar me shkresën e Bankës së Shqipërisë nr.1843, datë 01.08.2000.
Drejtor: Zana Konini.
Adresa: Rruga"Ismail Qemali", P.32, Tiranë.

**2. FONDACIONI "BESA"**
Themeluar nga "Fondacioni i Shoqërisë së Hapur për Shqipërinë" (SOROS).
Objekti i veprimtarisë: Financimi i ndërmarrjeve të mesme dhe të vogla.
Përjashtuar me shkresën e Bankës së Shqipërisë nr. 2895/1, datë 19.01.2001.
Drejtor: Bajram Muça.
Adresa: Rruga "Asim Vokshi", Nr. 35, Tiranë.

**3. PARTNERI SHQIPTAR NË MIKROKREDI**
Aksioner: "Opportunity International" (East Europe).
Objekti i veprimtarisë: Kredidhënia.
Përjashtuar me shkresën e Bankës së Shqipërisë nr. 828/1, datë 08.04.2002.
Drejtor: James Reiff.
Adresa: Rruga "Gjin Bue Shpata", Nr. 7/1, Tiranë.

## ZYRA TË KËMBIMEVE VALUTORE

**1. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "JOARD" SH.P.K., TIRANË**
Licenca: Nr. 01, datë 01.10.1999.
Adresa: Rruga "Ded Gjon Luli" Nr.2, Tiranë.
Kambistë: Josif Kote, Pajtim Kodra.

**2. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "AMA" SH.P.K., DURRËS**
Licenca: Nr. 02, datë 01.10.1999.
Adresa: Rruga "Tregtare", Lagja 3, Durrës.
Kambistë: Mirlinda Ceka, Ilir Hoxha.

**3. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "ARIS" SH.P.K., TIRANË**
Licenca: Nr. 03, datë 01.10.1999.
Adresa: Rruga "Luigj Gurakuqi" , Tiranë.
Kambistë: Ardian Goci, Ismet Noka.

**4. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "UNIONI FINANCIAR TIRANË" SH.P.K.**
Licenca: Nr. 04, datë 01.10.1999.
Adresa: Rruga "Reshit Çollaku", "Pall. Shallvare", Shk. 2/18, Tiranë.
Administrator: Niko Leka.
Kambistë: Arjan Lezha (Përgjegjës i agjencisë), Albert Sara, Dhimitër Papadhopulli, Genta Angjeli (Agalliu), Piro Teti, Flora Simixhi, Petrika Mano (Përgjegjës i agjencisë), Lindita Shala, Mirela Bakalli, Anila Demiri, Emili Bakalli (Nako), Astrit Sfërdelli, Mirela Kaiku, Erisa Emiri.

**5. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "AGLI" SH.P.K., TIRANË**
Licenca: Nr. 05, datë 01.10.1999.
Adresa: Agjencia 1: Rruga "Islam Alla", Nr.1, Tiranë.
Agjencia 2: Rruga "Kavajës", pranë pastiçeri "Rinia", Tiranë.
Kambistë: Kujtim Nina (Drejtor i shoqërisë), Agim Cani, Selim Luli.

**6. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "EXCHANGE" SH.P.K., TIRANË**
Licenca: Nr. 08, datë 24.11.1999.
Adresa: Rruga "Durrësit", Nr. 170, Tiranë.
Kambistë: Ivan Pavllovski, Ervis Myftari.

**7. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "UNISIX" SH.P.K., KORÇË**
Licenca: Nr. 09, datë 26.11.1999.
Adresa: Bulevardi "Republika", Pall.4, Korçë.
Kambistë: Pandi Cunoti, Ernest Golka, Nikolin Bicka, Eli Bode.

**8. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "EKSPRES J & E" SH.P.K., DURRËS**
Licenca: Nr. 10, datë 26.11.1999.
Adresa: Lagja 11, Rruga "Prokop Meksi" (pranë hotel "Durrësi"), Durrës.
Kambistë: Kostandin Ekonomi, Entela Ekonomi.

**9. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "ILIRIA '98" SH.P.K., TIRANË**
Licenca: Nr. 12, datë 25.02.2000.
Adresa: Sheshi "Skënderbej", Teatri i Kukullave, Tiranë.
Kambistë: Edmond Ymeri, Ali Topalli, Ilir Janku.

**10. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "SERXHIO" SH.P.K., ELBASAN**
Licenca: Nr. 14, datë 07.04.2000.
Adresa: Lagja "Luigj Gurakuqi", Rruga "11 Nëntori", Pall. 70, Nr.14, Elbasan.
Kambistë: Amarildo Canku.

**11. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "ALBTUR" SH.P.K., TIRANË**
Licenca: Nr. 15, datë 07.04.2000.
Adresa: Bulevardi "Zogu I", Pall. 32, Shk.1 (përballë bankës "Tirana"), Tiranë.
Kambistë: Albert Rahmani, Artur Rahmani.

**12. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "R & M" SH.P.K., TIRANË**
Licenca: Nr. 16, datë 22.05.2000.
Adresa: Rruga "Punëtorët e Rilindjes", Pall.182, Tiranë.
Kambistë: Edmond Stepa, Miranda Stepa.

**13. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "TEUTA 2000" SH.P.K., DURRËS**
Licenca: Nr. 17, datë 22.05.2000.
Adresa: Lagja 4, Rruga "Skënderbej", Ap. 950, Durrës.
Kambistë: Adelina Hoxha, Arben Çuni.

**14. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "T & E" SH.P.K., DURRËS**
Licenca: Nr. 18, datë 11.06.2000.
Adresa: Lagja 4, Rruga "9 Maji", Durrës.
Kambist: Shpëtim Hysa.

**15. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "SHIJAK 2000" SH.P.K., SHIJAK**
Licenca: Nr. 19, datë 24.11.2000.
Adresa: Lagja "Popullore", Shijak.
Kambistë: Nazmi Ademi, Farije Ademi.

**16. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "R & T" SH.P.K., TIRANË**
Licenca: Nr. 20, datë 20.12.2000.
Adresa: Bulevardi "Zogu I" (pranë BPI-së), Tiranë.
Kambist: Renis Tërshana.

**17. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "MANUSHI" SH.P.K., TIRANË**
Licenca: Nr. 22, datë 18.04.2001.
Adresa: Bulevardi "Zogu I", Qendra e Biznesit VEVE, Tiranë.
Kambist: Roland Manushi.

**18. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "UNIONI SELVIA" SH.P.K., TIRANË**
Licenca: Nr. 23, datë 21.05.2001.
Adresa: Godina 2-katëshe në krah të Postës Qendrore, Kati I, Tiranë.
Kambistë: Leonat Zenelaj, Gani Xhaja.

**19. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "KALENJA" SH.P.K., TIRANË**
Licenca: Nr. 24, datë 29.06.2001.
Adresa: Rruga "Kavajës" (pranë Ambasadës Turke), Tiranë.
Kambistë: Hair Shametaj, Fatmir Shametaj, Gëzim Dushkaj.

**20. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "TILBA" SH.P.K., ELBASAN**
Licenca: Nr. 25, datë 30.09.2001.
Adresa: Lagja "Luigj Gurakuqi", Bulevardi "Qemal Stafa", Njësia nr.12, Elbasan.
Kambistë: Kristaq Bako, Vjollca Bako.

**21. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "ANAGNOSTI" SH.P.K., TIRANË**
Licenca: Nr. 26, datë 31.10.2001.
Adresa: Zyra 1: Bulevardi "Zogu I", Pall. 97, Shk.3, Ap, 28, Tiranë.
Kambistë: Jani Anagnosti, Odise Anagnosti, Edlira Anagnosti.
Zyra 2: Rruga "Kajo Karafili", Nr.11 Tiranë.
Kambist: Fredi Cami.

**22. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "KO-GO" SH.P.K., TIRANË**
Licenca: Nr. 27, datë 12.11.2001.
Adresa: Rruga "Vaso Pasha", Pall.16, Shk.2, Ap. 9, Tiranë.
Kambistë: Mihal Konomi, Përparim Goxhaj.

**23. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "ALB- FOREX" SH.P.K., TIRANË**
Licenca: Nr. 28, datë 22.11.2001.
Adresa: Agjencia 1: Rruga "Abdyl Frashëri, Nr.3, Tiranë.
Agjencia 2: Rruga "Mine Peza", Pall. 102, Shk.1 (pranë bar "Grand"), Tiranë.
Kambistë: Almir Duli, Agim Xhemo, Fatmir Baholli.

**24. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "L&N" SH.P.K., TIRANË**
Licenca: Nr. 29, datë 22.11.2001.
Adresa: Rruga "Muhamet Gjollesha", ish-gjelltorja tek sheshi "ATATURK", Tiranë.
Kambist: Leonora Mihalcka.

**25. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "EXHANGE ALOG" SH.P.K., TIRANË**
Licenca: Nr. 31, datë 22.11.2001.
Adresa: Rruga "Mine Peza" (përballë Selisë së Vatikanit), Tiranë.
Kambistë: Almida Sterio, Fatmir Tafaj, Eduard Andoni.

**26. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "BASHKIMI 2001" SH.P.K., TIRANË**
Licenca: Nr. 35, datë 12.12.2001.
Adresa: Rruga "Kavajës" (pastiçeri "Rinia"), Tiranë.
Kambistë: Bashkim Shametaj, Luan Shametaj, Ilir Mesini.

**27. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "ARJON 2002" SH.P.K., ELBASAN**
Licenca: Nr. 36, datë 14.12.2001.
Adresa: Lagja "Kongresi i Elbasanit", Bulevardi "Qemal Stafa", Pall.9-katësh, Elbasan.
Kambistë: Arben Kovaçi, Besnik Lulja.

**28. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "ALAKTH" SH.P.K., TIRANË**
Licenca: Nr. 42, datë 18.01.2002.
Adresa: Rruga "Dibrës", Nr.105/1, Tiranë.
Kambistë: Kosta Papa, Arben Memko, Lorenc Konomi, Thoma Konomi, Aleko Plaku.

**29. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "FORMAT" SH.P.K., TIRANË**
Licenca: Nr. 43, datë 21.01.2002.
Adresa: Rruga "Durrësit", Pall.85, Shk.1, Ap.1, Tiranë.
Kambistë: Diana Lemi, Egon Sinani.

**30. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "TRI URAT" SH.P.K., ELBASAN**
Licenca: Nr. 44, datë 05.02.2002.
Adresa: Lagja "29 Nëntori", pranë Filialit të Postës Elbasan.
Kambistë: Fahri Sanco, Ismail Bejta.

**31. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "BESA 2001" SH.P.K., TIRANË**
Licenca: Nr. 46, datë 15.02.2002.
Adresa: Rruga "Myslym Shyri", Nr.25,Tiranë.
Kambistë: Belul Lleshi, Vladimir Avda, Mimoza Avda.

**32. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "MARIO" SH.P.K., SARANDË**
Licenca: Nr. 47, datë 14.03.2002.
Adresa: Lagja 1, pranë ish-Komitetit Ekzekutiv të rrethit Sarandë.
Kambistë: Vangjel Gramozi, Blerim Dhima.

**33. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "JAV" SH.P.K., TIRANË.**
Ka ndryshuar emrin Zyra e Këmbimit Valutor "R&T EXCHANGE" Sh.p.k.
Licenca: Nr. 48, datë 20. 03.2002.
Adresa: Bulevardi "Zogu I", Godina e "Zërit të Popullit", Tiranë.
Kambistë: Ervin Lera, Ilir Gurashi.

**34. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "DROGU" SH.P.K., TIRANË**
Licenca: Nr. 49, datë 23.04.2002.
Adresa: Rruga "Vaso Pasha", Kulla 1(pas pallatit Agimi), Kati I, Tiranë.
Kambistë: Shkëlqim Drogu, Kostandin Koteci.

**35. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "HYSEN-C" SH.P.K., LAÇ**
Licenca: Nr. 50, datë 23.04.2002.
Adresa: Lagja nr.3, përballë Komisariatit të Policisë, Laç.
Kambist: Cen Hyseni.

**36. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "UNIONI FIER" SH.P.K., FIER**
Licenca: Nr. 51, datë 08.05.2002.
Adresa: Lagja "15 Tetori", Rruga "Kastriot Muça", Fier.
Kambistë: Gjergj Dulaj.

**37. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "TAXI EKSPRES" SH.P.K., ELBASAN**
Licenca: Nr. 52, datë 20.05.2002.
Adresa: Rruga "Sami Frashëri", Nr.11 (pranë shkollës "Edit Durham"), Tiranë.
Kambistë: Arben Sharra, Sokol Kaleci.

**38. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "MERO" SH.P.K., DEVOLL**
Licenca: Nr. 53, datë 22.05.2002.
Adresa: Zyra nr.1 : Bulevardi "Fuat Babani", Bilisht.
Zyra nr.2 : Dogana, Kapshticë.
Kambistë: Gëzim Demcolli, Valter Miza, Genti Mahmutaj, Albert Haxhia, Edmond Miza.

**39. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "GLEAR" SH.P.K., SHIJAK**
Licenca: Nr. 55, datë 23.07.2002.
Adresa: Lagja "Kodër", Shijak, Durrës.
Kambistë: Argjend Calliku, Afërdita Calliku.

**40. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "POSTA SHQIPTARE" SH.A., TIRANË**
Licenca: Nr. 56, datë 28.08.2002.
Adresa: Rruga "Reshit Çollaku", Nr.4 Tiranë.

**41. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "UNIONI BALLSH" SH.P.K., BALLSH**
Licenca: Nr. 57, datë 11.09.2002.
Adresa: Rruga "8 Nëntori", Ballsh.
Kambistë: Luan Zenelaj, Lavdimir Zenelaj.

**42. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "ESLULI" SH.P.K., TIRANË**
Licenca: Nr. 58, datë 17.10.2002.
Adresa: Rr. "Reshit Çollaku", Pallati "Shallvare", Shk.4/1, Tiranë.
Kambistë: Selim Luli, Kleomen Gjiknuri.

**43. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "AMERICAN GLOBAL CAPITAL FUND WORLDWIDE INVESTMENT" SH.P.K., TIRANË**
Licenca: Nr. 59, datë 26 .11.2002.
Përfaqësues me prokurë: Dashnor Shena, Vilson Ahmeti.
Adresa: Rruga "Ismail Qemali", Parcela 167/187, "Euroapartment", Tiranë.
Kambistë: Elda Skënderi, Vasil Llogoro, Arian Kokali.

**44. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "DENI&KRISTI-2002" SH.P.K., TIRANË**
Licenca: Nr. 61, datë 02.06.2003.
Adresa: Rruga "Myslym Shyri", Pall.60, Ap.3, Tiranë.
Kambist: Maksim Çeku.

**45. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "YLDON" SH.P.K., TIRANË**
Licenca: Nr. 62, datë 03. 06.2003.
Adresa: Rruga "Qemal Stafa", Pall. 382/2/2, Tiranë.
Kambist: Ylli Ndoqi (themelues dhe administrator).

**46. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "BILLI" SH.P.K., TIRANË**
Licenca: Nr. 63, datë 16. 02.2004.
Adresa: Sheshi "Wilson", Pallati i ri në kryqëzimin e Tiranës së Re.
Kambist: Sybi Cenolli.

**47. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "REXHA F&E" SH.P.K., DURRËS**
Licenca: Nr. 64, datë 07.04.2004.
Adresa: Rruga "Mujo Ulqinaku", Lagja nr. 5, Pall. 619, Durrës.
Kambistë: Fatmir Rexha (themelues dhe administrator), Ermira Rexha.

**48. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "ALBA&ARBËR" SH.P.K., TIRANË**
Licenca:. Nr. 65, datë 06.05.2004.
Adresa: Rruga "Kavajës", Pall. 3, Kati I, Tiranë.
Kambistë: Pëllumb Memetaj e Bukurosh Jaho (administratorë).

**49. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "I.S.N." SH.P.K., TIRANË**
Licenca: Nr. 66, datë 06.05.2004.
Adresa: Rruga "Kavajës", Pall. 3, Kati I, Tiranë.
Kambistë: Evzi Zemzadja (administrator), Nexhmi Uka, Salandi Brojaj.

**50. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "ARIABA" SH.P.K., TIRANË**
Licenca: Nr. 67, datë 07.06.2004.
Adresa: Rruga "Abdyl Frashëri", Pallati i Librit Universitar, Kati I, Shk.5, Tiranë.
Kambistë: Agim Xhemo (administrator), Astrit Hado.

**51. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "ALBACREDITS" SH.P.K., TIRANË**
Licenca: Nr. 68, datë 13.07.2004.
Adresa: Rruga "Ded Gjon Luli", Nr. 5, Tiranë.
Kambistë: Ermira Skënderi (administratore), Engjëll Skënderi, Burhan Kodra.

**52. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "ALB- KREDIT" SH.P.K., TIRANË**

Licenca: Nr. 69, datë 19.07.2004.
Adresa: Rruga e Durrësit, Nr. 2, Tiranë.
Kambistë: Arben Cani (administrator), Vasil Marto, Rudina Muskaj, Valbona Kadriu, Teuta Koltarka, Hajredin Toca.

**53. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "IDEA - 2" SH.P.K., KAVAJË**

Licenca: Nr. 70, datë 02.09.2004.
Adresa: Lagja nr.2, Rruga "10 korriku", Kavajë.
Kambist: Taulant Karkini (administrator).

**54. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "O & G" SH.P.K., TIRANË**

Licenca: Nr. 71, datë 30.09.2004.
Adresa: Rruga e Kavajës (përballë Kishës Katolike, ngjitur me Raiffeisen Bank), Tiranë.
Kambistë: Prandvera Ago (administratore), Teuta Broqi.

**55. ZYRA E KËMBIMEVE VALUTORE "OMEGA" SH.P.K., TIRANË**

Licenca: Nr. 72, datë 20.12.2004.
Adresa: Rruga "Abdyl Frashëri", Pall. 1, Shk.2, Ap.10, Tiranë.
Kambistë: Mihallaq Peko (administrator).

# UNIONET E SHOQËRIVE TË KURSIM-KREDITIT

**1. UNIONI I SHOQËRIVE TË KURSIM-KREDITIT "JEHONA" TIRANË**
Licenca: Nr.1, datë 27.06.2002.

Kryetar i bordit drejtues: Vojsava Rama.

Anëtare të këtij unioni janë 41 shoqëri të kursim-kreditit, të cilat janë të licencuara edhe si shoqëri të veçanta. Mbështeten me asistencë teknike nga fondacioni "Lëvizja për zhvillimin e shoqërive të kursim-kredive".

**2. UNIONI I SHOQËRIVE TË KURSIM-KREDITIT "UNIONI SHQIPTAR KURSIM-KREDITIT", TIRANË**
Licenca: Nr.2, datë 09.08.2002.
Adresa: Rruga "Ismail Qemali", Nr.32.

Kryetar i bordit drejtues: Zana Konini

Anëtare të këtij unioni janë 98 shoqëri të kursim-kreditit, të cilat janë të licencuara edhe si shoqëri të veçanta. Mbështeten me asistencë teknike nga Fondi i Financimit Rural.

## ZYRA TË PËRFAQËSIMIT TË BANKAVE TË HUAJA

**1. ZYRA E PËRFAQËSIMIT TË BANKËS POPULLORE PULIEZE NË SHQIPËRI.**
Licenca: Nr.1, datë 02.07.2003.

Përfaqësuesi: Giancarlo Stasi.
Adresa: Sheshi “Skënderbej”, Pallati i Kulturës, Kati III, Tiranë.